



■ Udhëzuesi për kalimin në transmetimin digjital

Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim janë pikëpamje të tyre, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht edhe pikëpamjet e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave.

Publikuar nga Dunja Mijatović, Përfaqësuese e OSBE-së për Lirinë e Mediave
Redaktuar nga Nora Kovacs dhe Mike Stone

© 2010 Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Mediave të
Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE)
Wallnerstrasse 6
A-1010 Vienë, Austri
Tel.: +43-1 514 36 68 00
Fax: +43-1 514 36 6802
E-mail: pm-fom@osce.org
<http://www.osce.org/fom>

Dizajni dhe formëdhënia: Phoenix Design Aid, Danimarkë

ISBN 978-92-9234-632-4

- Udhëzuesi për kalimin në transmetimin digjital



Parathënie nga Dunja Mijatović

Të dashur lexues,

Udhëzuesi të cilin mbani në duart tuaja ka të bëjë me kalimin në transmetimin digjital, proces teknologjik i cili përmes televizionit dhe radios na mundëson qasje në një vëllim të informacionit, paraprakisht të paimagjinueshëm. Ky zhvillim gjithashtu bën të mundur ofrimin e informacionit për të tjerët më lehtë se kurrë më parë. Megjithatë, se deri në çfarë mase një teknologji e tillë shfrytëzohet për të mirën e njerëzve, se si mund të ndihmojë ajo në krijimin e një shoqërie pluraliste dhe në çfarë mase mund të kapërcejë hendekun informativ që ende ekziston në shumë zona të rajonit të OSBE-së varet shumë nga ligjet mbi mediat dhe politikat që rregullojnë një kalim të këtillë.

Nëse kryhet si duhet, kalimi në transmetimin digjital mund të mbrojë të drejtat e njeriut, përfshirë lirinë e masmediave dhe të drejtën për qasje në informacion. Nëse të gjitha palët e përfshira në proces bashkëpunojnë, duke përfshirë transmetuesit, prodhuesit dhe shoqatat e distributorëve dhe konsumatorëve, si rezultat do të kemi një peizazh të mediave që mbron pluralizmin e mendimit dhe lirinë e shprehjes. Qeveritë duhet të besojnë se duke ju ofruar qytetarëve të vet informacione pluraliste në këtë mënyrë vetëm mund të përforcojnë demokracitë e tyre. Personat e mirë-informuar bien vendime të mirë-informuara, e që janë themele të pazëvendësueshme mbi të cilat mund të ndërtohen demokracitë.

Ne tashmë jetojmë në epokën digjitale, kohë gjatë së cilës, me pjesëmarrjen e të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, ne mund të krijojmë kultura me të vërtetë demokratike. Ky udhëzues ka për qëllim të ofrojë ndihmë praktike për ato shtete anëtare të OSBE-së ku kalimi në transmetimin digjital është sfidë e viteve në vijim. Versioni i aktual është një përditësim i udhëzuesit të botuar në vitin 2009 nga paraardhësi im i shquar, Miklós Haraszti. Puna është porositur nga dy prej ekspertëve më të njohur ndërkombëtarë në këtë fushë, Dr. Katrin Nyman-Metcalf dhe Dr. Andrei Richter.

Ky udhëzues është një ekzaminim gjithëpërfshirës i çështjeve që do të shqyrtohen nga të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e kalimit në transmetimin digjital, duke përfshirë edhe sukseset dhe dështimet gjatë këtij procesi.

Siç e dimë të gjithë, revolucioni digjital ka shumë aspekte, kalimi nga transmetimi tokësor në atë digjital paraqet vetëm një prej tyre. Ndikimi i teknologjive të digjitalizimit mbi shoqërinë është universal. Mediat e reja kanë ndikuar mbi shoqërinë në një mënyrë edhe më dramatike se sa që këtë e bënë mediat elektronike vetëm disa dekada më parë. Me teknologjitë e reja të mediave, ne mund t'i qasemi dhe të konsumojnë çfarëdolloj mediash që duam, kudo, kurdo dhe në çfarëdo mënyre qoftë.

A ndryshojnë, këto teknologji të reja, pikëpamjet tona themelore rreth lirisë së mediave? Ndoshta edhe e bëjnë këtë. Liria e mediave dhe liria e shprehjes në epokën digjitale do të thotë që të gjithëve t'i ofrohet, e jo vetëm disa personave që posedojnë ose kontrollojnë mjetet tradicionale të komunikimit masiv, një gjasë për të përdorur këto teknologji të reja për pjesëmarrje, për bashkëveprim, për të ndërtuar dhe për të biseduar në lidhje me atë për të cilën ata duan të bisedojnë, qoftë kjo politika, çështjet publike apo kultura popullore. Me fjalë të tjera, digjitalizimi mund të na ofrojë të gjithëve mundësinë për të qenë pjesë e dialogut.

Përse është i rëndësishëm ky dialog? Përgjigjja është e thjeshtë: sepse ai i lejon njerëzit që të shprehen, të ndikojnë e ndoshta edhe të ndryshojnë mendjen e njerëzve tjetrit. Kur njerëzit bëjnë gjëra të reja nga gjërat e vjetra, kur ata prodhojnë, kur ata krijojnë, ata ushtrojnë lirinë e tyre përmes pjesëmarrjes së tyre në shoqëri.

Qeveritë kanë një rol të pazëvendësueshëm në këtë proces. Lehtësimi i qasjes në informacion dhe i shpërndarjen së tij çon deri tek një proces i vazhdueshëm i të mësuarit; ai gjithashtu hap rrugë për lidhje më të ngushta shoqërore dhe një marrëdhënie më të ngushtë në mes të atyre që prodhojnë informacione dhe atyre që i konsumojnë ato. Masmediat tradicionale, veçanërisht në vendet në tranzicion, janë duke kaluar nëpër një proces të transformimit. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se tranzicioni në transmetim digjital, nëse zhvillohet në frymën e lirisë së mediave, mund të çojë në diversitet më të madh të shërbimeve të mediave, përfshirë transmetimin e të dhënave interaktive, televizionit të definicionit të lartë,

programimit më të shënjestruar të paguaj-për-të-shikuar dhe interesimeve të veçanta, si dhe tregtisë elektronike.

Më shumë frekuenca në dispozicion përmes transmetimit digjital donë të thotë që mungesa e spektrit nuk mund të paraqitet më gjatë si arsytimi kryesor për rregullimin/kontrollimin e rreptë të mediave elektronike nga ana e qeverisë. Me riorganizimin radikal të komunikimit dhe peizazhit medial përmes teknologjive të reja, supozimet tradicionale rregullative janë vënë në pikëpyetje, dhe në shumë raste rregullat e vjetra janë bërë kontraproduktive. Në një epokë të ndryshimit të shpejtë dhe konvergjencës teknologjike, kontrolli i qeverisë mbi mediat është gjithnjë e më i padrejtë, i pambrojtshëm dhe, në fund të fundit, i paqëndrueshëm.

Caku ynë, dhe qëllimi i këtij udhëzuesi është që të gjejë rrugët për të përforcuar lirinë e mediave në epokën digjitale. Deri më sot, niveli i lirisë dhe pluralizmit të mediave në tërë rajonin e OSBE-së tregojnë dallime të rëndësishme. Edhe pse në përgjithësi më tepër informacione janë në dispozicion dhe ato janë më lehtë të arritshme se më parë, legjislacioni i ri dhe masat kufizuese në shumë vende pengojnë mundësitë që mund të ofrojnë mediat e reja dhe kalimi në transmetimin digjital.

Ky udhëzues është një produkt organik - i cili duhet të përditësohet dhe rishikohet nëse këtë e kërkojnë rrethanat. Nëse në çfarëdo kohë keni pyetje, sugjerime apo komente, ju lutemi që ta kontaktoni Zyrën tonë.

Ju dëshirojmë lexim të frytshëm,

Dunja Mijatović
Vienë, nëntor 2010

Përgatitur nga

Dr. Katrin Nyman-Metcalf, Profesoreshë dhe Kryesuese e degës së shkencave Juridike dhe të Teknologjisë, pranë Universitetit të Teknologjisë në Talin, eksperte e ligjit mbi komunikimin (katrinmetcalf@hotmail.com)

dhe

Dr. Andrei Richter, Profesor i Fakultetit të Gazetarisë pranë Universitetit Shtetëror të Moskës, ekspert mbi ligjet për media dhe telekomunikacion (richter.andrei@gmail.com)

Porositur nga

Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave
Përditësuar dhe publikuar në nëntor të vitit 2010

Përmbajtja

| | | |
|-------------|--|----|
| I. | Përmbledhje Ekzekutive | 9 |
| II. | Çka duhet bërë dhe çka nuk duhet bërë gjatë Procesit të kalimit në transmetimin digjital ... 17 | |
| III. | Rekomandime | 21 |
| IV. | Terminologjia | 27 |
| V. | Udhëzuesi për Digjitalizim | 33 |
| 1. | Hyrje | 34 |
| 1.1 | Përse digjitalizim? | 34 |
| 1.2 | Gjendja ndërkombëtare juridike | 35 |
| 1.3 | Gjendja aktuale në Europë | 38 |
| 1.4 | Përmbajtja dhe qëllimi i këtij Udhëzuesi | 39 |
| 2. | Çështjet e infrastrukturës: Si të shmangët monopolizimi | 40 |
| 2.1 | Ligji mbi konkurrencën dhe digjitalizimi..... | 40 |
| 2.2 | Qasja në objektet e transmetimit..... | 43 |
| 2.3 | Rekomandimet e Këshillit të Europës mbi pluralizmin e mediave..... | 46 |
| 2.4 | Përqendrimet | 48 |
| 2.5 | Përzgjedhja e transmetuesve..... | 50 |
| 3. | Skema programore në epokën digjitale: | |
| | Si të shmangët monopolizimi | 54 |
| 3.1 | Pluralizmi i përmbajtjes | 54 |
| 3.2 | Detyrimet e përmbajtjes (programore) | 59 |

| | |
|--|-----|
| 4. Shërbimi Publik i Transmetimit në epokën digjitale | 61 |
| 5. Strategjia: Procesi i planifikimit | 67 |
| 5.1 Plani | 67 |
| 5.2 Pjesëmarrja e publikut në planifikimin për digjitalizim | 70 |
| 5.3 Ndihma për publikun | 72 |
| 5.4. Legjislacioni..... | 74 |
| 6. Audiencia: Çështjet sociale dhe ekonomike | 78 |
| 6.1 Çështjet sociale dhe ekonomike dhe qasja në transmetim | 78 |
| 6.2 Pluralizëm dhe jo vetëm numër i madh i kanaleve | 80 |
| 6.3 Subvencionimi i pajisjeve marrëse | 80 |
| 6.4 Obligimi i Shërbimit Universal | 84 |
| 6.5 Ndërveprimi | 85 |
| 6.6 Mbrojtja e konsumatorit | 88 |
| 7. Transmetuesit: Çështjet ekonomike dhe ato teknike | 89 |
| 7.1 Investimet për digjitalizim | 89 |
| 7.2. Platforma e transmetimit | 94 |
| 7.3 Të ardhurat e transmetuesve..... | 95 |
| 7.4 Ndihma shtetërore..... | 96 |
| 8. Rregullatori: Çështjet e licencimit | 100 |
| 8.1 Procesi i licencimit | 100 |
| 8.2 Shembuj të licencimit digjital | 102 |
| 8.3 Roli i autoritetit rregullator | 106 |
| 8.4 Moratoriumet..... | 109 |
| 8.5 Transmetimi shtetëror | 110 |
| 8.6 Ndërprerja e transmetimit analog | 112 |
| VI. Shtojcë. Aktet përkatëse ndërkombëtare | 115 |



I. Përmbledhje Ekzekutive

Si mund të përfitojnë mediat e lira nga digjitalizimi

Transmetimi digjital është një mënyrë e ndryshme e dërgimit të sinjaleve, e paketimit të sinjalit që mbart përmbajtje të transmetuar të transmetimit, dhe të pranimit dhe deshifrimit të sinjaleve. Televizioni digjital mund të bart shumë më shumë kanale se sa ai analog dhe do të lirojë spektër i cili mund të shfrytëzohet për një sërë shërbimesh.

Në këtë mënyrë digjitalizimi krijon mundësi për rrjedhën e lirë të informacionit dhe një mjedis pluralist të mediave. Nga pikëpamja e lirisë së mediave, teknologjia e re do të lejojë audiencën që të kërkoj dhe të pranoj më shumë informacione dhe ide nëpërmjet medias transmetuese. Ajo gjithashtu mund t'i ofrojë transmetuesit më shumë mundësi për t'i dhënë informacione publikut.

Për të arritur këtë, procesi i kalimit në transmetim digjital duhet të bazohet në ligj dhe politikat mbi media të cilat mbrojnë dhe përforcojnë lirinë e shprehjes, lirinë e mediave dhe qasjen në informacione. Përpos kur rregullat dhe parimet e caktuara merren parasysh nga qeveritë dhe rregullatorët kombëtar, ekziston një rrezik i madh për efektet negative të kalimit në televizion digjital, duke përfshirë monopolizimin e mëtejshëm të tregut të medias nga ana e aktorëve shtetëror apo të tjerë, më pak pluralizëm të mediave, barriera të reja për diversitetin kulturor dhe gjuhësor dhe për lëvizjen e lirë ndërkombëtare të informacionit.

Procesi i digjitalizimit të transmetimeve është në vazhdim e sipër në tërë botën. Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (BNT - ITU) ka vendosur 2015-ën si vitin e ndërprerjes së transmetimit televiziv analog në rajon, në të cilin është përfshirë edhe Europa.

Shtetet mbajnë përgjegjësi për të gjitha çështjet rreth lirisë së mediave gjatë digjitalizimit

Aktualisht, digjitalizimi i televizionit udhëhiqet nga qeveritë që miratojnë plane digjitalizimi dhe vendosin afatet kohore për kalimin nga njëri sistem në tjetrin. Duke e ndërprerë sistemin ekzistues analog të transmetimit, qeveritë dhe rregullatorët kombëtar inkurajojnë sinjalin digjital televiziv dhe iu ofrojnë njerëzve një përzgjedhje më të madhe të opsioneve të përballueshme digjitale.

Çështjet sociale dhe ekonomike

Çështje të rëndësishme sociale dhe ekonomike janë të ndërlidhura me transmetimin digjital. Është e rëndësishë thelbësore që të merret një këndvështrim i qytetarëve, në mënyrë që të merremi me njerëzit, e jo me territoret. Shtetet duhet të sigurojnë qasje universale në masmedia, duke përfshirë grupet minoritare dhe ato të pafavorizuara. Grupet e cenushme mund të kenë nevojë për mbështetje të veçantë, siç është p.sh. asistenca për blerjen e pajisjeve për transmetimin digjital. Rregullat rreth asistencës duhet t'i përshtaten secilit vend specifik.

Është e rëndësishme që njerëzit të informohen në lidhje me dobitë e digjitalizimit. Në një plan digjitalizimi, gjithashtu duhet të merren parasysh çështjet e mbrojtjes së konsumatorit.

Kushtet e rrepta duhet t'i pengojnë kompanitë, të cilave iu janë dhënë të drejtat për transmetim të shërbimeve digjitale, që të bartin shpenzimet tek publiku, duke imponuar kontrolle të çmimeve për shërbimet e reja.

Pluralizmi i mediave dhe digjitalizimi

Pluralizmi i mediave ndikohet negativisht nga dominimi i transmetuesve shtetërorë, kur transmetuesit drejtohen si mjete propagandistike, dhe kur ata futen në konkurrencë të padrejtë me kompanitë private. Një abuzim i tillë i lirisë së mediave duket se merr një nxitje gjatë procesit të kalimit në transmetimin digjital.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se procesi i licencimit duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, duke përfshirë

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

arsyetimin e duhur nga autoriteti licencues rreth vendimeve të veta, me rastin e mohimit të një licence për transmetim

Operatorët e licencuar duhet të jenë të detyruar, gjithashtu edhe përmes rregullave strikte, që të ofrojnë një gamë të kanaleve digjitale që i shërbejnë më së miri një shumëllojshmërie të mendimeve.

Digjitalizimi i cili do të çojë në më shumë zgjedhje fillimisht çon drejtë rreziqeve të përqendrimit, rreziqe këto të cilat duhet të shqyrtohet sipas ligjeve të konkurrencës. Në disa situata, përqendrimi mund të pranohet nëse kombinohet me garanci për një pluralizëm të pikëpamjeve. Është e nevojshme mbikëqyrja e Rregullatorit.

Fakti që pajisjet e reja marrëse (set-top kutitë - set-top boxes) do të jenë të nevojshme për publikun, si dhe pajisjet e reja transmetuese për transmetuesit, mund të çojë në më pak zgjedhje gjatë periudhës kalimtare. Metoda e zgjedhur për të futur set-top kutitë duhet - në një mënyrë transparente - të zvogëlojë dhe të shkurtojë humbjen e përkohshme të zgjedhjes.

Moratoriumi për dhënien e licencave për transmetim është një hap i domosdoshëm në procesin e kalimit në transmetimet digjitale pasi që ai i lejon autoritetet rregullatore për të bërë plane dhe të përdorin spektrin në mënyrë efikase. Megjithatë, ka raste kur një moratorium përdoret për qëllime politike, për të mbajtur transmetuesit e pavarur jashtë transmetimit. Kjo duhet të parandalohet.

Ekziston shqetësimi se me kalimin në sistemin digjital, transmetuesit e vogël lokal privat, që operojnë përmes-ajrit (analog), nuk do të mund të përballojnë hyrjen në treg pa ndihmën e jashtme. Masat e ndryshme rregullatore janë miratuar në Europë për të garantuar qasje në rrjetet digjitale nga transmetuesit ekzistues përmes-ajrit dhe nga ofruesit e përmbajtjes. Nga ofruesit e rrjetit mund të kërkohet që të ofrojnë kushte të drejta, transparente dhe jo-diskriminuese. Nga ofruesit e rrjetit, si dhe nga operatorët e platformës, mund të kërkohet që të publikojnë një listë të çmimeve për shërbimet e ofruara teknike ofruesve të përmbajtjes.

Monopolizimi mund të paraqet problem në nivelin e ofruesve të programit, e në veçanti për ofrimin e shërbimeve. Dispozitat rreth qasjes duhet të garantojnë që ekzistenca e vetëm një operatori të rrjetit nuk do të shkaktoj probleme. Të gjitha kërkesat e bëra në mirëbesim për qasje duhet të përmbushen në baza komerciale.

E ardhmja e Shërbimit Publik të Transmetimit në epokën digjitale

Shërbimi publik i transmetimit (ShPT) mbetet një nga veglat themelore të demokracive. Duke ofruar raportim objektiv të lajmeve, një sërë opinionesh pluraliste dhe programe me cilësi të lartë, ShPT është i pazëvendësueshëm në sigurimin e lirisë dhe transparencës së zgjedhjeve, në luftimin fjalimeve të urrejtjes dhe mbrojtjen e kulturave të pakicave në një vend.

Në epokën digjitale, rëndësia e shërbimit publik të transmetimit pa reklama komerciale, vetëm sa vjen e rritet. Me të vërtetë, teknologjitë digjitale ofrojnë mundësinë e zgjerimit të spektrit të programeve në dispozicion të ShPT. Me interes për ne këtu është zgjerimi digjital i ShPT, që është parë në Mbretërinë e Bashkuar.

Modeli i zakonshëm në Europë është ai i zhvillimit të disa multipleksëve, duke përfshirë pakot në dispozicion pa pagesë për të gjithë ata që kanë pajisje të përshtatshme marrëse. Pakot pa pagesë përfshijnë një shumëllojshmëri të kanaleve që plotësojnë nevojat e ndryshme të transmetimit, dhe pakoja gjithmonë “duhet të bart” kanalet e SHPT. Pluralizmi është i rëndësishëm me këtë rast, dhe jo vetëm një numër i madh i kanaleve. Qasja në informata dhe reduktimi i pabarazive nuk vijnë automatikisht me një numër të madh kanalesh - është e rëndësishme që të ketë një shumëllojshmëri të vërtetë kanalesh. Prandaj, ofrimi i SHPT, me pluralizmin e vet të brendshëm të detyrueshëm, duhet të jetë pjesë integrale e reformës së digjitalizimit.

Licencimi

Një nga parimet kryesore në transmetimin digjital është se licencat për objektin dhe pajisjet e transmetimit (platformën) dhe përmbajtjen programore

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

duhet të jenë të ndara. Mënyra e përzgjedhjes së transmetuesve që do të jenë pjesë e multipleksëve digjitale, veçanërisht përbërja e pakos pa pagesë (sociale), duhet të mbetet transparente dhe e hapur ndaj kritikës publike.

Nëse monopoli dhe problemet e dominimit tashmë ekzistojnë, këto kanë prirje të rriten edhe më shumë me digjitalizimin - ata që tashmë “kanë” do të kenë edhe më shumë. Kjo do të thotë se çështjet e tilla duhet të adresohen në këtë proces. Pronësia dhe rregullat e lidhura me dhënien e informacioneve të dizajnuara për të kufizuar përqendrimin e mediave bëhen edhe më të rëndësishme.

Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore (PEAR - EPRA) vë në dukje se sa i rëndësishëm është rregullimi i qasjes në kapacitetin e ri teknik. Me këtë rast, roli i autoriteteve kombëtare të transmetimit (ARrK) mbetet vendimtar. Në caktimin e kapacitetit teknik, duhet të përvetësohen gjerësisht “Procedurat e konkursit të bukurisë” për dalim nga ankandet të cilat përdoren më shpesh kur bëhet ndarja e spektrit për përdorim të telekomit. Sidoqoftë, e drejta për të transmetuar kanale të televizionit digjital tokësor (TDT) përmes antenës duhet të jepet nën kushte të rrepta.

Mbulimi universal dhe qasja e lirë në shërbimet digjitale audiovizuale e të gjithë qytetarëve është edhe një parim i cili duhet të respektohet kur bëhet licencimi për procesin e kalimit në transmetimet digjitale. Potenciali i televizionit digjital është që të sjellë shoqërinë e informacionit në çdo shtëpi. Prandaj, është e rëndësishme që të shmangen përjashtimet, dhe në veçanti përjashtimi nga shërbimet pa pagesë dhe programet televizive trans-nacionale.

Pajisjet dhe infrastruktura

Sa i përket pajisjes, në vend të mbështetjes shtetërore apo krahas saj, kjo fushë inkurajohet që të ofroj lloje të ndryshme të pajisjeve me kosto të ulët. Shtetet e hershme në digjitalizim kanë promovuar konkurrencën dhe në këtë mënyrë kanë arritur tek set-top kuti të lira, si dhe tek llojet më të avancuara të pajisjeve.

Megjithatë, sigurimi i ndërveprimit në mes të grupeve të ndryshme të pajisjeve është një detyrë e vazhdueshme. Ndërveprimi promovohet edhe nga Bashkimi Europian, pasi kjo e bën tregun Europian më tërheqës për prodhuesit. Standardet janë të paramenduara që të udhëhiqen nga kjo industri. Operatorët e platformës digjitale duhet të përpiqen që të zbatojnë ndërthurjen e hapur të programeve aplikative (open application programme interface - API) e cila është në përputhje me Standardet Europiane dhe lejon migrimin prej njërit në sistemin tjetër.

Shpenzimet për ndërtimin e një infrastrukture dhe kush duhet të paguajë për të, paraqesin sfidë të vërtetë. Rreziku i falimentimit të transmetuesit do të ndikojë negativisht në pluralizmin dhe shumëllojshmërinë. Partneriteti mes qeverive, transmetuesve, operatorëve të rrjetit dhe industrisë është një mënyrë e mundshme e financimit. Modeli do të varet nga struktura e sektorit të transmetimit në vendin përkatës.

Kostot fillestare janë të larta, dhe rritja e atraktivitetit të transmetimit digjital vjen vetëm pas një kohe dhe kostoje të caktuar. Nga transmetuesit privat pritet që të bartin një pjesë të koston, e që është e arsyeshme, por duhet pranuar se një stimulim i caktuar mund të jetë i nevojshëm. Fakti që të ardhurat nga reklamat komerciale në Europë në përgjithësi kanë pësuar rënie dhe tregu është mjaft jo tërheqës, paraqesin një problem tjetër.

Infrastruktura ekzistuese duhet të shfrytëzohet sa më shumë që të jetë e mundur. Ndarja e infrastrukturës është një mënyrë tjetër për të ulur shpenzimet. Kjo gjithashtu sjell përfitime edhe për mjedisin.

Digjitalizimi nuk duhet të lejohet të përforcojë ose të shkaktojë dominimin e pronarit ose operatorit të objekteve dhe pajisjeve të transmetimit. Rregullat që garantojnë qasjen në to janë vendimtare. Privatizimi i tyre dhe ndarja strukturore janë të rëndësishme, dhe digjitalizimi nuk duhet të përdoret për të vonuar këto zhvillime.


Planifikimi për digjitalizim

Planifikimi për digjitalizim është i rëndësishëm dhe duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Fillimisht duhet dhënë përgjigje disa pyetjeve themelore, në mënyrë që të jeni në dijeni nëse vendi është gati për digjitalizim. Duhet të ekzistoj një rend transparent në sektorin e transmetimit, pluralizëm dhe diversitet i transmetimit dhe një rregullator funksional i pavarur.

Hapi i parë zakonisht është miratimi (nga qeveria apo parlamenti) i një plani të digjitalizimit. Transmetuesit dhe rregullatori duhet të jenë të përfshirë në përgatitjen e planit, i cili do të përcaktojë ndryshimet ligjore të domosdoshme për të lejuar dhe inkurajuar digjitalizimin. Të gjitha moratoriumet e përkohshme ose përqendrimet kalimtare të burimeve që mund të jenë të nevojshme duhet të paraqiten në plan. Para miratimit të tij, projekt-planet duhet të jenë të hapura ndaj kritikave publike, civile dhe profesionale. Mund poashtu të ketë nevojë për një organ të veçantë që do të merrej me digjitalizimin.

Televizioni analog nuk duhet të ndërpritet deri sa të jetë arritur një depërtim pothuajse universal i sinjalit digjital. Procesi i kalimit duhet të udhëhiqet nga tregu, por kjo të bëhet me koordinim. Përderisa teknologjia MPEG 2 është përdorur më së shpeshti në ditët e para të digjitalizimit në ato vende që kanë kaluar nëpër këtë proces së pari, tani kryesisht përdoret teknologjia MPEG 4. Ekzistojnë përparësi nëse menjëherë shkohet me MPEG 4; megjithatë, kjo është e mundshme vetëm në qoftë se kështu vendoset në fillim të procesit.

II. ÇKA DUHET BËRË DHE ÇKA NUK DUHET BËRË
POLITIKËBËRËSIT DHE PUBLIKU GJATË PROCESIT TË
KALIMIT NË TRANSMETIMIN DIGJITAL



- Procesi i kalimit në transmetimet digjitale duhet bazuar në ligjet dhe politikat mbi mediat që do të mbrojnë të drejtat e njeriut, duke përfshirë lirinë e shprehjes, lirinë e mediave dhe të drejtën për qasje në informacion.
- Duhet zhvilluar një kornizë legjislative dhe strategji për transmetimin digjital të hartuar nën vëzhgimin e vazhdueshëm të publikut. Strategjia e miratuar duhet të çojë kah legjislacioni i ri i cili do të prezantohej dhe miratohej nga parlamenti, në vend të marrjes së vendimeve administrative ose dekreteve presidenciale.
- Duhet ofruar një plan të digjitalizimit, të krijuar nga një organ kompetent (Ministria, rregullatori) i cili përfshin të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë transmetuesit dhe ofruesit e shërbimeve.
- Duhet përfshirë autoritetet kombëtare të transmetimit (ose rregullatorët kombëtarë) në planifikimin dhe zbatimin e kalimit në sistemin digjital.
- Duhet shmangur përjashtimin e konsumatorëve, dhe në veçanti përjashtimin nga shërbimet pa pagesë dhe programet televizive transnacionale.
- Duhet caktuar me kujdes datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në mënyrë që asnjë pjesë e popullatës të mos përjashtohet nga televizioni digjital tokësor.
- Duhet marrë parasysh çështjen e mbrojtjes së konsumatorëve, siç është mundësia për të migruar në mes të operatorëve të ndryshëm të shërbimit dhe përdorimit të pajisjeve ndërvepruese.
- Duhet ofruar fushata për informimin e publikut mbi digjitalizimin.
- Duhet kërkuar nga pronarët e objekteve dhe pajisjeve të transmetimit që të ofrojnë shërbim universal.
- Duhet prezantuar një moratorium mbi dhënien e licencave për transmetime, pasi që ai iu lejon autoriteteve rregullatore që të bëjnë plane dhe të përdorin spektrin në mënyrë efikase.
Mos shfrytëzoni moratoriumin për qëllime politike për të mbajtur transmetuesit e pavarur jashtë transmetimit.
- Duhet garantuar qasjen në rrjetet digjitale transmetuesve analog ekzistues. Transmetuesit të Shërbimit Publik kombëtar (ShPT), duhet t'i garantohet një vend.
- Duhet shfrytëzuar digjitalizimin për zgjerimin e spektrit të programeve në dispozicion të ShPT. Zgjerimi i ShPT duhet të ketë vlerë të qartë të shërbimit publik.

- Duhet mbajtur të ndara licencat për objektet dhe pajisjet transmetuese (platformën) dhe ato për përmbajtjen programore. Mos lejoni që licencimi të bëhet një proces i njëanshëm dhe jo-transparent gjatë digjitalizimit.
- Duhet siguruar që procedura për përzgjedhjen e përbërjes së pakos pa pagesë (sociale) të mbetet transparente dhe e hapur për kritika publike.
- Duhet marrë parasysh partneritetet mes qeverive, transmetuesve, operatorëve të rrjetit dhe industrisë përkatëse si një mënyrë e mundshme e financimit të digjitalizimit.
- Duhet inkurajuar njerëzit që të fillojnë planifikimin për kalimin në sistemin digjital dhe të mos e lënë këtë punë për momentin e fundit.
- Duhet siguruar njerëzit që televizionet analoge do të bëhen të papërdorshme dhe që shpenzimet për kalimin në televizion digjital janë të arsyeshme.
- Duhet përqendruar në publikun, dhe në mënyrë të qartë t'i komunikohen shikuesve arsyet për kalimin në sistemin digjital por edhe për kohën e implementimit të tij.
- Duhet të përfshihen të gjithë aktorët kryesor të sistemit, transmetuesit, prodhuesit, distributorët, shoqatat e konsumatorëve. Bashkëpunimi është thelbësor për arritjen e suksesit të informimit.

- Mos i besoni asaj se sa më shumë kanale digjitale barazohet me pluralizmin e mendimit dhe lirinë e shprehjes.
- Mos e injoroni nevojën për të ofruar mbështetje të veçantë për grupet e cenueshme, siç është p.sh. asistimi për blerjen e pajisjeve për transmetimin digjital.
- Mos lejoni që ekzistenca e vetëm një operatori të rrjetit të shkaktojë probleme për lirinë e konkurrencës në mes të transmetuesve dhe ofruesve të tjerë të përmbajtjes programore.
- Mos planifikoni asnjë ndihmë shtetërore e cila do t'i ofronte përparësi të padrejtë një operatori komercial ndaj të tjerëve. Qeveritë duhet të përmbahen nga lehtësimi i kalimit në sistemin digjital vetëm për transmetuesit shtetërorë, në ato vende ku ata ende ekzistojnë.
- Mos injoroni neutralitetin teknologjik në lidhje me platformat e aplikimit; bëhuni fleksibil.
- Mos e inkurajoni hedhjen e panevojshme të TV pajisjeve.
- Mos bëni panik, bëni tranzicion të qetë dhe të balancuar: digjitalizimi është sfidë. Bëjeni këtë!

Digjitalizimi nuk do të zgjidhë problemet kronike në sektorin e transmetimit, siç janë p.sh.: ndërhyrja e qeverisë, monopolet, problemet strukturore, rregullatorët apo transmetuesit e dobët të shërbimit publik. Problemet e tilla duhet të zgjidhen para digjitalizimit, dhe paralelisht me planifikimin për digjitalizim.

III. Rekomandime

Liria dhe pluralizmi i mediave

- Në procesin e kalimit në sistemin digjital, qeveritë dhe rregullatorët kombëtarë duhet të ndërmarrin hapa për të rritur pluralizmin e përmbajtjes programore dhe për të parandaluar përqendrimin e pronës në transmetim.

Çështjet sociale dhe ekonomike

- Interesat e publikut, si dhe interesat dhe kufizimet e të gjitha kategorive të transmetuesve, veçanërisht atyre jo-komercial, rajonal dhe transmetuesit lokal, duhet të merren parasysh në procesin e kalimit në sistemin digjital.
- Qeveritë dhe rregullatorët kombëtarë duhet të jenë veçanërisht vigjilentë që të sigurojnë respektimin e mbrojtjes së të miturve dhe të dinjitetit njerëzor dhe mos-nxitjen për dhunë dhe urrejtje. Zhvillimi i mjeteve teknike për kontroll prindëror nuk duhet të zvogëlojë përgjegjësinë e transmetuesve dhe ofruesve.
- Grupet e cenueshme duhet të përkrahen në mënyrë që ato të mund të kenë qasje në pajisjet e nevojshme marrëse. Vendimet nëse disa grupe pranojnë pajisje të subvencionuara, mbi ç' baza dhe si, duhet të bëhen në bazë të situatës në secilin vend përkatës.

Shërbimi publik i transmetimit

- Teknologjitë e reja duhet t'i shërbejnë qëllimeve të përgjithshme të qeverisë për promovimin e transmetimit digjital dhe atij publik. Një mundësi e tillë, megjithatë, nuk duhet të paraqesë konkurrencë të padrejtë për transmetuesit privat dhe kështu të parandalojë zhvillimin e sektorit të pavarur të televizionit. Zgjerimi i ShPT duhet të konsiderohet si i dallueshëm dhe të ketë vlerë të qartë të shërbimit publik.

- Me rastin e përzgjedhjes së pakove programore për të shkuar në platforma, diversiteti (shumëllojshmëria) dhe pluralizmi janë thelbësor. Shërbimit Publik kombëtar të Transmetimit, do t'i garantohet një vend dhe duhet të zbatohen rregullat e përfshirjes së domosdoshme.
- Siç sugjerohet nga Rekomandimi (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, obligimet e “përfshirjes së domosdoshme” të vendosura nga shtetet anëtare duhet të jenë të arsyeshme; ato duhet të jenë proporcionale dhe transparente në pikëpamje të objektivave të interesit të përgjithshëm të përcaktuara në mënyrë të qartë, dhe mund, aty ku është e përshtatshme, të kërkojnë një dispozitë për shpërbim proporcional.

Reformat legjislative, licencimi

- Procesi i kalimit në transmetimet digjitale duhet të bazohet në ligjet dhe politikat mbi mediat që do të mbajnë garanci thelbësore për ruajtjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e shprehjes, lirinë e mediave dhe të drejtën për qasje në informim.
- Shtetet duhet të zhvillojnë një kornizë legjislative dhe strategjinë për transmetimet digjitale. Një strategji e tillë duhet të kërkojë të nxisë bashkëpunimin në mes të operatorëve, platformave komplementare, ndërveprimin e dekoderëve dhe disponueshmërinë e një shumëllojshmërie më të gjerë të përbajtjes programore, duke përfshirë edhe shërbimet televizive ekzistuese pa pagesë.
- Strategjia duhet të hartohet nën vëzhgimin e vazhdueshëm të publikut me qëllim që të garantoj pluralizmin e shërbimeve të transmetimit dhe të qasjes së publikut në një shumëllojshmëri të zgjeruar të programeve cilësore. Strategjia e miratuar duhet të çojë në legjislaionin e ri i cili prezantohet dhe miratohet nga ana e parlamentit, e jo përmes vendimeve qeveritare ose dekreteve presidenciale.
- Duhet të ekzistojë një plan i digjitalizimit, i bërë nga një organ kompetent (Ministria, rregullatori) i cili do të përfshinte të gjitha palët e interesuara, përfshirë edhe transmetuesit dhe ofruesit e shërbimeve.
- Duhet të ekzistojë një proces i rregull-marrjes publike dhe fushata për informimin e publikut.

- Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet një procesi të paanshëm dhe transparent të licencimit.
- Licencat për programet dhe ato për transmetimin teknik do të jenë të ndara nga njëra-tjetra, të dyja të lëshuara nga një rregullator i pavarur.
- Çfarëdo ndihme shtetërore duhet të jetë e planifikuar me kujdes në mënyrë që të mos i japë përparësi të padrejtë një operatori komercial ndaj të tjerëve. Liberalizimi dhe privatizimi në fushën e mediave dhe komunikimit duhet të shkojë paralelisht me përgatitjet për digjitalizim.

Pajisjet dhe infrastruktura

- Autoritetet kombëtare të transmetimit (ose rregullatorët kombëtarë) duhet të jenë gjithnjë e më shumë të përfshirë në procesin e kalimit në sistemin digjital, sepse kompetenca e tyre teknike, ekonomike dhe ligjore është thelbësore në hartimin e kornizës më të përshtatshme rregullative.
- Pavarësia e organeve rregullatore dhe atyre të licencimit është jetike për kryerjen e funksioneve të tyre dhe kjo duhet të arrihet dhe të ruhet përmes ligjit dhe në praktikë.
- Qeveritë duhet të përmbahen nga lehtësimi i kalimit në sistemin digjital vetëm për transmetuesit shtetërorë, atje ku ata ende ekzistojnë.
- Ofruesit e objekteve dhe pajisjeve të transmetimit rekomandohen që të kenë një detyrim të shërbimit universal, i cili duhet të monitorohet nga një rregullator i pavarur.
- Rregullatori do të monitorojë rregullat për qasje në mënyrë që të lejojë kompanitë e ndryshme që të konkurrojnë, edhe në qoftë se numri i objekteve dhe pajisjeve të transmetimit është i kufizuar.
- Pajisjet duhet të jenë të ndërveprueshme. Standardet do të jenë të bëra nga tregu, por me mbikëqyrje të rregullatorit.

Planifikimi për digjitalizim

- Digjitalizimi nuk do të zgjidhë problemet kronike në sektorin e transmetimit, siç janë p.sh.: ndërhyrja e qeverisë, monopolet, problemet strukturore, rregullatorët apo transmetuesit e dobët të shërbimit publik.
Problemet e tilla duhet të zgjidhen para digjitalizimit, dhe paralelisht me planifikimin për digjitalizim.
- Duhet caktuar me kujdes datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në mënyrë që asnjë pjesë e popullatës të mos përjashtohet nga televizioni digjital tokësor. Data e mbylljes së transmetimeve të tilla, ndonëse në praktikë kjo i shtyn transmetuesit që të kenë një ritëm më të shpejtë drejt procesit të kalimit në sistem digjital të transmetimit, duhet të rishikohet në qoftë se paraqitet një rrezik i përjashtimit të tillë. Për këtë arsye, gjithashtu rekomandohet edhe monitorimi i mjedisit digjital.



IV Terminologjia¹

Observatori European Audiovizual në vitin 2004. Shih:
http://www.obs.ee.int/oea_publ/iris_special/2004_01.html, gjithashtu edhe Tranzicioni i TV digital: Fjalor nga
Komisioni Federal i Komunikimit SHBA, shih: <http://www.dtv.gov/glossary.html>

Transmetimi analog – e kodon informacionin e fotografisë dhe zërit të televizionit dhe e transmeton atë si një sinjal analog (të tillë në të cilin mesazhi i bartur nga sinjali i transmetimit është një funksion i ndryshimeve të qëllimshme në amplitudë dhe/ose frekuencë të sinjalit). Të gjitha sistemet paraardhëse të televizionit digjital (p.sh. NTSC) janë sisteme televizive analoge. Teknologjia analoge ka qenë në përdorim gjatë 50 viteve të fundit për të transmetuar sinjalet televizive konvencionale tek konsumatorët.

Ndërthurja e programeve aplikative (Application programme interface - API) – është një komponent kyç i një set-top kutie (shih më poshtë). Ajo përbën lidhjen me softuerin operativ të set-top kutisë, mbi të cilat janë bazuar programet aplikative. Për shkak se API është platformë softuerike për të gjitha aplikacionet e mëvonshme, një API i patentuar mund të përdoret për të kthyer një set-top kuti në një mjet për kufizimin e qasjes. Në qoftë se të dhënat teknike nga API mbahen sekrete, zhvilluesit e softuerit nuk do të jenë në gjendje që të ofrojnë ndonjë aplikacion të përshtatshëm, dhe këto do të mbeten jokompatible.

Komplementariteti – një shprehje për teknologji të ndryshme apo sisteme të tjera që i kontribuojnë tërësisë dhe që janë në gjendje për të vepruar së bashku.

Dekoderët – për shkak se një pjesë e konsiderueshme e programeve digjitale - dhe jo vetëm të televizionit me pagesë - janë të koduara/shifruara, kapaciteti i pajisjeve marrëse për të deshifruar këto sinjale është një aspekt i rëndësishëm. Kjo realizohet nëpërmjet përdorimit të dekodeve.

Dividenda digjitale - radio spektri i liruuar si rezultat i kalimit nga transmetimi analog në atë digjital.

Digjitalizimi – hapi i parë në procesin e transmetimit të televizionit digjital i kryer nga një shndërrues analog-në-digjital, i cili kodon sinjalin origjinal analog. Në kuptimin më të gjerë, digjitalizimi nënkupton procesin e shndërrimit të sistemit analog të transmetimit në një sistem digjital të transmetimit të televizionit dhe radios.

Udhëzuesi elektronik i programeve – një program aplikativ që është i bazuar në ndërthurjen e programit aplikativ (API) (shih më lart) në set-top kuti (shih më poshtë). Me qëllim që EPG-ja të funksionoj, ai duhet të jetë i ndërveprueshëm me API-në. EPG-ja përmban informata në kohë reale, që janë më gjithëpërfshirëse se ato të navigatorit bazik, mbi programet aktuale dhe të ardhshme të transmetuesve të cilët i mbulon. Duke përdorur EPG-në, shikuesit mund të kërkojnë historikun dhe informacionet shtesë në lidhje me programet. Ai gjithashtu mund të përmbajë edhe video sekuenca dhe fotografi.

Pa pagesë – transmetim i cili mund të pranohet nga çdokush me pajisje të përshtatshme, pa ndonjë pagesë të veçantë.

Televizioni me definicion të lartë (High definition television - HDTV) – ofron fotografi me rezolucion që ka mbi 700 linja vertikalisht dhe mbi 1000 pikselë (shih më poshtë) horizontalisht. Fotografia paraqitet në formatin 16:9. Në Europë ka pasur shumë pak progres drejt HDTV-së, sepse sistemi ekzistues i televizionit konsiderohet si i kënaqshëm.

Ndërveprimi – aftësia e pajisjeve ose makinave për të punuar së bashku me njëra-tjetrën dhe për të komunikuar në një gjuhë, në veçanti aftësia e softuerit dhe harduerit të prodhuar nga prodhues të ndryshëm që të punojnë së bashku.

Migrimi – API-të (shih më lart) që aktualisht janë në dispozicion dhe set-top kutitë përkatëse (shih më poshtë) duhet të bëhen që të mundësojnë pajtueshmërinë e tyre me produkte të reja, në mënyrë që set-top kutitë e vjetra të mos bëhen të papërdorshme.

Multipleksi (Multiplex - MUX) – bashkimi i disa rrjedhave të të dhënave për të formuar një rrjedhë të unifikuar, të cilat më vonë mund të ndahen përsëri.

Përfshirja e domosdoshme - detyrimi ligjor i kompanive të TV kabllor për të përfshirë në pakot e ofruara sinjalet analoge ose digjitale të transmetuesve lokal dhe publik.

Pikselë – në fakt ky është kombinim i dy fjalëve, “Picture” (Fotografi) dhe “Element.” Pikselët janë mostra të vogla të video informacionit, “katrorë të vegjël” që “duke i bashkuar” paraqesin një fotografi të plotë. Pikseli është fusha më e vogël që është e mundur të dallohet e fotografisë televizive dhe që mund të transmetohet nëpërmjet sistemit, dhe të shfaqet në një monitor.

Platforma e TV digjital – të gjitha komponentët teknike dhe teknologjike që janë të nevojshme për të sjellë programet nga prodhuesi tek konsumatori.

Pajisjet marrëse - çdo pajisje që është e nevojshme për të pranuar çfarëdo transmetimi

Autoriteti rregullator (ose Rregullatori) - Rregullatori i transmetimit zakonisht përfshin pushtetin për licencimin e transmetuesve, për të monitoruar nëse transmetuesit janë duke përmbushur detyrimet e tyre ligjore, dhe për të vendosur sanksione nëse ata dështojnë në përmbushjen e këtyre detyrimeve. Këtyre funksioneve tradicionale mund t'i shtohen edhe ato të organizimit dhe koordinimit të peizazhit transmetues.

Ofruesit e shërbimeve – janë kompanitë që i ofrojnë publikut një shërbim të komunikimit (rrjetet, sistemet e telekomunikacionit, internetin, e kështu me radhë). Ofruesit e shërbimeve zakonisht nuk janë përgjegjës për ndonjë përmbajtje të ofruar përmes shërbimit të komunikimit, por vetëm për ofrimin e sinjalit.

Set-top kutia (Kutia e mbivendosur) - pajisja e nevojshme për pranimin e televizionit digjital. Nga pamja e jashtme, kjo duket të jetë një pajisje tashmë e njohur e marrësit të televizionit satelitor, e cila është e lidhur me televizionin. Set-top kutia e mori emrin e vet nga pozita e saj e zakonshme e vendosjes mbi televizor - ajo gjithashtu referohet edhe si dekoderi marrës i integruar (IRD). Detyra e saj kryesore është që të dekompresoj dhe të deshifroj rrjedhën e të dhënave, në mënyrë që një sinjal normal audiovizual mund t'i dërgohet televizorit.

Spektri – një brez i radio frekuencave elektromagnetike që përdoren në transmetimin e radios, videos dhe të dhënave.

Standardet – futja e standardeve do të thotë arritja e marrëveshjeve ose përkushtimi për atë se cilat mund të jenë specifikimet e teknologjisë së re. Në Europë, shumica e këtyre standardeve janë hartuar dhe vendosur nga Grupi i VTD (Video transmetimit digjital)(DVB Group -Digital Video Broadcasting), një Konzorciumi i udhëhequr nga kjo industri i përbërë nga mbi 300 transmetues, prodhues, operatorë të rrjetit, zhvillues të softuerit, organe rregullatore dhe të tjerë, në më tepër se 35 shtete.

Televizioni tej-kufitar – një term i përdorur kryesisht në të Drejtën Europiane (BE dhe Këshill të Europës) për të shënuar programet televizive të cilat transmetohen përtej kufijve kombëtarë.

Objekti dhe pajisja e transmetimit – ndërtesat, pajisjet dhe sistemi i përdorur për të transmetuar sinjalet e komunikimit. Transmetimi mund të shfrytëzoj teknologji të ndryshme dhe objekti dhe pajisjet përfshijnë çfarëdo pajisjesh dhe objektivsh përkatëse (shtyllat, ndërtesat, etj.), që janë të nevojshme.


Pajisja e transmetimit – një koncept më i ngushtë se sa objekti dhe pajisjet e transmetimit, i cili përfshinë pajisjet aktuale siç janë antenat, kabllot ose të ngjashme.

Mbulimi universal – sinjali (i transmetimit ose komunikimeve tjera) që arrin tek pothuajse e tërë popullata e një zone të caktuar.

Obligimi i shërbimit universal – një shprehje juridike për detyrimin e shtetit për të siguruar që të gjithë kanë mundësi të kenë qasje në dhe të përdorin shërbime të caktuara që konsiderohen si thelbësore për të gjithë, pa marrë parasysh gjendjen e tyre ekonomike, pozitën gjeografike apo faktorët tjerë. Obligimi i shërbimit universal normalisht përfshin shërbimet si energjia, uji, si dhe të komunikimin si telekomunikacioni dhe disa shërbime të transportit. Obligimi i shërbimit universal shpesh kryhet nga kompanitë private si kusht i licencës, por është përgjegjësi e shtetit për t'u siguruar që shërbimet e përfshira në këtë detyrim ofrohen me të vërtetë për të gjithë.

Video-sipas-kërkesës (Video-on-demand) - do të thotë se programet e kërkuara nuk transmetohen menjëherë, por ato transmetohen përmes transmetimeve të shtyra; shikuesit nuk mund të shikojnë programe ose filma posa t'i porosisin ato, por atyre u jepet qasje në zgjedhjen e tyre në një kohë të caktuar.

Udhëzuesi për Digjitalizim



Kapitulli 1. Hyrje

Ky udhëzues ka të bëjë me digjitalizimin e transmetimeve, sidomos të transmetimit të televizionit, dhe shpjegon çështjet e ndryshme që duhet të merren parasysh kur planifikohet digjitalizimi. Udhëzuesi shënjestron të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë proces, qofshin ata ligjvënës, rregullator që zbatojnë rregullat, transmetuesit, profesionistë mediash apo një qytetar që është pjesë e audiencës së transmetimit.

Digjitalizimi është një proces i vazhdueshëm i cili do të prek të gjitha vendet me kalimin e kohës - dhe është pasojë e vendimeve nga organi global përgjegjës për komunikim, Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit- BNT (the International Telecommunications Union - ITU)).

Ekzistojnë dobi të shumta nga transmetimet digjitale, siç është mundësia për të vendosur shumë më tepër kanale në spektrin e radio frekuencave dhe për të ofruar një cilësi më të lartë të transmetimit. Prandaj digjitalizimi është pozitiv për lirinë e mediave. Megjithatë, është e rëndësishme që procesi të planifikohet në mënyrën e duhur, pasi ka një numër sfidash që duhet të tejkalohen në mënyrë që të shmangen pasojat negative të këtij ndryshimi të madh në peizazhin e transmetimit.

Ky udhëzues ndihmon në shpjegimin se si të planifikohet procesi i digjitalizimit dhe se si të përkujdesemi që ai të ndikoj pozitivisht në lirinë e mediave, si dhe në zgjedhjen dhe cilësinë në dispozicion të publikut.

1.1 Përse të digjitalizojmë?

Digjitalizimi do të thotë një mënyrë e ndryshme për të dërguar sinjale, e paketimit të përmbajtjes së transmetuar gjatë transmetimit të saj dhe një mënyrë tjetër (dhe pajisje) për marrjen dhe deshifrimin e sinjalit. Televizioni digjital mund të bart shumë më shumë kanale se sa ai analog dhe do të liroj spektrin i cili mund të përdoret për një varg shërbimesh, siç janë p.sh.: shërbimet e televizionet në definicion standard ose të lartë, internet pa tela të brezit të gjerë (wireless broadband), televizionet lokale, shpërndarës pa tela në shtëpi (wireless home hubs) dhe të tjera.

Në këtë mënyrë digjitalizimi sjell mundësi të reja për masmedia të lira dhe pluraliste. Nga pikëpamja e lirisë së mediave, teknologjia e re mund të lejojë shikuesit që të kërkojnë dhe të pranojnë më shumë informacione dhe ide. Digjitalizimi gjithashtu mund t'ju ofrojë transmetuesve më shumë mundësi për t'i ofruar informacione publikut.

Por për të arritur këtë, procesi i kalimit në transmetimet digjitale duhet të bazohet në ligjin dhe politikat mbi mediat që do të përmbajnë garanci thelbësore për ruajtjen dhe përforsimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e shprehjes, lirinë e mediave dhe qasjen në informata. Nëse rregullat dhe parimet e caktuara nuk merren parasysh nga qeveritë dhe rregullatorët kombëtar, ekziston një rrezik i madh për efekte negative të kalimit në televizion digjital, siç janë p.sh.: monopolizimi i mëtejshëm i tregut medial nga ana e aktorëve shtetëror apo të tjerë, më pak pluralizëm i mediave, barriera të reja për diversitetin kulturor dhe gjuhësor dhe për rrjedhën ndërkombëtare të informacionit.

Procesi i digjitalizimit të transmetimeve është në vazhdim e sipër në tërë botën. Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (BNT - ITU) ka vendosur 2015-ën si vitin e ndërprerjes së transmetimit televiziv analog në rajon, në të cilin është përfshirë edhe Europa dhe disa pjesë të Azisë Qendrore. Nevoja për digjitalizimin pra buron nga detyrimet ligjore ndërkombëtare (pasi praktikisht të gjitha shtetet në botë janë anëtarë të BNT-së), por se si do të bëhet kjo është çështje e çdo vendi veçmas brenda disa parametrave të dhëna.

1.2 Gjendja ndërkombëtare juridike

Ky udhëzues është i bazuar në një njohje themelore të lirisë së mediave që buron nga aktet e shumta të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE). Siç është e njohur, OSBE-ja konsideron se mediat e pavarura janë *“thelbësore për një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe për sisteme qeveritare të përgjegjshme dhe janë*

*të një rëndësie të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.*²

Në një numër rastesh, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së riafirmuan se *“liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut dhe një komponent themelor i një shoqërie demokratike. Në këtë kuptim, mediat e pavarura dhe pluraliste janë thelbësore për një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe për sisteme qeveritare të përgjegjshme”*. Ata gjithashtu morën përsipër, si një parim udhëzues të OSBE-së, se ata do të mbrojnë këtë të drejtë.³

Garancitë e së drejtës për lirinë e shprehjes janë të mishëruara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, si dhe në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP), një traktat ligjërshet i detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të OSBE-së. Liria e shprehjes është e garantuar edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), që ishte nënshkruar nga shumica e shteteve anëtare të OSBE-së. Organet dhe gjykatat ndërkombëtare e kanë bërë shumë të qartë se liria e shprehjes dhe informimit është ndër të drejtat më të rëndësishme të njeriut. Nuk ka asnjë dyshim se liria e shprehjes është e ndërlidhur me lirinë e mediave. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar:

Liria e shtypit i jep publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe formuar një opinion të ideve dhe qëndrimeve rreth udhëheqësve të tyre politikë. Në veçanti, ajo u jep politikanëve mundësinë për të reflektuar dhe komentuar mbi shqetësimet e opinionit publik; pra në këtë mënyrë

2 Paragrafi 26 i deklaratës së KSBE-së në Takimin e Moskës të Konferencës për Dimensionin Njerëzor të KSBE. (Tetor 1991). Shih edhe paragrafin II.26 të Raportit të Këshillit të KSBE-së nga Seminar i CSCE i Ekspertëve për Institucione Demokratike në Oslo. (Nëntor 1991) / Liria e Shprehjes, Rrjedha e lirë e informacionit, Liria e mediave: Dispozitat kryesore KSBE/OSBE 1975-2007. Publikuar në: http://www.osce.org/fom/item_11_30426.html

3 Paragrafi 36 i “Drejt një partneriteti të vërtetë në një epokë të re” të miratuar në Samitin e KSBE-së në Budapest, në vitin 1994. Shih gjithashtu paragrafin e 27 të Deklaratës së Samitit të OSBE-së në Stamboll, në vitin 1999. / Liria e Shprehjes, Rrjedha e lirë e informacionit, Liria e mediave: Dispozitat kryesore KSBE/OSBE 1975-2007. Publikuar në: http://www.osce.org/fom/item_11_30426.html

ju mundëson të gjithëve që të marrin pjesë në debatin e lirë politik i cili është në thelbin e konceptit të një shoqërie demokratike.⁴

Përderisa është e mundur që në një shoqëri demokratike liria e mediave të rregullohet dhe të vihen kufizime mbi të, kufizimet e tilla - në bazë të përkushtimeve të OSBE-së - gjithmonë duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare⁵.

Liria e mediave përfshin garanci për televizionin publik, shtetëror, privat dhe atë të komunitetit, masmediumit me ndikimin më të madh. Standardet ndërkombëtare në fushën e televizionit janë të radhitura në një numër të akteve. Ato vejnë kufizime të mundshme të lirisë së transmetimit, si dhe standardet e caktuara në licencim dhe në forma të tjera të rregullimit të transmetimit.

Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave nuk është organi i parë ndërkombëtar i cili adreson çështjet e digjitalizimit. Bashkimi Europian (BE), Këshilli i Europës, Unioni Europian i Transmetuesve (JET - EBU), BNT dhe të tjerët janë duke ofruar udhëzime dhe asistencë në këtë proces kompleks.⁶ Ky udhëzues është i bazuar në standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara dhe organizatat ndërkombëtare të sipërpërmendura të rëndësishme për Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Këshilli i Europës që ka një anëtarësi të madhe (47 shtete anëtare në vitin 2010), ka lëshuar një numër rekomandimesh jo-detyruese për çështjet e medias, duke përfshirë edhe digjitalizimin. BE-ja ka kompetencë të nxjerrë akte ligjore që janë të detyrueshme për shtetet e veta anëtare.

4 Castells v. Spanja, 24 prill 1992, Aplikacioni nr. 11798/85, para. 43.

5 Paragrafi (9.1) i dokumentit të nënshkruar në Takimin e Kopenhagës (Konferenca për Dimensionin Njerëzor të KSBE-së, qershor 1990). Paragrafi 26 i deklaratës së KSBE-së në Takimin e Moskës të Konferencës për Dimensionin Njerëzor të KSBE. Tetor 1991 / Liria e Shprehjes, Rrjedha e lirë e informacionit, Liria e mediave: Dispozitat kryesore KSBE/OSBE 1975-2007. Publikuar në: http://www.osce.org/fom/item_11_30426.html

6 Në kemi përdorur gjerësisht IRIS Merlin, bazën e të dhënave të informacionit ligjor përkatës për sektorin audiovizual në Europë të bërë nga Observatori Audiovizual Europian në Strasburg. Shih gjithashtu p.sh.: <http://www.article19.org/pdfs/press/romania-submission-on-digital-switchover-standards.pdf> për paraqitjen e Rumanisë për kalim në sistem digjital – neni 19, Londër, 2008 – Numri i indeksit: Law/2008/11/Romania.

Edhe pse BE-ja ka vetëm 27 anëtarë, aktet e saj ligjore shpesh janë përdorur si modele nga shtetet tjera ose janë të përfshira si standarde në marrëveshjet që BE-ja bën me shtetet tjera.

1.3 Gjendja aktuale në Europë

Eksperimentet me transmetimin digjital kanë qenë të vazhdueshme në Europë që një kohë. Transmetimet e para të televizionit digjital u bënë në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1998 dhe në Spanjë në vitin 2000. Të dyja këto vende eksperimentuan me një përzjerje të kanaleve pa pagesë dhe të atyre që paguhen për t'i shikuar. Kompanitë transmetuese atje subvencionuan marrësit digjital duke shpresuar që të tërheqin klientët të mjaftueshëm për ta bërë këtë ndërmarrje fitimprurëse. Mungesa e interesimit të konsumatorëve, konkurrenca nga televizioni ekzistues satelitor me pagesë ose shërbimet tjera nënkuptuan se të dy këto ndërmarrje dështuan.

Përjasja aktuale në Europë është e ndryshme nga eksperimentet fillestare, pasi ajo udhëhiqet nga qeveritë të cilat miratojnë plane digjitalizimi dhe vendosin afatin kohor për kalim në transmetim digjital, dhe në këtë mënyrë detyrojnë transmetuesit privat dhe ata publikë që të ndërmarrin ndryshime. Kalimi në transmetimin digjital përfshin sigurimin që njerëzit kanë përshtatur apo modernizuar aparatet e tyre televizive dhe pajisjet shtëpiake për regjistrim për të pranuar sinjalin digjital. Transferimi i parë i tillë ishte kryer në qytetin e Berlinit në Gjermani në vitin 2002. Vendi i parë që ndërmori digjitalizimin ishte Finlanda në vitin 2006, (i cili përfundoi tërësisht në vitin 2007). Shtetet anëtare të BE-së janë angazhuar për të përfunduar kalimin në transmetime digjitale në vitin 2012, edhe pse disa (si Greqia), mund të aplikojnë për një zgjatje të afatit për disa vite. Deri në vitin 2010 procesi është zbatuar plotësisht në Gjermani, Danimarkë, Finlandë, Luksemburg, Holandë dhe Suedi. Në vitin 2010 kalimi do të përfundojë në Austri, Estoni, Letoni, Maltë, Spanjë dhe Slloveni.

Duke e ndërprerë sistemin ekzistues të transmetimit analog qeveritë dhe rregullatorët kombëtarë nxisin sinjalin digjital dhe i ofrojnë popullatës një zgjedhje më të madhe të opsioneve të përballueshme.

Edhe pse nuk ka asnjë dyshim se Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë të lira që ta rregullojnë këtë transferim vetë, qeveritë dhe rregullatorët e tyre mbeten të detyruar në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare për të nxitur, respektuar, dhe mbrojtur lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave.

1.4 Përmbajtja dhe qëllimi i këtij Udhëzuesi

Ky udhëzues thekson atë se çfarë dispozitash ligjore (ndryshime në ligjet ekzistuese, ligje të reja ose instrumente tjera ligjore) dhe çfarë ndërhyrjesh rregullatore janë të nevojshme për të lejuar dhe për të inkurajuar digjitalizimin dhe se si të menaxhohet ai. Udhëzuesi nuk merret me detajet teknike në lidhje me digjitalizimin apo me aspekte të së drejtës autoriale të digjitalizimit.

Udhëzuesi analizon disa nga shembujt praktik të kalimit në transmetimin digjital dhe jep rekomandimet e duhura, praktikatat e mira por edhe ato të këqija.

Udhëzuesi kryesisht merret me televizionin, edhe pse shumë çështje të përgjithshme kanë të bëjnë edhe me televizionin edhe me radion. Audio Transmetimi Digjital (Digital Audio Broadcasting - DAB) u zhvillua në Europë në vitin 1980 dhe kishte për qëllim të zëvendësojë FM/AM analoge për transmetimet kombëtare dhe lokale. Transmetimet me orar të plotë ekzistojnë që nga mesi i viteve 1990. Radioja digjitale ka disa probleme të veta - radio-marrësit analog janë shpesh shumë të lirë, njerëzit kanë shumë të këtille, dhe ka shumë pak interes për ata digjital, që janë më të shtrenjtë. Radioja analoge tashmë ofron një gamë të gjerë zgjedhjesh. Lirimi i spektrit përmes radios digjitale është edhe më problematik dhe më pak i rëndësishëm sesa ai përmes televizionit digjital.

Kapitulli 2. Çështjet e infrastrukturës: Si të shmanget monopolizimi

Për shkak të marrëdhënieve të ndryshme në mes të ofruesve të përmbajtjes programore dhe objekteve dhe pajisjeve të transmetimit në peizazhin e transmetimit digjital, me objekte dhe pajisje të shtrenjta dhe komplekse të transmetimit që mund të paraqesin një fyt të ngushtë, është e rëndësishme që të përkujdesemi që disa transmetues të mos e monopolizojnë tregun e transmetimeve. Në legjislacion dhe rregullore duhet t'i kushtohet shumë vëmendje faktit se si të arrihet pluralizmi dhe diversiteti.

Ky kapitull shpjegon se çfarë duhet të bëjnë ligjvënësi dhe rregullatori për të shmangur monopolizimin dhe për të siguruar se ka konkurrencë në mesin e transmetuesve, si dhe pluralizmin dhe diversitetin e skemës programore.

2.1 Ligji mbi konkurrencën dhe digjitalizimi

Në ekonomitë e tregut me konkurrencë të lirë, është i nevojshëm legjislacioni për të mbrojtur konkurrencën kundër përpjekjeve për ta çrregulluar atë, qoftë nga marrëveshjet e fshehta mes kompanive, ose nga kompanitë që kanë fuqinë që vetë ta çrregullojnë konkurrencën. Legjislacioni i tillë quhet Ligji mbi konkurrencën dhe zbatimi i tij zakonisht sigurohet nga një autoritet i pavarur për konkurrencën. Mënyra në të cilën ligji i konkurrencës zbatohet dhe çfarë përjashtimesh mund të ketë ndryshon në varësi të llojit të biznesit në fjalë dhe nga struktura e tregut, si në anën e kërkesës ashtu edhe të ofertës.

Përveç dallimeve të tilla, ka rregulla të veçanta për sektorët që, për arsye objektive, duhet të trajtohen përmes një ligji të veçantë. Arsyet për trajtimin e ndryshëm zakonisht gjinden në dy situata: në monopolin natyror bazuar në përdorimin e infrastrukturës së veçantë (një rrjet) apo në natyrën e veçantë të mallrave ose shërbimeve që më parë siguroheshin nga shteti. Shërbimet e energjisë, ujit dhe të komunikimit janë vetëm disa nga shembujt.

Në këta sektorë, roli kryesor i ligjit të konkurrencës është për t'u siguruar që mund të ekzistojë konkurrenca, dhe ky shërbim thelbësor nuk do të jetë në dispozicion pa rregulla të veçanta. Objekt dhe pajisje thelbësore në terminologjinë e ligjit mbi konkurrencën mund të jetë një rrjet ose infrastruktura tjetër, por ai gjithashtu mund t'i referohet nevojës për një leje të veçantë për të kryer një aktivitet, për shembull një licencë.

Roli i autoriteteve është që të sigurojnë sa më shumë që të jetë e mundur se është ruajtur konkurrenca. Në shumicën e ekonomive të tregut me shërbime të liberalizuara, detyrën për të siguruar konkurrencë ndahet mes rregullatorit të konkurrencës dhe rregullatorëve të sektorëve të veçantë. Një nga detyrat kryesore të rregullatorit të sektorit specifik është të sigurojë që kushtet për shfrytëzimin e infrastrukturës janë të drejta dhe të barabarta. Për shembull, ofruesit e shërbimeve të telefonisë fikse, duhet të lejohen të shfrytëzojnë rrjetin e kabllove në kushte që ju lejojnë atyre për të konkurruar, pavarësisht nga pronësia mbi rrjetin. Nëse pronari i rrjetit është gjithashtu një nga ofruesit e shërbimeve, është veçanërisht e rëndësishme që të përkujdesemi që pronari të mos e ngulfatë konkurrencën. Kjo është arsyeja përse është mjaft e zakonshme që pronarët e infrastrukturës të ndalohen nga ofrimi i një shërbimi. Kjo ka çuar në shpërbërje të ish-monopoleve të shërbimeve në shumë vende. Në kontekstin e transmetimit digjital ky lloj konsiderate do të thotë se pronarët e platformave të transmetimit nuk mund të jenë edhe ofrues të përmbajtjes programore.

Digjitalizimi shpjen në rreziqet fillestare të përqendrimit, që duhet të shqyrtohen sipas ligjit mbi konkurrencën. Kjo është për shkak, si pasojë e kostos së tyre dhe kompleksitetit, zakonisht ekzistojnë vetëm disa objekte dhe pajisje transmetimi. Kur teknologjia është e re, për ofruesit e transmetimit të përmbajtjes programore mund të jetë më e vështirë që të organizojnë objektet dhe pajisjet e transmetimit. Ligjet e kundër-përqendrimit, sidomos në fushën e transmetimit, kanë shumë qëllime: për të ruajtur diversitetin, si dhe objektivat kulturore dhe ato afariste.

Franca është shembull i një vendi ku qëllimi i ruajtjes së kulturës kombëtare, asaj frënge, është tejet i theksuar.

Kur puna vjen tek ofrimi i programeve dhe pikëpamjeve, pluralizmi i mendimit garanton pluralizmin dhe diversitetin. Gjersa është e rëndësishme që të luftohet përqendrimi i tepruar, ndonjëherë një nivel i caktuar i përqendrimit duhet të lejohet për t'u siguruar që kompanitë e qëndrueshme ekzistojnë. Kjo duhet të kombinohet me garancitë për një pluralizëm të pikëpamjeve. Ligji mbi konkurrencën, si rregull, vepron nën supozimin se liria e ndërmarrjeve duhet të kufizohet vetëm në qoftë se ka arsye mbizotëruese për të mirën publike për ta bërë këtë, si për shembull për mbrojtjen e pluralizmit.

Në shumë vende dy sisteme dhe rregullatorë të veçantë vëzhgojnë çështjet e përqendrimit në fushën e transmetimit: sistemet për çështjet e përqendrimit dhe konkurrencës, dhe sistemet për transmetim.

Numri i organeve nuk është vendimtar. Në **Gjermani** për shembull, ka një organ me pluralizëm të brendshëm, që do të thotë se brenda një organi departamente të ndryshme merren me çështje të ndryshme dhe veprojnë veçmas nga njëri-tjetri edhe pse janë pjesë e së njëjtës strukturë, diçka që është e panjohur në vende të tjera.

Në epokën digjitale mund të jetë e nevojshme që të jemi më fleksibil rreth kufizimeve numerike të mundshme mbi përqendrimin e mediave, me rregullat e vendosura të përqindjes së legjislacionit mbi mediat, të anashkaluara në favor të rregullave më fleksibile rast-pas-rasti, siç është e zakonshme në ligjin mbi konkurrencën.⁷

7 M. Arino "Lufta dhe paqja digjitale: Rregullimi dhe Konkurrenca në Transmetimet Digjitale Europiane" Ligji Publik European, 2004, Vëll. 10 Çështja 1, fq. 135-160.

Në Francë, Conseil Supérieur de l'Audiovisuel (Autoriteti rregullator audiovizual francez, CSA) dhe Autoriteti mbi konkurrencën, që të dy janë kompetent. Autoriteti mbi konkurrencën do të kërkoj sqarim nga CSA, kur rastet përfshijnë ndonjë kompani audiovizuale, dhe CSA duhet të japë një opinion brenda një muaji. Edhe në rastet kur CSA nuk ka një rol të tillë formal, ai mund të informojë Autoritetin mbi konkurrencën. Organet nuk janë të varura nga opinionet e tjetrit, pasi ato shqyrtojnë aspekte të ndryshme. Njëri prej tyre mund edhe të lejojë atë që tjetri e ndalon. Megjithatë, ata duhet të konsultohen dhe vendimi i njërit mund të jetë një faktor i rëndësishëm për vendimmarrjen e tjetrit. Si zbatohet kjo në praktikë nuk është e lehtë ta dimë, pasi që Autoriteti mbi konkurrencën nuk kishte kompetencë mbi kompanitë audiovizuale deri në gusht të vitit 2008. Kjo ishte ndryshuar vetëm duke pasur parasysh digjitalizimin, me konvergjencën e teknologjive dhe aspekteve të konkurrencës jashtë fushës së përmbajtjes së transmetimit, që luajtën një rol më të madh.¹

2.2 Qasja në objektet e transmetimit

Monopolizimi mund të paraqes probleme në nivel të ofruesit të programit, por edhe më shumë në nivel të ofruesit të shërbimit. Pasja e më shumë se një ofruesi të shërbimeve të rrjetit është më e dëshirueshme nga këndvështrimi i konkurrencës. Megjithatë, kjo mund të jetë e vështirë të arrihet, veçanërisht në vendet e vogla, dhe kjo mund të mos jetë e përshtatshme edhe për arsye të tjera, si p.sh.: instalime të tepërta të infrastrukturës. Dispozitat mbi qasjen duhet të sigurojnë se ekzistimi i vetëm një operatori të rrjetit nuk do të shkaktoj probleme. Në të njëjtën kohë, në qoftë se konkurrenca mund të inkurajohet, kjo duhet të bëhet.

Një element kyç i strategjisë së digjitalizimit duhet të jetë nxitja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve dhe të sigurohet ndërveprimi. Duhet të ekzistojnë detyrimet ligjore që ju lejojnë të tjerëve qasje në infrastrukturë.

Direktiva e BE-së mbi Qasjen⁸ thekson se në një treg të hapur dhe konkurrues nuk duhet të ketë kufizime që pengojnë kompanitë për të negociuar qasjen dhe marrëveshjet e ndërlidhjes reciproke, duke përfshirë edhe marrëveshjet ndërkuftare. Në parim, të gjitha kërkesat për qasje të bëra në mirëbesim duhet të përmbushen në baza komerciale. Palët mund të përcaktojnë kushtet, por kur ka ndryshime të rëndësishme sa i përket fuqisë negociuese, dhe kur disa kompani mbështeten në infrastrukturën e të tjerëve, duhet të ketë një kornizë rregullatore dhe një rregullator të pavarur për të siguruar funksionimin e tregut. Rregullat e BE-së ofrojnë një shembull edhe për shtetet jo anëtare.

Ofrimi i qasjes nënkupton që kompanitë kontrollojnë qasjen për shfrytëzuesit final, do të thotë kontrolli mbi telat ose instalimet tjera që shkojnë nëpër shtëpi, në pajisjet marrëse që shfrytëzohen për të parë apo dëgjuar transmetimet ose të përdorin objektet dhe pajisjet tjera të komunikimit, mund të detyrohen nga autoritetet rregullatore që të ofrojnë qasje nëpërmjet ndërlidhjes me rrjetet e tyre. Direktiva e BE-së mbi Qasjen përmend në mënyrë specifike transmetimet digjitale të radiotelevizionit.⁹ Këto dispozita synojnë ofruesit e shërbimeve që kanë kontroll mbi një strukturë që është e domosdoshme për ofrimin e shërbimit. Në transmetimet digjitale ata janë operatorët e platformës që kontrollojnë objektet dhe pajisjet e transmetimit.

Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe koston e transmetimit digjital, ka të ngjarë që do të ketë kompani dominuese, dhe rregullatori do të ketë një rol të rëndësishëm në sigurimin që rregullat për qasje do të respektohen. Rregullat për qasje brenda rregullores së komunikimit duhet të ruhen dhe përmirësohen për mjedisin digjital në mënyrë që ato të shtrihen drejt portave të reja.¹⁰

8 Direktiva 2002/19/BE mbi qasjen në, dhe ndërlidhjen e, rrjeteve të komunikimit elektronik dhe të objekteve dhe pajisjeve shoqëruese (Direktiva mbi qasjen) e ndryshuar nga Direktiva 2009/140/BE.

9 Neni 5.1(b) dhe Neni 6 si dhe Aneksi 1 Pjesa II e Direktivës mbi qasjen 2002/19/EC.

10 Shih diskutimin në "Kontributi i EBU ndaj apelit të Komisionit Europian për prurje (inpute) rreth shqyrtimit të ardhshëm të kornizës rregullatore të BE-së për komunikim dhe shërbime elektronike", 30.1.2006 DAJ/ACB/mtp/jev.

Në fushën e telekomunikacionit ka precedentë dhe përvoja se si duhet të sigurohet qasja në rrjete. Rregull themelorë është që kompanitë do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje. Rregullatori duhet të ndërhyj vetëm në qoftë se kjo nuk funksionon. Gjendja për transmetimet digjitale është e ngjashme me atë të telekomunikacionit në faktin se infrastruktura e nevojshme për transmetim është e shtrenjtë, dhe nuk do të kishte kuptim komercial, logjistik apo mjedisor që secili ofrues shërbimi të ketë infrastrukturën e vet. **Rregullatori (rregullatori i konkurrencës apo rregullatori i sektorit specifik) duhet të sigurojë qasje të barabartë në infrastrukturën për transmetimin digjital.**

Mund të jetë joshëse për rregullatorin ose për shtetin që të vendos drejtpërdrejt çmimet dhe kushtet për shfrytëzimin e rrjetit si një shkurtore për të arritur një gjendje të dëshirueshme të tregut. Megjithatë, kjo do të ishte ndërhyrje e tepruar në tregun e lirë dhe dobitë e zakonshme të një tregu të lirë siç janë çmimet konkurruese dhe cilësia më e lartë do të humbeshin. Çmimet dhe kushtet duhet të vendosen nga tregu dhe rregullatori duhet të ndërhyjë vetëm nëse tregu dështon.

Fillimisht, kur transmetimi digjital është i ri, një pjesë e madhe e përgjegjësisë bie mbi rregullatorët, pasi që nuk ka kushte ekzistuese të tregut që duhet mbështetur. Bashkëpunimi i ngushtë mes aktorëve të ndryshëm të sektorit është i nevojshëm. Nuk ka asnjë arsye për të ndaluar privatizimet e rrjeteve transmetuese që janë në vazhdim e sipër, por organet e reja private duhet të kuptojnë se çmimet që ata ngarkojnë ose kushtet që imponojnë ata duhet të jenë të arsyeshme. **Në qoftë se transmetuesit nuk mund të kenë qasje në infrastrukturë nën kushte të arsyeshme, digjitalizimi rrezikon të kufizoj pluralizmin dhe diversitetin në vend se t'i promovoj ata.** Ky është një nga elementet që, nga këndvështrimi i rregullatorit, e bënë transmetimin në mjedis digjital të ngjashëm me telekomunikacionin. Për dallim nga transmetimi analog, ku pajisja është relativisht e lirë dhe e thjeshtë, në mjedisin digjital ofruesit e shërbimeve dhe transmetuesit do të kenë punë me një numër të pakët të ofruesve të transmetimit.

Direktivat e BE-së mund të shihen si ofruese të udhëzimeve të dobishme për atë se çfarë duhet të parasheh legjislacioni, pasi që është pasqyrim i një mënyre bashkëkohore për të zgjidhur problemet e mundshme. Legjislacioni i ngjashëm vlen edhe në shumë shtete jo-pjesëmarrëse të BE-OSBE-së. Në vendet që kanë kryer digjitalizimin, çështja është zgjidhur në mënyra të ndryshme, por të gjitha këto vende Europiane janë të lidhura me Direktivat e BE-së me të cilat legjislacioni kombëtar duhet të jetë në përputhje.

2.3 Rekomandimet e Këshillit të Europës mbi pluralizmin e mediave

Gjatë planifikimit të digjitalizimit, çështjet e përqendrimit duhet të jenë në maje të agjendës së qeverive dhe rregullatorëve, pasi përndryshe ekziston rreziku që digjitalizimi do të shpie në bashkimin e kompanive, duke bërë që ato më të voglat të zhduken, dhe në përgjithësi në më pak zgjedhje.

Këshilli i Europës është organ European që ka dhënë rekomandime specifike mbi mediat dhe digjitalizimin. Ai rekomandon që shtetet anëtare të mbajnë rregulla që kufizojnë përqendrimin e pronësisë mbi mediat dhe çdo masë plotësuese të cilën ata mund të ndërmarrin për të rritur pluralizmin. Ai gjithashtu rekomandon masa për të forcuar transmetimin e shërbimit publik si drejtpeshim vendimtar kundrejt përqendrimit në sektorin privat të mediave.¹¹ Masat e tilla janë renditur në një numër të akteve.

Ato janë diskutuar në “Deklaratën për mbrojtjen e rolit të mediave në demokraci në kontekstin e përqendrimit të mediave” dhe “Rekomandimi për pluralizmin e mediave dhe diversitetin e përmbajtjes së mediave”, miratuar më 31 janar 2007 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës.

¹¹ Shtojcë për Rekomandimin R (2003)9 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital.

Deklarata thekson se peizazhi medial po ndryshon si rezultat i globalizimit dhe përqendrimit. Kjo është pozitive për faktin që kjo shpie në efikasitetin e tregut, përmbajtjes së përshtatur konsumatorit dhe krijimin e vendeve të punës; megjithatë, kjo gjithashtu paraqet sfida. Kjo mund të gërryen diversitetin e mediave në tregjet e vogla, shumëllojshmërinë e kanaleve dhe ekzistimin e hapësirave për debat publik. Përqendrimi i mediave mund të vendos një grusht pronarësh të mediave në një pozicion për të kontrolluar agjendën e debatit publik. Prandaj, Deklarata nënvizon dëshirën e ndarjes së kontrollit ndaj mediave dhe ushtrimit të autoritetit politik. Ajo gjithashtu thekson rëndësinë e transparencës së pronësisë mbi mediat përmes masave përkatëse rregulatore dhe nënvizon që shërbimi publik i transmetimit i pajisur dhe i financuar në mënyrë adekuate mund të kundërpeshoj pasojat negative të përqendrimit të fortë të mediave. Politikat që inkurajojnë zhvillimin e mediave jo-fitimprurëse mund të paraqesin një tjetër mënyrë për të nxitur diversitetin e mendimeve.

Rekomandimi ripohon se mediat janë thelbësore për funksionimin e një shoqërie demokratike pasi që ato të nxisin debatin publik, pluralizmin politik dhe ndërgjegjësimin e opinioneve të ndryshme. Ai rekomandon që shtetet anëtare të marrin parasysh përfshirjen në ligjin ose praktikën kombëtare një sërë masash. Këto masa ndryshojnë nga rregullat në lidhje me rregullimin e pronësisë në rregullat që kanë të bëjnë me ndarjen e licencave të transmetimit dhe duhet të përmbajnë/duhet të ofrojnë detyrime/obligime.

Më parë, Rekomandimi nr. R(99)1 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës trajtoi zhvillimin e përqendrimit të transmetimit i cili mund të rrezikojë pluralizmin e mediave. Ai sugjeroi që të ndërmerren masat e duhura, siç është p.sh.: krijimi i autoriteteve të veçanta për media me kompetenca për të ndërmarrë veprime kundër përqendrimit të tregut, kur kjo është e nevojshme. Në mënyrë të ngjashme, Rekomandimi (2003)9 i bënë thirrje shteteve të Këshillit të Europës që të vendosin rregulla që kufizojnë përqendrimin e pronësisë mbi media.¹²

12 Artikulli 18 i Shtojcës së Rekomandimit (2003)9.

Rezoluta 1636 (2008) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës e bën transparencën e pronësisë mbi media dhe ndikimin ekonomik mbi mediat **një nga treguesit për mediat në një shoqëri demokratike. Teksti i saj vë në dukje se** *“legjislacioni duhet të zbatohet kundër monopoleve të mediave dhe pozitive dominuese në treg në mesin e mediave. Përveç kësaj, duhet të ndërmerren veprime konkrete pozitive për të nxitur pluralizmin e mediave”*.¹³

2.4. Përqendrimi

Sikurse në liberalizimin e telekomunikacionit, edhe në digjitalizim ata që bartin shpenzimet mund, në një farë mase, të bëjnë këtë në mënyrë që të tjerët të jenë në gjendje të konkurrojnë me ta. Kjo natyrisht vë një theks mbi autoritetet për të përcaktuar drejtpeshimin më të mirë në mes të lejimit të bashkëpunimit dhe dhënies së të drejtave të veçanta. Kur vrojtohen çështje të tilla si përqendrimi, duhet të merren parasysh nevoja të veçanta siç janë investime shumë të theksuara në infrastrukturë. Është e mundur që përqendrimet e caktuara janë e vetmja mënyrë për të parandaluar kompanitë nga falimentimi.¹⁴ Në qoftë se rregullat janë shumë të rrepta rreth përqendrimit ose bashkimeve, kjo mund të rezultojë që ofruesit të mos jenë në gjendje të përballojnë digjitalizimin. Por çdo zbatimje e rregullave duhet të shqyrtohet me kujdes, pasi që ligji mbi konkurrencën ekziston që konsumatorët të përfitojnë nga ai.

Fusha të ndryshme të tregut të transmetimit tregojnë shembuj të përqendrimit, siç është televizioni analog me pagesë. Digjitalizimi ndryshon mënyrën se si konsumohen mediat, duke e afuar atë më pranë shërbimeve të tjera të komunikimit. Kur shikohet për përqendrim dhe për ndërhyrje të mundshme të rregullatorit, është e rëndësishme që të bëhet përkufizimi i tregut. Shtrohet pyetja nëse televizionet me pagesë dhe ato pa pagesë konsiderohen të jenë pjesë e të njëjtit treg apo janë të ndryshme. Megjithëse produkti është i njëjtë, kushtet janë të ndryshme. Deri më tani, tregjet zakonisht janë konsideruar si të ndryshme, por kjo do të duhej të ndryshojë.

¹³ Artikulli 8.18. Shih: <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta08/ERES1636.htm#1>

¹⁴ Shih diskutimin në rastin T-158/00 të Gjykatës Europiane të shkallës së parë.

Televizioni digjital, edhe më tepër sesa vetëm si televizion, është një industri komplekse me shpenzim të rëndësishëm të pakthyeshëm, me tendenca oligopolistike, nevojë për infrastrukturë të veçantë dhe disa objekte “të fytit të ngushtë”.

Operatorët e platformës mund të kontrollojnë pajisjet e konsumit dhe të përcaktojnë teknologjinë e tyre. Me fjalë të tjera ka dështime të ndjeshme të tregut.¹⁵

Ndërveprimi dhe rregullat mbi qasjen i luftojnë këto tendenca negative, por nuk mund t'i shmangin përqendrimet si të tilla. Platformat konkurrojnë për përmbajtje relativisht të rralla dhe mund të ketë nevojë për marrëveshje ekskluzive dhe këto mund të lejohen në bazë të ligjit mbi konkurrencën¹⁶ (nën kushte të caktuara)¹⁷; megjithatë, duhet të monitorohen përqendrimet në treg dhe barrierat e hyrjes.

Ndërhyrja e rregullatorit është e nevojshme për të luftuar efektet negative të përqendrimit, duke tejkaluar atë që mund të jetë një pasojë e natyrshme e strukturës së tregut. Gjithmonë ekziston një rrezik me ex-post rregullimin (retrospektivë), pasi një situatë nuk mund të kthehet mbrapa me rregullore.¹⁸ Këto janë rastet kur është i domosdoshëm ex-ante rregullimi (paraprak) i sektorit specifik. Shumë burime nuk garantojnë pluralizmin në qoftë se ato ofrojnë të njëjtën përmbajtje. Pasi që ligji mbi konkurrencën e mbron konkurrencën dhe jo konkurrentët, dikush do të mbetet i pambrojtur në qoftë se ka një zë që është financiarisht më i fuqishëm dhe në këtë mënyrë nuk ka nevojë për mbështetje, por mund të ofrojë një shërbim apo produkt pa të. Nëse ka shumë aktorë (firma), që zakonisht është e mjaftueshme nga pikëpamja e ligjit mbi konkurrencën, dhe siç supozohet atëherë se tregu do të përcaktojë se çfarë produktesh ofrojnë ata dhe do të ketë zgjedhje për konsumatorët. Ligji tradicional mbi konkurrencën nuk është projektuar për t'u marrë me një situatë ku mund të ketë konkurrencë përmes shumë aktorëve, por kur produktet që ata ofrojnë janë pothuajse të njëjta.

15 M. Arino "Lufta dhe paqja digjitale: Rregullimi dhe Konkurrenca në Transmetimet Digjitale Europiane" Ligji Publik Europian, 2004, Vëll. 10 Çështja 1, fq.135-160 në fq.137-138.

16 Neni 101 (ish-neni 81) i Traktatit mbi Funkcionimin e BE-së dhe përjashtimet nga ndalimi i marrëveshjeve ose praktikave të përbashkëta ndërmjet kompanive.

17 M. Arino "Lufta dhe paqja digjitale: Rregullimi dhe Konkurrenca në Transmetimet Digjitale Europiane" Ligji Publik Europian, 2004, Vëll. 10 Çështja 1, fq. 135-160 fq. 139-141.

18 Po aty, në fq. 143-144.

Kjo është arsyeja përse transmetimi trajtohet nga rregullatorët e veçantë dhe sipas rregullave të veçanta sipas të cilave edhe çështjet e përmbajtjes mund të merren parasysh. Për procesin e digjitalizimit është thelbësore që të ketë një mirëkuptim rreth ndikimit të vërtetë të ndërhyrjeve të ndryshme rregullatore.¹⁹

Si shembull mund të përmendim rastin e një bashkimi **spanjoll** në tregun e televizionit digjital. Autoritetet vështruan fuqinë e tregut, por jo edhe fuqinë e mediave, kontrollin mbi mediat si të tillë. Interesat e konsumatorëve ishin marrë parasysh, por jo domosdoshmërisht edhe interesat e qytetarëve jashtë rolit të tyre si konsumatorë. Kjo është gjendja siç u shpjegua më lart, ku situata e veçantë për transmetim nuk është marrë plotësisht parasysh, ku jo vetëm numri i ofruesve të shërbimit është i rëndësishëm, por edhe përmbajtja.

Ndryshimi i cekur më herët në ligjin **francez** për të lejuar autoritetet e konkurrencës të shqyrtojnë bashkimin në fushën e transmetimeve është një tjetër ilustrim se si grupe të ndryshme të rregullave rregullatore, të administruara nga rregullatorët e ndryshëm, ndërveprojnë në një peizazh të mediave digjitale.

2.5 Përzgjedhja e transmetuesve

Një nga parimet kryesore në licencimin e transmetimeve digjitale është se procesi i licencimit për objektin e transmetimit (platformën) dhe përmbajtjen programore duhet të jetë i ndarë. Mënyra e përzgjedhjes së transmetuesve që të bëhen pjesë e multipleksëve digjitale, sidomos të pakove pa pagesë (sociale), duhet të jetë transparente dhe e hapur.

¹⁹ Po aty, në fq. 143-144 dhe 157-158.

Përfitimet nga qasja në informata dhe reduktimi i pabarazive nuk ndodhin automatikisht dhe jo vetëm përmes një shumësie të kanaleve - është e rëndësishme që të ekzistojë një diversitet i vërtetë. Kjo duhet kihen parasysh kur vendoset rreth përmbajtjes (cilat kanale) së multiplekseve të transmetimit. Roli kyç i ShPT nuk ndryshon. Në një treg të zhvilluar të transmetimit digjital, shikuesit janë më të ngjashëm me konsumatorët në një kuptim tradicional; me më shumë zgjedhje dhe diversitet transmetimi mund të bëhet më i lidhur me kërkesat e shikuesve.

Në të njëjtën kohë, ekziston rreziku i cekur i monopolizimit nëqoftëse një ofrues i shërbimit merr një pozicion dominues. Pengesat për hyrje për të tjerët do të jenë mjaft të mëdha për shkak të kostove të infrastrukturës dhe për shkak se konsumatorët do të jenë të lidhur me një operator të caktuar (në këtë rast transmetuesin) përmes pajisjeve teknike, kushteve të kontratës apo preferencave programore. Kjo mund të rezultojë në më pak zëra të mediave në dispozicion. Në qoftë se transmetuesit nuk mund të kenë qasje në objektet/pajisjet e transmetimit ata nuk do të arrijnë audiencën dhe mund të marrë kohë para se të krijohet një treg i vërtetë për transmetimin me një zgjedhje në mes të operatorëve.

Rregullatorët duhet të identifikojnë situatat ku transmetimi digjital mund të shpije në një gjendje monopoli anti-konkurrues, gjë që është shumë e vështirë, pasi që zakonisht është e nevojshme që të ofrohet nxitje apo të jepen stimulime në mënyrë që të fillohet me transmetimin digjital dhe jo të ngulfaten risitë.²⁰ **Nëse monopoli dhe problemet e dominimit tashmë ekzistojnë, atëherë këto mund të rriten me digjitalizimin. Çështjet e tilla duhet të adresohen pa vonesë.**

20 Në Itali i ashtuquajtur i Ligji Gaspari (Ligji nr. 112 i 3 maj 2004), përcaktoi se vetëm transmetuesit ekzistues mund të aplikojnë për licenca digjitale eksperimentale dhe nuk kishte asnjë obligim formal për dorëzimin e frekuencave analoge. Në dhjetor të vitit 2005 janë licencuar pesë multiplekse, RAI dhe një transmetues komercial, me dispozitën se çdo operator me më shumë se një licencë digjitale duhet të mundësojë qasje në 40% të brezit për ofruesit e pavarur të përmbajtjes programore.

Rregullat e pronësisë dhe rregullat e lidhura me publikimin e informacioneve shpjeguese të dizajnuara për të kufizuar përqendrimin e mediave bëhen edhe më të rëndësishme në arenën digjitale. Në shtetet me legjislacion të pamjaftueshëm mbi pronësinë dhe publikimin e informatave dhe me mungesë të transparencës, ekziston një rrezik serioz për mungesë të pluralizmit. Problemet e përmendura të sektorit të transmetimit duhet të adresohen paralelisht me planet për digjitalizim.

Vetëm rregullat për konkurrencën mund të mos jenë të mjaftueshme për të siguruar diversitetin kulturor dhe pluralizmin e mediave në fushën e televizionit digjital. Kjo tregon përsëri rëndësinë e monitorimit të autoritetit rregullator të sektorit specifik rreth asaj se çfarë detyrimesh janë të përcaktuara për aktorët në tregun e transmetimit digjital, në mënyrë që çdo lloj monopolizimi të mbahet në minimum. **Çështjet e përmbajtjes (programore) duhet të vështrohen ndaras nga transmetimi, por përmbajtja, që është e dëshiruar në bazë të legjislacionit dhe vendimeve të politikave të vendit, duhet të ketë qasje në transmetim.** Nuk do të ketë asnjë kuptim për rregulla rreth transmetimit për/të pakica/ve, në shërbimin publik të transmetimit apo për çështje të tjera të tilla, nëse transmetuesit nuk mund t'i qasen infrastrukturës së nevojshme për të transmetuar. Puna rregullatore dhe vlerësimi i asaj se si do duhej të duket peizazhi programor për të përmbushur vendimet e bëra të politikave është një punë e pandërprerë dhe duhet të trajtohet përmes analizave të vazhdueshme të tregut. Rregullatori duhet të balancojë nevojat e pronarit të infrastrukturës dhe shfrytëzuesve të tjerë të infrastrukturës, d.m.th. transmetuesve apo ofruesve tjerë të shërbimeve që shfrytëzojnë infrastrukturën.

Në një vend ku ligji i përgjithshëm mbi konkurrencën dhe aplikimi e zbatimi i tij janë të dobët, është edhe më e rëndësishme që rregullatori të monitoroj funksionimin e duhur të tregut. Duhet të ketë transparencë të përgjegjësive dhe kushteve për qasje dhe ndërlikohje.

Rregullatori i pavarur duhet të marrë kompetenca të mjaftueshme dhe është thelbësore që puna e rregullatorit të jetë objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese.²¹

EBU thekson se çdo revidim i kornizës rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike duhet të vazhdojë të marrë parasysh lidhjet që ekzistojnë mes përmbajtjes (programore) dhe rrjeteve, dhe në veçanti në lidhje me qasjen në përmbajtje. Për EBU-në, ky shqetësim mbulon qasjen në përmbajtje nga qytetarët dhe konsumatorët dhe qasjen nga ana e ofruesve të përmbajtjes - dhe jo më pak edhe për transmetuesit - në rrjetet dhe objektet/pajisjet shoqëruese të cilat janë të nevojshme për të arritur tek publiku. Kjo është e rëndësishme për objektivat e përgjithshme, siç janë diversiteti kulturor dhe pluralizmi i mediave, të cilat EBU, si një organizatë transmetuese, i mbron.

Ligjet mbi konkurrencën nuk mund të merren vetëm me problematikën e mediave dhe nuk janë të mjaftueshme për arritjen e objektivave me interes publik, siç janë: pluralizmi i mediave dhe qasja e konsumatorëve në një gamë të gjerë të përmbajtjes (programore). EBU arrin në përfundimin se kjo është arsyeja pse disa rregulla post-factum, si p.sh.: dispozitat e "përfshirjes së domosdoshme" dhe ato të qasjes, duhet të ruhen, dhe në fakt të përmirësohen, në epokën e televizionit digjital.²²

21 Direktiva mbi qasjen gjithashtu kërkon nga rrjetet publike të komunikimit elektronik, d.m.th. infrastrukturën e përdorur për shërbimet e komunikimit (antenat, kabllo etj.) për shpërndarjen e televizionit digjital që të përkrah shërbimet televizive me ekran të gjerë (wide-screen), që është teknologjia më e re për transmetime televizive. Kërkesa të veçanta për qasjen e kushtëzuar të sistemeve në transmetime digjitale të radio-televizionit janë paraqitur në një shtojcë të direktivës. Megjithatë, edhe shtetet anëtare të BE-së, kanë mundësi që autoritetet rregullatore të tyre të vendosin kritere të tjera për teknologjinë e përdorur dhe për kërkesat që mund të bëhen për ofruesit e shërbimeve, pasi që ky treg vazhdimisht është duke evoluuar.

22 Kontributi i EBU-së Komisionit Europian bën thirrje për prurje (inpute) në rishikimin e ardhshëm të kornizës rregullatore të BE-së për komunikimet dhe shërbimet elektronike, më 30.1. 2006 EBU.

Kapitulli 3. Skema programore në epokën digjitale: Si të shmangët monopolizimi

3.1 Pluralizmi i përmbajtjes

Një garanci e rëndësishme e lirisë së informimit është respektimi i parimeve të diversitetit ideologjik dhe politik brenda shoqërisë, të cilat përfshijnë pluralizmin e informacionit dhe ideologjisë brenda gazetarisë. Dhe liria e informacionit, nga ana tjetër, siguron një klimë të pluralizmit ideologjik në shoqëri dhe në mesin e burimeve të informacionit.

Diversiteti i ideologjive, politikës dhe informacioneve e ka logjikën e vet të brendshme. Diversiteti ideologjik presupozon një shumëllojshmëri të opinioneve në politikë, ekonomi, religjion, arte, etikë dhe fusha të tjera. Konkurrenca e mendimeve sigurohet përmes disponueshmërisë së lirë të informacionit të duhur objektiv për publikun dhe nga debati publik. Kjo, nga ana tjetër, ofron një mënyrë për të zhvilluar argumentet më të mira për t'u testuar në nivelin politik; kjo shpie në pluralizëm politik. Diversiteti politik dhe ideologjik janë rezultat i diversitetit të informacionit dhe anasjelltas. Ekziston një supremaci e pluralizmit ideologjik dhe atij politik: diversiteti i informacionit, duke përfshirë edhe atë në formën e lirisë së informacionit, është një mjet për të arritur atë, e jo qëllimi i pluralizmit ideologjik dhe atij politik.

Qasja në përmbajtjen pluraliste të mediave është një nga shenjat e shoqërisë civile. Shumëllojshmëria e informacionit promovon një shoqëri të hapur. Mbulimi mediatik i interesave dhe pikëpamjeve të ndryshme ndihmon për të zbutur qëndrimet ekstreme dhe për të promovuar tolerancën dhe gatishmërinë për kompromis.

Është e përshtatshme të përkujtojmë me këtë rast se Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar të *“pranojnë çdo mundësi të ofruar nga mjetet*

*bashkëkohore të komunikimit ... për të rritur shpërndarjen më të lirë dhe më të gjerë të informacionit të të gjitha llojeve”.*²³

Prandaj, në procesin e kalimit në transmetime digjitale është e rëndësishme që rregullatorët kombëtarë përveç parandalimit të përqendrimit të pronësisë në transmetim të ndërmarrin hapa për të rritur pluralizmin e përbajtjes. Ka modele të ndryshme në Europë për të përzgjedhur kanalet që shfaqen në multiplekse. Kjo mund të bëhet nga rregullatori ose pronari i multipleksit. Nëse është përzgjedhur ky i fundit, ekzistojnë rregulla dhe masa mbrojtëse të ndryshme të aplikuara për të siguruar diversitetin.

Këtu janë masat që do të prezantohen për të ndikuar ose kufizuar lirinë e operatorit të rrjetit për të hartuar përbërjen e multipleksit. Praktika aktuale në Europë është si në vijim:

1. Rregullat e përfshirjes së domosdoshme për ShPT dhe kanalet tjera tokësore janë të vendosura në Holandë dhe Austri, ndërsa masa të tilla nuk janë të nevojshme në Mbretërinë e Bashkuar, Spanjë apo Itali apo kurdo që transmetuesve tokësorë ju është ndarë pjesa e tyre e kapacitetit digjital.
2. Në Norvegji operatori i multipleksit rezervon një kapacitet për të ashtuquajturat “kanale të hapura” dhe, nëse kanalet lokale kërkojnë qasje në platformë, operatori i rrjetit është i detyruar për të gjetur një zgjidhje adekuate.
3. Në Itali masa të veçanta janë miratuar për të garantuar qasje në platformën për “kanale të pavarura”, d.m.th. kanalet që nuk janë në pronësi të transmetuesve që do të operojnë përmes kapacitetit TTD. Këto masa janë të rëndësishme pasi që kapaciteti nuk është ndarë nëpërmjet një procedure të rregullt, por ka qenë pak a shumë i “blerë” nga transmetuesit kombëtarë të gatshëm për të operuar në rrjetin TTD. Masat e tilla kanë për qëllim shmangien e vështirësive të krijuara nga integrimi vertikal i operatorëve të rrjetit TTD që kanë kanalet e tyre.²⁴

23 Paragrafi (35) i Dokumentit konkludues “Bashkëpunim në fushat humanitare e të tjera” në të takimin përcjellës të OSBE-së në Vjenë në vitin 1986 / Liria e shprehjes, Rrjedha e lirë e informacionit, Liria e mediave: Dispozitat kryesore të KSBE/OSBE 1975-2007. Publikuar në: http://www.osce.org/fom/item_11_30426.html

24 Grupi punues për Televizionin Tokësor Digjital në vendet e PEAR (EPRA). Raporti final. 2 qershor 2004. Shih në faqen zyrtare të PEAR, Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, në: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTTWG_finalreport.doc

Situata me përqendrimin e televizionit analog në Itali mund të jetë e afërt me atë në vendet post-sovjetike. Prandaj, është me interes të bëjmë përpjekjet për të siguruar pluralizmin e përmbajtjes në procesin e kalimit në transmetime digjitale në këtë vend.

Praktikë e mirë në lidhje me këtë çështje duket të jetë vendimi i *Autorità per le garanzie nelle comunicazioni* (Autoriteti italian për komunikime - AGCOM) i datës 6 korrik 2005. Vendimi respektoi dispozitat përkatëse të Aktit mbi Transmetimet të vitit 2004. AGCOM përcaktoi kushtet për ofruesit e pavarur të përmbajtjes (programore) që do të zhvillohen në një kuotë të rezervuar prej 40 për qind të kapacitetit të TTD multipleksëve të dy aktorëve kryesorë në fushën e transmetimit, RAI dhe R.T.I. S.p.A. (pjesë e Mediaset Group), deri në zbatimin e plotë të planit kombëtar të frekuencave digjitale. Ofruesit e përmbajtjes (programore) duhet të:

- Respektojnë parimet e pluralizmit dhe të objektivitetit dhe të ofrojnë skemë programore me një mbulim të gjerë të zhanreve të ndryshme, në mënyrë që të kënaqin shijet e kategorive të ndryshme të shikuesve, veçanërisht gjatë kohës së shikueshmërisë më të lartë;
- Respektojnë të drejtat themelore të njeriut dhe të përmbahen nga transmetimi i programeve të dhunshme ose pornografike;
- Ofrojnë skemë programore tërheqëse për të rritur pjesën e audiencës por edhe të ardhurat nga reklamat në frekuencat TTD dhe në përputhje me të paktën të dy kushteve të mëposhtme:
 1. Programe argëtuese, siç janë emisionet debatuese/intervistuese, lojërat, programe që kanë të bëjnë me ngjarje të veçanta (sportive, çështje sociale, kulturë, muzikë);
 2. Programet me interes të përgjithshëm që thellojnë vetëdijen shkencore, çështjet kulturore, historike ose muzikore;

3. Fikcion, TV-filma, seriale, komedi dhe vepra kinematografike, përveç detyrimeve në lidhje me veprat Europiane që rrjedhin nga Direktiva e BE-së për Televizionin pa kufij (më vonë të ndryshuar/plotësuar nga Direktiva për Shërbimin e mediave audiovizuale)²⁵;
4. Programet kushtuar fëmijëve dhe të rinjve.

Nëse kapaciteti që është në dispozicion dëshmohej se është i pamjaftueshëm për të kënaqur të gjitha kërkesat, përparësi duhet t'u jepet atyre që ofrojnë shumicën e zhanreve të lartpërmendura. Kapaciteti duhet të caktohet nën kushte të drejta, transparente dhe jo-diskriminuese me qëllim të sigurimit të programeve pluraliste.

Për këtë arsye, RAI dhe R.T.I. duhet të informojnë publikun të paktën 60 ditë përpara në faqet e tyre të internetit në lidhje me qëllimin e tyre për të caktuar TTD kapacitetin, duke specifikuar kushtet teknike dhe ekonomike të cilat e kanë ndërmend të aplikojnë. Të gjitha marrëveshjet ndërmjet RAI/R.T.I. dhe ofruesve të interesuar të përmbajtjes programore duhet paraprakisht t'i dorëzohen AGCOM-it, për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me detyrimet e lartpërmendura. AGCOM është gjithashtu kompetent për t'u marrë me zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të lind gjatë vlefshmërisë së këtyre marrëveshjeve.²⁶

Masat tjera rregullatore të miratuara për të garantuar qasjen janë të radhitura në një raport nga ana e Platformës Europiane të Autoriteteve Rregullatore. Për shembull, me rregullore mund të kërkohet nga ofruesit e rrjetit që të ofrojnë kushte të drejta, transparente dhe jo-diskriminuese. Nga ofruesit e rrjetit, si dhe operatorët e platformës, mund të kërkohet që të publikojnë një listë çmimesh për shërbimet teknike të ofruara për ofruesit e përmbajtjes (gjithashtu edhe për kodimin e sinjalit, EPG, etj.). Kur operatori i rrjetit ose platformës është gjithashtu edhe transmetues, mund të jetë e nevojshme që të mbahen llogari ndaras për secilin aktivitetet të tij të veçantë.²⁷

25 **Direktiva 2010/13/EU.**

26 *Cappello M.* Itali: 40% e kapacitetit TTD në multiplekset e RAI-t dhe R.T.I. për Ofruesit e Pavarur të Përmbajtjes // IRIS 2005-9:15/26. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2005/9/article26.en.html>

27 Shih Tabelën 5.4 në: Grupi punues për Televizionin Tokësor Digjital në vendet e PEAR (EPRA). Raporti final. 2 qershor 2004. Shih në faqen zyrtare të PEAR, Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, në: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTTWG_finalreport.doc

Rekomandimi për pluralizmin e mediave të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës më tej sugjeron që shtetet anëtare të vlerësojnë, në nivel kombëtar dhe rregullisht, efikasitetin e masave ekzistuese për të nxitur pluralizmin e mediave dhe diversitetin e përmbajtjes, duke shqyrtuar nevojën e mundshme për t'i reviduar ato si pasojë e zhvillimeve ekonomike, teknologjike dhe sociale.

Në konferencat kushtuar të ardhmes së shërbimit publik të transmetimit dhe kalimit në transmetimet digjitale të mbajtura nën patronazhin e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave në Almati (Konferenca e 10-të e Azisë Qendrore për Mediat, më 16-17 tetor 2008) dhe në Tbilisi (Konferenca e 5-të e Kaukazit Jugor për Mediat, 13-14 nëntor 2008), pjesëmarrësit shprehën shqetësimin se transmetuesit e vegjël, lokal dhe provincial privat që veprojnë përmes-ajrit (analog) nuk do të jenë në gjendje të përballojnë hyrjen në tregun e TTD, pa ndihmën nga jashtë (p.sh. stacionet si GALA-TV në Giumri, Armeni). Ata janë të popullarizuar në mesin e shikuesve vendas, ata janë të rëndësishëm për pluralizmin informativ dhe politik të mediave, por qeveria i lë ata vetëm para kostos në rritje të kalimit në transmetime digjitale. Është ngritur edhe shqetësimi që qeveritë ishin të kënaqura me pamundësinë e transmetuesve të vegjël privat për të arritur tek audiencia e tyre.

Këshilli i Europës rekomandon që përderisa bëhet inkurajimi për një kalim të shpejtë, qeveritë gjithashtu duhet të sigurojnë që të merren parasysh interesat e publikut, si dhe ato të transmetuesve, veçanërisht atyre jo-komercial, rajonal dhe lokal. Në këtë drejtim, duhet të ofrohet një kornizë e përshtatshme ligjore dhe kushte të favorshme ekonomike dhe teknike.²⁸

28 Shih: Shtojcën për Rekomandimin Rec (2003)9 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital

3.2 Detyrimet e përmbajtjes (programore)

Konventa mbi Televizionin Tej-kufitar²⁹ e Këshillit të Europës dhe Direktiva mbi Shërbimet e Mediave Audiovizuale³⁰, instrument i saj paralel në Bashkimin Europian, numëron objektiva të caktuara të rëndësishme me interes të përgjithshëm në lidhje me përmbajtjen audio-vizuale. Këto përfshijnë detyrime për shtetet anëtare për të ndërmarr masa për të siguruar që:

- Shërbimet audio-vizuale nuk përmbajnë ndonjë nxitje të urrejtjes në baza racore, gjinore, fetare ose kombëtare;³¹
- Disponueshmëria e shërbimeve mediale audio-vizuale të kërkuara të cilat mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve është e kufizuar në mënyrë të duhur;³²
- Për qëllimin e raportimeve të shkurtra të lajmeve, çdo transmetues ka qasje në një mënyrë të drejtë, të arsyeshme dhe jo-diskriminuese, në ngjarjet me interes për publikun të cilat transmetohen në baza ekskluzive nga një transmetues nën juridiksionin e tyre.³³

Është e qartë se në periudhën e kalimit në transmetimin digjital, i cili ofron qasje në një shumëllojshmëri të gjerë të përmbajtjes, qeveritë dhe rregullatorët kombëtarë duhet të jenë veçanërisht vigjilentë që të sigurojnë respektimin për mbrojtjen e të miturve dhe të dinjitetit njerëzor dhe të mos-nxitjes për dhunë dhe urrejtje. Zhvillimi i mjeteve të reja teknike për kontroll prindëror nuk duhet të reduktojë përgjegjësitë e transmetuesve. Megjithatë, e gjithë kjo nuk do me thënë, edhe ndërhyrjen në lirinë redaktuese. Përmbajtja e transmetimit digjital është e ndikuar nga detyrimet e përfshirjes së domosdoshme sa i përket ShPT.

29 Miratuar më 5 maj 1989. Teksti është ndryshuar sipas dispozitave të Protokollit (ETS Nr. 171), i cili hyri në fuqi më 1 mars 2002. Tani nën revidim të ri.

30 Direktiva 2010/13/EU për koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore apo veprime administrative në shtetet anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale (Direktiva mbi Shërbimet e Mediave Audiovizuale)

31 N e n i 3b. Artikulli 9 i Rekomandimit (2003)9 gjithashtu trajton çështjen e mos-nxitjes së urrejtjes dhe dhunës me origjinë racore dhe fetare në transmetimet digjitale.

32 N e n i 3i. Përsëri, Artikulli 9 i Rekomandimit (2003)9 gjithashtu trajton këtë çështje.

33 N e n i 3k.

Rekomandimi (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës sugjeron se detyrimet e vendosura të “përfshirjes së domosdoshme” nga shtetet anëtare duhet të jenë të arsyeshme, d.m.th. ato duhet të jenë proporcionale dhe transparente si pasojë e objektivave të interesit të përgjithshëm të përcaktuara në mënyrë të qartë, dhe mund, kur është e përshtatshme, të përfshij një dispozitë për shpërblim proporcional. Këto detyrime të “përfshirjes së domosdoshme” mund të përfshijnë transmetimin e shërbimeve të dizajnuara në mënyrë specifike për të mundësuar qasje adekuate për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Kapitulli 4. Shërbimi Publik i Transmetimit në epokën digjitale

Shërbimi publik i transmetimit është një element jetik i demokracisë. Pa marrë parasysh nëse drejtohet nga organizatat publike ose kompanitë private, shërbimi publik i transmetimit ndryshon nga transmetimi i thjeshtë komercial apo politik për shkak të qëllimit të tij të caktuar: për të vepruar në mënyrë të pavarur nga ata që kanë pushtetin mbi ekonominë dhe politikën. Ai i ofron shoqërisë informacione, kulturë, edukim dhe argëtim; ai e fuqizon qytetarinë sociale, politike dhe kulturore dhe e nxit kohezionin social. Për këtë qëllim, ai zakonisht është universal në aspektin e përmbajtjes dhe qasjes; ai garanton pavarësinë dhe paanësinë redaktuese; ai ofron një pikë referimi të cilësisë; ai ofron një shumëllojshmëri të programeve dhe përkujdeset për nevojat e të gjitha grupeve në shoqëri; për më tepër, ai jep llogaridhënie publikisht.³⁴

Këto parime gjejnë zbatim për çfarëdo ndryshimesh që mund të prezantohen për të përmbushur kërkesat e radio-televizionit digjital. Organizuar nga Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave në vitin 2008, Konferenca e 10-të e Azisë Qendrore për Mediat deklaroi se shërbimi publik i transmetimit është një nga mjetet themelore të demokracive - i pazëvendësueshëm për të siguruar lirinë dhe transparencën e zgjedhjeve, në luftën kundër fjalimeve të urrejtjes, si dhe në mbrojtjen e kulturave të pakicave të një vendi duke ofruar raportim objektiv të lajmeve dhe duke transmetuar programe me cilësi të lartë.

Konferenca sponsorizuar nga OSBE-ja më tej thekson se në epokën digjitale, rëndësia e shërbimit publik të transmetimit pa reklama komerciale me cilësi të lartë dhe skemë programore objektive vetëm sa vjen e rritet.³⁵

34 Rekomandimi 1641 (2004) Shërbimi Publik i Transmetimit i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës në: <http://assembly.coe.int/main.asp?Link=/documents/adoptedtext/ta04/erec1641.htm>

35 Konferenca e 10-të e Azisë Qendrore për Mediat "E ardhmja e shërbimit publik të transmetimit dhe kalimi në transmetime digjitale në Azinë Qendrore". Almati, 16-17 tetor 2008. Shih: http://www.osce.org/documents/html/pdf/html/34491_en.pdf.html

Ky këndvështrim është në përputhje me qëndrimin e Këshilli të Europës duke deklaruar se *“roli specifik i shërbimit publik të transmetimit si një faktor i unitetit, i aftë për të ofruar një zgjedhje të gjerë të programeve dhe shërbimeve për të gjitha pjesët e popullsisë, duhet të ruhet në mjedisin e ri digjital”*.³⁶

Rekomandimi Rec (2007)3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi qëllimet e shërbimit publik të mediave në shoqërinë e informacionit (nga 31 janari 2007) ofron një fokusim mbi implikimet e mjedisit të ri digjital dhe rolin specifik të shërbimit publik të transmetimit në shoqërinë e informacionit. Ai deklaron se qëllimi është edhe më i rëndësishëm në epokën digjitale dhe shtetet anëtare duhet të sigurojnë që mediat e shërbimit publik mund të ofrohen nëpërmjet platformave të ndryshme që rezultojnë nga paraqitja e teknologjive të reja.

Rekomandimi sugjeron që shtetet anëtare të garantojnë rolin fundamental të mediave të shërbimit publik në mjedisin e ri digjital; të përfshijnë dispozita në legjislacionin e tyre dhe rregullore të veçanta për qëllim të mediave të shërbimit publik, duke mbuluar në veçanti shërbimet e reja të komunikimit; t’ju garantojnë mediave të shërbimit publik kushtet financiare dhe organizative të nevojshme për të kryer funksionin e besuar atyre në mjedisin e ri digjital në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme; t’i mundësojnë mediat e shërbimit publik që t’i përgjigjen plotësisht dhe në mënyrë efektive sfidave të shoqërisë së informacionit, duke respektuar strukturën e dyfishtë të peizazhit European të mediave elektronike, të transmetuesve publik dhe privat, dhe duke i kushtuar vëmendje çështjeve të tregut dhe të konkurrencës; dhe të sigurojnë që qasja universale në mediat e shërbimit publik i është ofruar të gjithë individëve dhe grupeve shoqërore.³⁷

36 Rekomandimi Rec (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital.

37 Rekomandimi Rec (2007)3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi qëllimet e shërbimit publik të mediave në shoqërinë e informacionit (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 janar 2007 në takimin e 985-të të Zëvendësministrave). Shih: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1089759>

Rekomandimi (2003)⁹ i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital është shumë specifik sa i përket parimeve të aplikueshme për shërbimin publik të transmetimit në mjedisin e ri. Parimi i parë ka të bëjë me qëllimin e ShPT. Ai insiston që:

“...ballafaquar me sfidat e lidhura me ardhjen e teknologjive digjitale, shërbimi publik i transmetimit duhet të ruaj qëllimin e vet të veçantë social, duke përfshirë edhe një shërbim të përgjithshëm themelor që ofron lajme, programe arsimore, kulturore dhe argëtuese që synojnë kategori të ndryshme të publikut. Shtetet anëtare duhet të krijojnë kushtet financiare, teknike dhe të tjera që nevojiten për t’iu mundësuar transmetuesve të shërbimit publik që të përmbushin këtë qëllim në mënyrën më të mirë duke iu përshtatur mjedisit të ri digjital. Në këtë kuptim, mjetet për të përmbushur qëllimin e shërbimit publik mund të përfshijnë ofrimin e kanaleve të reja të specializuara, për shembull në fushën e informacionit, arsimit dhe kulturës, dhe të shërbimeve të reja interaktive, për shembull EPG dhe shërbimet on-line të lidhura me programin. Transmetuesit e shërbimit publik duhet të luajnë një rol qendror në procesin e tranzicionit në transmetim digjital tokësor”.

Parimi i dytë ka të bëjë me qasjen universale në shërbimin publik të transmetimit:

“Universaliteti është fundamental për zhvillimin e shërbimit publik të transmetimit në epokën digjitale. Prandaj, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që janë krijuar kushtet ligjore, ekonomike dhe teknike për të mundësuar transmetuesit e shërbimit publik të jenë të pranishëm në platforma të ndryshme digjitale (kabllore, satelitore, tokësore) me programe me cilësi të ndryshme dhe shërbimet që janë të afta për të bashkuar shoqërinë, veçanërisht duke pasur parasysh rrezikun e fragmentimit të audiencës, si rezultat i diversifikimit dhe specializimit të programeve të ofruara. Në lidhje me këtë, duke pasur parasysh diversifikimin e platformave digjitale, rregulla e përfshirjes së domosdoshme duhet të zbatohet për të mirën e transmetuesve të shërbimit publik për aq sa është e arsyeshme për të garantuar pranimin e shërbimeve dhe programeve të tyre nëpërmjet këtyre platformave”.

Parimi i tretë ka të bëjë me çështjet e financimit të shërbimit publik të transmetimit:

“Në kontekstin e ri teknologjik, pa një kornizë të sigurt dhe të përshtatshme financimi, shtrirja e transmetuesve të shërbimit publik dhe shkalla e kontributit të tyre në shoqëri mund të zvogëlohet. Të ballafaquar me rritjen e kostos së blerjes, prodhimit dhe ruajtjes së programeve, dhe ndonjëherë edhe të transmetimit, shtetet anëtare duhet t’ju japin transmetuesve të shërbimit publik mundësinë për të pasur qasje në mjetet e nevojshme financiare për të përmbushur qëllimin e tyre”.³⁸

Për sa i përket rolit të luajtur nga ShPT, në të gjitha rastet e një studimi të kryer nga ana e Platformës Europiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA), me përjashtim të Spanjës, transmetuesve publikë u janë ndarë një ose më shumë multiplekse, në vend të kapacitetit për të transmetuar njëkohësisht vetëm kanalet tokësore ekzistuese. Në shumicën e rasteve, ShPT-të kanë qenë të lira të vendosin rreth përbërjes së multipleksit.³⁹

Vërtetë, teknologjitë digjitale parashikojnë mundësinë e zgjerimit të spektrit të programeve të shërbimit publik të transmetimit. Kjo do t’ju shërbejë qëllimeve të përgjithshme të qeverisë për promovimin e dy formave të transmetimit, digjital dhe atij publik. Në të njëjtën kohë, një mundësi e tillë zakonisht e mbështetur nga taksa për licencë apo fondet publike nuk duhet të paraqes konkurrencë të padrejtë për transmetuesit privat dhe të parandaloj zhvillimin e sektorit të televizionit të pavarur. Zgjerimi i tillë duhet të konsiderohet të jetë i dallueshëm dhe të ketë një vlerë të qartë të shërbimit publik. Prandaj ai duhet të miratohet nëse i plotëson kushtet.

38 Shtojcë për Rekomandimin R (2003)9 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital.

39 Grupi punues për Televizionin Tokësor Digjital në vendet e PEAR (EPRA). Raporti final. 2 qershor 2004. Shih në faqen zyrtare të PEAR, Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, në: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTTWG_finalreport.doc

Si një shembull mund të shpjegohet zgjerimi digjital i **BBC-së, që është transmetues publik në Mbretërinë e Bashkuar**. Në shtator të vitit 2001, Sekretari britanik i Shtetit për Kulturë, Media dhe Sport miratoi tri kanale të reja digjitale të BBC-së (pëlqimi ministror është i nevojshëm për shërbime të reja sipas Marrëveshjes me Sekretarin e Shtetit i cili përcakton kompetencat e BBC-së). Këto programe përfshinin dy kanale për fëmijë (një për ata të moshës nën gjashtë vjet dhe një për ata të moshës gjashtë deri në trembëdhjetë vjet) dhe një shërbim televiziv të specializuar për kulturë, art dhe ide. Në vitin 2003, Sekretari më tej miratoi edhe Kurrikulën (Plan-programin) Digjitale të BBC-ës, një burim i ri i të mësuarit që synon shkollat, mësimdhënësit, nxënësit dhe nxënësit individual. Në të gjitha këto raste miratimet ishin të kushtëzuara, që kërkonin një përpjesëtim të lartë të skemës programore të BE/ZEE-së dhe një orar të përzier programor, përfshirë edhe materialet për qëllime edukative, informative, si dhe argëtuese. Opozita nga sektori privat ishte veçanërisht e fuqishme në këtë rast, dhe një total prej 18 kushtesh iu bashkëngjiti miratimit të fundit në përpjekje për t'u siguruar që shërbimi është komplementar dhe dallon nga shërbimet e ofruara nga sektori komercial. Kushtet për Kurrikulën Digjitale përfshijnë kërkesat për të sjellë risi dhe promovuar eksperimentimin arsimor dhe teknologjik, për të ruajtur standardet e larta të cilësisë së përmbajtjes dhe integritetin redaktues, dhe të publikojë planet vjetore të përmbajtjes që mbulon pesë vitet e ardhshme. BBC-ja është e detyruar të raportojë çdo vit rreth performancës së shërbimit dhe pas dy vitesh do të kryejë një shqyrtim i shërbimit për të vendosur nëse BBC-ja plotëson kushtet. Ky shqyrtim përfshin një element të pavarur dhe konsultimin publik, dhe gjithashtu shqyrton ndikimin e Kurrikulës Digjitale të BBC-së në tregun e softuerit arsimor. BBC-ja gjithashtu premtoi të shpenzojë gjysmën e buxhetit prej £90 milionë për përmbajtjen duke angazhuar shërbime nga sektori privat.²

Këshilli i Europës njeh detyrimin e shteteve anëtare të vet, për të ruajtur dhe, kur është e nevojshme, krijuar një kornizë të përshtatshme dhe të sigurt financimi që ju garanton transmetuesve të shërbimit publik mjetet e nevojshme për të përmbushur qëllimin që u është caktuar atyre nga shtetet anëtare në mjedisin e ri digjital.⁴⁰

40 Rekomandimi Rec (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital.

Kapitulli 5. Strategjia: Procesi i planifikimit

Është shumë e rëndësishme për suksesin e këtij procesi që të kemi një plan të mirë digjitalizimi që merret me të gjitha çështjet e ndryshme të përmendura në këtë udhëzues.

Shumë probleme të mundshme mund të shmangen nëse ato trajtohen herët dhe zgjidhjet janë qartë të paraqitura në një plan, të zhvilluar në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara. Ka edhe pyetje të ndryshme paraprake që duhet të sqarohen për të bërë planin. Procesi i planifikimit duhet të jetë sa më përfshirës që është e mundur.

Ky kapitull shpjegon procesin e planifikimit dhe përmbajtjen e planit.

5.1 Plani

Para se të fillojë planifikimit aktual është e rëndësishme për t'u përgjigjur disa pyetjeve themelore, për të ditur nëse vendi është gati për digjitalizim. **Në mënyrë që të ndjehen efektet pozitive të digjitalizimit duhet të ekzistoj një rend transparent në sektorin e transmetimit, pluralizëm dhe diversitet i transmetimit dhe një rregullator funksional i pavarur para se të zhvillohet digjitalizimi.** Nuk është e mundur që të "riparohen" problemet me kornizën ligjore-rregullatore me një ShPT ose një monopol shtetëror të platformave të transmetimit nëpërmjet digjitalizimit. Aspektet e ndryshme të peizazhit të komunikimit të një vendi ndikojnë në procesin e digjitalizimit, kryesisht çështja se si shumica e njerëzve pranojnë transmetimet e tyre (depërtimi i kablllove, internet i brezit të gjerë - broadband, satelitë për transmetim të drejtpërdrejt apo forma të tjera të pranimit). Kjo ka një ndikim në mënyrën se sa njerëz do të kenë nevojë të furnizohen me pajisje të veçantë për pranim digjital.

Pasi digjitalizimi sjell ndryshime për disa aktorë të ndryshëm, është e rëndësishme që procesi të planifikohet mirë. Hapi i parë në këtë proces zakonisht është miratimi i një plani të digjitalizimit nga qeveria apo parlamenti. Transmetuesit privat, si dhe ShPT dhe rregullatori i transmetimit, duhet të përfshihen në planin e digjitalizimit, pasi që është e rëndësishme që ai të mos konsiderohet si një dokument politik partiak.

Plani duhet të paraqes se çfarë ndryshimesh ligjore janë të nevojshme për të inkurajuar e jo vetëm për të lejuar digjitalizimin. Nevoja për përgatitjen adekuate të digjitalizimit është vënë në dukje nga organizatat ndërkombëtare siç është Këshilli i Europës dhe EBU. Kjo është e rëndësishme për sigurinë juridike, një parim i rëndësishëm i sundimit të ligjit, që do të thotë një rend juridik i qëndrueshëm dhe i besueshëm, në mënyrë që veprimet e autoriteteve publike mund të parashikohen dhe qytetarët dhe kompanitë e dinë se çfarë pritet prej tyre.

Është e rëndësishme që të mos ndërpritet transmetimi analog deri sa të arrihet një depërtim pothuaj universal i transmetimit digjital. Kjo do të thotë se datat e ndërprerjes duhet të jenë fleksibile për të marrë parasysh ndryshimet në përparimin e pritur. Një lansim, i ashtuquajtur, i butë, duke përdorur frekuencat e disponueshme dhe duke e bërë kalimin gradualisht, ofron më shumë kohë për planifikimin. Disavantazh është se është e kushtueshme që të ketë njëkohësisht transmetime në sistemin analog dhe atë digjital. Një kalim gradual, sipas rajoneve, gjithashtu lejon më shumë kohë dhe për të mësuar nga gabimet në një rajon para se të bëhet kalimi në rajonet tjera, por në përgjithësi tani ka shumë pak kohë për kalim duke pasur parasysh afatin e paraqitur nga BNT (ITU).

Procesi i kalimit në transmetime digjitale duhet të jetë i udhëhequr nga tregu, por në të njëjtën kohë nevojitet koordinimi i transmetuesve për të arritur një zbatim të qetë teknik dhe komercial (p.sh. afatet kompatible). BE-ja ka theksuar se vendet anëtare të cilat mbështeten jo vetëm në një përqasje të udhëhequr nga tregu, por edhe në veprim të qartë të politikave publike për të koordinuar transmetuesit kanë prirje të jenë më të hershme në procesin e miratimit dhe kalimit në transmetime digjitale. Një tipar i rëndësishëm i koordinimit është pajtimi lidhur me afatin për faza të ndryshme. Komisioni në Komunikatën e tij thotë se kjo ofron siguri më të madhe për aktorët e tregut që

bëjnë furnizimin me produkte digjitale dhe shërbime dhe i inkurajon ata për të stimuluar kërkesën.⁴¹

Digjitalizimi ka ndikim në teknologji të ndryshme. Shumica e planeve Europiane për kalim në transmetime digjitale kryesisht fokusohet në platforma tokësore. Por, në rregullimin bashkëkohor, ekziston një parim i neutralitetit teknologjik, që do të thotë se rregullimi nuk duhet as të imponojë dhe as të diskriminojë në dobi të një lloji të veçantë të teknologjisë. Është e mundur që vetëm të ndërmerren hapa proporcional për të promovuar teknologjitë e veçanta; për shembull, rritja e efikasitetit të spektrit.⁴²

Sidoqoftë, përgatitjet duhet të bëhen sa më shpejt të jetë e mundur, në konsultim me palët e përfshira, duke përfshirë edhe sektorin e transmetimit dhe të shoqërisë civile. Digjitalizimi nuk duhet të lejohet të zvogëloj diversitetin dhe pluralizmin dhe kurrë nuk duhet të përdoret si një justifikim për të kufizuar transmetimin e lirë dhe të pavarur. Nëse peizazhi transmetues në një vend nuk është pluralist dhe i larmishëm, do të ishte më mirë të vonohet digjitalizimi dhe së pari të ndërmerren reforma të tjera. Digjitalizimi ngre pyetje të reja rreth rregulloreve dhe politikave - mundësi të reja dhe sfida të shumta. Stimulimet janë të nevojshme përmes legjislacionit, jo vetëm për të lejuar, por edhe inkurajuar digjitalizimin.

Standarde të ndryshme digjitale për kompresimin e videos dhe formateve të skedave mund të përdoren për të kompresuar të dhënat për të formuar pjesëza të vogla që mund të transportohen dhe të dekompresohen, normalisht duke përdorur një dekoder. Standardet janë zhvilluar nga Grupi i ekspertëve të fotografive lëvizëse (Moving Pictures Expert Group - MPEG), grup punues i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO). Standardet MPEG, me numra të ndryshëm për gjeneratat e ndryshme të standardeve, zakonisht kërkojnë dekoderë të ndryshëm. MPEG 2 është përdorur më së shpeshti në vendet që bënë digjitalizimin më herët. Por, tani më gjerësisht përdoret MPEG 4.

41 Komunikata COM(2005) 204 final, "Mbi përshpejtimin e tranzicionit nga transmetimi analog në atë digjital".

42 Po aty.

MPEG 4 pajisjet mund të përdoren për të marrë MPEG 2 sinjalet, por jo edhe anasjelltas. Ekzistojnë përparësi nëse menjëherë shkohet me MPEG 4; megjithatë, kjo është e mundshme vetëm në qoftë se kështu vendoset në fillim të procesit. Përndryshe në qoftë se njerëzit kanë një lloj pajisjesh ata nuk do të jenë të interesuar për të blerë një lloj tjetër, posaçërisht pasi MPEG 4 është një teknologji më e shtrenjtë. Ky problem tashmë është përballur nga digjitalizuesit e hershëm siç është Suedia.

5.2 Pjesëmarrja e publikut në planifikimin për digjitalizim

Digjitalizimi është një ndryshim madhor në peizazhin e transmetimit dhe me interes për shikuesit, si dhe për industrinë përkatëse. Është e rëndësishme pjesëmarrja maksimale e publikut në ligj-bërje duke përfshirë bërjen e strategjisë. Mund të paraqitet nevoja për një organ të veçantë për t'u marrë me digjitalizimin, duke përfshirë përhapjen e informacionit. Shumë vende kanë organe të veçanta për kalimin në transmetim digjital. Një organ i tillë do të ketë gjithashtu rol të rëndësishëm në publikimin dhe diskutimin publik të kësaj çështjeje. Ky organ duhet të bashkëpunoj shumë ngushtë me rregullatorin e pavarur. Stimulimi i kërkesës dhe interesimit për transmetimet digjitale është një pjesë e rëndësishme e procesit të kalimit, por gjithashtu edhe për t'i nxitur njerëzit për të blerë set-top kutitë dhe vullnetarisht të migrojnë në sistemin digjital. Migrimi i tillë ka qenë zhgënjyes në tërë Europën, gjë që e thekson rëndësinë e informacionit për të stimuluar kërkesën. Është i rëndësishëm vetëdijesimi i njerëzve për procesin. Fushatat e informimit siç janë ueb-faqet në Mbretërinë e Bashkuar, Finlandë dhe Suedi janë shembuj të përpjekjes për të krijuar interesimin dhe njëkohësisht për të përhapur njohurinë.

Një organ i veçantë për digjitalizim u krijua në Mbretërinë e Bashkuar. Digital UK është një organizatë jo-fitimprurëse e krijuar nga transmetuesit e shërbimit publik dhe operatorët e multiplekseve për të udhëhequr implementimin e kalimit në transmetime digjitale. Kjo përfshin: koordinimin e lansimit teknik të rrjetit të televizionit tokësor digjital me fuqi të madhe; komunikimi me publikun rreth kalimit në sistemin digjital për t'u siguruar se të gjithë e dinë se çfarë po ndodh, se çfarë duhet të bëjnë dhe kur; dhe ndërlidhjen me palët e interesuara për të siguruar mirëkuptim dhe mbështetje për programin e kalimit në transmetime digjitale.³

Detyrat e rregullatorit mbeten shumë të rëndësishme dhe në rast se rregullatori ka një rol në përzgjedhjen e kanaleve është e domosdoshme për t'u siguruar që vendimet për përzgjedhjen e kanaleve janë të bazuara në kritere transparente dhe objektive. Autoriteti rregullator duhet të jetë në gjendje të veproj për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes të kompanive, për shembull në rastet kur operatorët e multiplekseve bëjnë përzgjedhjen e kanaleve. Është shumë e rëndësishme që rregullatori të jetë i pavarur nga çdo kompani. Nuk duhet të ketë lidhje të ngushta midis ish-transmetuesit shtetëror ose pronarit të transmetuesit dhe rregullatorit, pasi ekziston një rrezik kur ata vijnë nga i njëjti sfond.

Një nga parimet në Rekomandimin e Këshillit të Europës⁴³ është se shtetet duhet të hartojnë strategji të mirë-përkufizuara për digjitalizim. Në shumë vende janë mbajtur proceset publike të bërjes së rregullave sa i përket strategjisë së digjitalizimit. Edhe në qoftë se publiku i përgjithshëm ka gjasë të mos kontribuoj shumë në një proces të tillë teknikisht të ndërlikuar, këtë do ta bëjnë përfaqësuesit e industrisë dhe palëve posaçërisht të interesuara. Kontributi është i rëndësishëm për aspekte të ndryshme, siç janë përmbajtja e transmetimeve, specififikimet teknike, çështjet e infrastrukturës dhe shumë të tjera.

43 Rekomandimi Rec (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital.

Rekomandimi (2003)⁹ thotë se strategjitë e transmetimit digjital duhet të hartohen *“në konsultim me industri të ndryshme të përfshira dhe me publikun”*. Më tutje rekomandimi kërkon nga strategjitë e tilla që të synojnë nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve dhe të lehtësojnë kalimin e publikut në transmetime digjitale, përmes masave t'i ofrojnë publikut informacione të gjera me theks të veçantë tek sektorët më pak të favorizuar të popullsisë dhe tek të moshuarit. Kalimi në sistemin digjital gjithashtu ka potencial të kontribuoj në shërbim më të mirë rreth nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara. Vëmendje duhet t'i kushtohet përfshirjes së kërkesave të qasshmërisë në ndërthurjen e përdoruesit (user interface), siç janë udhëzuesit elektronik të programit dhe pajisjeve marrëse.⁴⁴ Një faktor tjetër i rëndësishëm për suksesin e kalimit në sistemin digjital është një strategji efektive për të informuar konsumatorët për disponueshmërinë e programeve në platformat digjitale dhe pajisjet e nevojshme për të pranuar programe të tilla.

5.3 Ndhma për publikun

Ekzistojnë politika të ndryshme praktike për të lehtësuar depërtimin e pajisjeve marrëse për televizionin digjital. Dy llojet të masave të tilla janë vërejtur nga Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA):

1. Subvencionet ose mbështetjet tjera të tërthorta financiare të ofruara familjeve për të inkurajuar blerjen e pajisjeve marrëse;
5. 2. Politikat e standardizimit që duhet të mbështesin përhapjen e pajisjeve marrëse ose aparateve të integruara televizive.⁴⁵

⁴⁴ Komunikata COM (2005) 204 final, “Mbi përshpejtimin e tranzicionit nga transmetimi analog në atë digjital”.

⁴⁵ Grupi punues për Televizionin Tokësor Digjital në vendet e PEAR (EPRA). Raporti final. 2 qershor 2004. Shih në faqen zyrtare të PEAR, Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, në: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTTWG_finalreport.doc

Shembulli i rregullores për mbështetje financiare publike është Ligji (296/2006) i miratuar në **Itali** më 27 dhjetor 2006.⁴⁶ Ai ofroi një zbritje të taksës mbi të ardhurat për konsumatorët të cilët gjatë vitit 2007 do të blejnë televizorë me zgjedhës kanalesh dhe dekoderë digjital të integruar. Reduktimi i tatimit mbi të ardhurat ishte i barabartë me 20 për qind të çmimit të paguar për pajisjet, deri në një zbritje maksimale prej 200€ për dekoder, me një masë totale të buxhetit prej 40 milionë €.⁴⁷

Për konsumatorët, kalimi në transmetim digjital do të thotë blerje e pajisjeve të reja për të dekoduar dhe hapur sinjalet digjitale dhe, për këtë arsye, një shpenzim i caktuar. Për të shmangur çdo formë të diskriminimit material dhe çdo rrezik të “ndasisë digjitale” në mes të kategorive të ndryshme sociale, Këshilli i Europës rekomandon që shtetet anëtare t'i kushtojnë vëmendje të posaçme mënyrave për reduktimin e kostos së pajisjeve të tilla.⁴⁸

Njësoj si në këtë rekomandim **Mbretëria e Bashkuar** në vitin 2005 vendosi për të ndihmuar procesin e kalimit në transmetimet digjitale duke krijuar Skemën e Ndhmës për Kalim në Transmetime Digjitale për t'i ofruar ndihmë personave të moshës 75 vjeçare e më lartë, atyre me aftësi tejet të kufizuara dhe atyre që janë të verbër ose me shikim të pjesërishëm. Skema administrohet nga BBC-ja dhe ofron pajisje për të konvertuar një aparat televizori, ndihmon në rregullimin e tij dhe ofron çdo veprim të nevojshëm për të përmirësuar antenën e televizorit; ajo është pa pagesë për ata që marrin ndihma të caktuara shtetërore, ndërsa të tjerët do të paguajnë një kontribut prej 40 £ për shpenzime.⁴⁹

Në **Lituani**, në vitin 2010 qeveria ka miratuar Rezolutën për Urdhëresën për pagesën e shpenzimeve të shkaktuara nga blerja e pajisjeve të nevojshme për të pranuar televizionin digjital.

46 Paragrafi 357 dhe Paragrafi 361 të Propozim Buxhetit për vitin 2007

47 <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/07/960&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en#n1> Masa të ngjashme janë miratuar edhe në vende të tjera, si p.sh. në Austri.

48 Shtojcë për Rekomandimin R (2003)9 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital.

49 *Prosser T.* Legjislacioni për të lejuar zbulimin e të dhënave për asistencën ndihmon në Kalimin në Transmetime Digjitale // IRIS 2007-9:15/20.

Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2007/9/article20.en.html> Shih gjithashtu: http://www.opsi.gov.uk/acts/acts2007/en/ukpgaen_20070008_en.pdf

Në përputhje me aktet mbi familjen dhe personat me të ardhura të ulëta (të ardhura mujore prej më pak se 525 Litash, ose 125€, për kokë) do të fitojnë të drejtën për të marrë shpërblim nga buxheti i shtetit për set-top kuti. Procesi i shpërblimit do të fillojë 6 muaj përpara datës së ndërprerjes së televizionit analog dhe do të përfundojë 3 muaj pas kësaj date.⁵⁰

5.4. Legjislacioni

Kalimi në mjedis digjital ofron përparësi, por ai gjithashtu paraqet rreziqe.

Për të duhet të bëhen përgatitjet adekuate në mënyrë që ai të kryhet në kushtet më të mira të mundshme në interes të publikut, si dhe të transmetuesve dhe industrisë audio-vizuale si tërësi. Duhet të arrihet një ekuilibër mes interesave ekonomike dhe nevojave sociale, por perspektiva qytetare duhet qartë të jetë prioritet. Në vitet e ardhshme duhet të tejkalohen disa pengesa të theksuara të migrimit, megjithëse përfitimet e ardhshme nga transmetimi digjital janë të pamohueshme.

Që të dy, edhe Komisioni Europian edhe Këshilli i BE-së pranojnë se kalimi i tillë nuk është thjesht një çështje teknike. Si pasojë e efekteve të mundshme ekonomike dhe sociale të kalimit të tillë, Komisioni përcakton disa kriteret për ndërhyrjet me politika nga shtetet anëtare. Është parakusht që fuqia e tregut dhe kërkesa e konsumatorit duhet të jenë mekanizmat udhëheqës të kalimit në transmetime digjitale. Nga ky këndvështrim, ndërhyrjet e politikave duhet të jenë *“transparente, të justifikuar, proporcionale dhe në kohë të duhur”* dhe gjithashtu duhet të *“formulohen në bazë të qëllimeve specifike dhe qartë të përkufizuara të politikave dhe vështirësive të tregut”*.

⁵⁰ *lešmantait J.* Urdhëresa e miratuar mbi pagesën e shpenzimeve të blerjes së set-top kutive // IRIS 2010-3/30. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2010/3/article30.en.html>

Ndërhyrjet duhet të jenë jo-diskriminuese dhe nga aspekti teknologjik neutrale.⁵¹

Shtetet duhet të zhvillojnë një kornizë legjislative dhe strategjinë për transmetimet digjitale. Ky rekomandim për të gjitha qeveritë kombëtare është përcaktuar nga Këshilli i Europës në Komitetin e tij të Ministrave në Rekomandimin (2003)9 mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital. Ky dokument parasheh që shtetet anëtare duhet të *“krijojnë kushte të përshtatshme ligjore dhe ekonomike për zhvillimin e transmetimeve digjitale”*. Përveç kësaj, ai parashikon që Shtetet duhet të hartojnë një strategji të mirë-përkufizuar që do të siguronte një kalim të menduar mirë nga transmetimet analoge në ato digjitale. Një strategji e tillë *“duhet të kërkojë të nxisë bashkëpunimin në mes të operatorëve, ndër-plotësimin në mes të platformave, ndërveprimin e dekoderëve, disponueshmërinë e një shumëllojshmërie të gjerë të përmbajtjes (programore), duke përfshirë edhe shërbimet pa pagesë të radios dhe televizionit, si dhe shfrytëzimin më të gjerë të mundësive të veçanta të cilat mund t'i ofrojë teknologjia digjitale pas ri-alokimit të domosdoshëm të frekuencave”*.⁵²

Strategjia e digjitalizimit nuk duhet të hartohet dhe miratohet si rezultat i bisedimeve me dyer të mbyllura mes bizneseve dhe qeverisë, por duhet të jetë nën vrotimin e vazhdueshëm të një diskutimi të gjerë publik, me qëllim të garantimit të pluralizmit të shërbimeve të transmetimit dhe qasjes së publikut në një zgjedhje të zgjeruar dhe të ndryshme të programeve cilësore. Është e preferueshme që strategjia e miratuar shpie në legjislacionin e ri të prezantuar dhe miratuar nga parlamenti, në vend të vendimeve qeveritare ose dekreteve presidenciale. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në menaxhimin e kalimit pa rrezikuar sigurinë ligjore.

51 Idema E. Komisioni Europian: Komunikimi për kalimin nga transmetimi analog në transmetimin digjital // IRIS 2003-10:4/5. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2004/1/article7.en.html> Shih gjithashtu: Idema E. Këshilli i Bashkimit Europian: Konkluzione mbi kalimin nga transmetimet analoge në ato digjitale dhe mbi Televizionin digjital dhe Komunikimin 3G me pajisje mobile // IRIS 2004-1:5/7 at: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2004/1/article7.en.htm>

52 Rekomandimi Rec (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital.

Procesi legjislativë i **Hungarisë** mund të shërbejë si shembull. Transmetimet e televizionit tokësor digjital kanë filluar këtu që nga viti 2004. Projekt-Strategjia e parë u publikua në tetor të vitit 2006. Kjo u pasua nga dy muaj konsultimesh publike. Zyra e Kryeministrit finalizoi strategjinë në përputhje me rezultatin e konsultimeve, që u bart në një dokument zyrtar të politikave. Më 7 mars 2007, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Kalimin në Transmetime Digjitale dhe vendosi të ndërmarrë masat e nevojshme rregullore për zbatimin e saj. Më vonë, në qershor të vitit 2007, Kuvendi i Hungarisë miratoi një statut për rregullat mbi transmetimin dhe për kalimin në transmetimet digjitale (Akti i Kalimit në Transmetime Digjitale). Ky ligj paraqet një ndarje të qartë të rregullimit të përmbajtjes dhe rregullimit të transmetimeve. Ai përmban një sërë dispozitash që synojnë zhvillimin e diversitetit të mediave. Në lidhje me këtë ky akt paraqet disa detyrime për operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimeve të ngjashme për ruajtjen dhe promovimin e kulturës kombëtare, diversitetin kulturor dhe pluralizmin e mendimit. Këto detyrime përfshijnë ri-përkufizimin e rregullave të “përfshirjes së domosdoshme”. Tipari më i rëndësishëm i Akti i Kalimit në Transmetime Digjitale është përkufizimi i kornizës së nevojshme ligjore për prezantimin e shërbimeve të televizionit tokësor digjital. Kjo përfshin prezantimin e dispozitave interpretuese siç janë nocionet “multipleks”, “ndërthurja e programit aplikativ”, “udhëzues elektronik i programit”, ose “shërbimi i televizionit digjital interaktiv”. Akti gjithashtu ofron një kornizë të qartë për shfrytëzimin e frekuencave për qëllime të transmetimit dhe një sërë rregullash për promovimin e konkurrencës, si dhe përcakton procedurën e tenderimit për operatorët e shërbimeve të transmetimit digjital tokësor. Implementimi i Aktit për Kalimin në Transmetime Digjitale është detyrë e autoritetit rregullator dhe i komisionit të posaçëm parlamentar për të hartuar dhe publikuar thirrjen për tender për operatorët e multiplekseve.⁴

Pas miratimit të Aktit, tenderët për multiplekset tokësore kombëtare, përfundimi i kontratave për TTD dhe fillimi i tij u zhvilluan gjatë vitit 2008.

Si shembuj tjerë të ligjeve për transmetimin digjital të miratuara në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së mund të përmenden të mëposhtmet.

Një Akt mbi Transmetimet Digjitale është miratuar në **Slovaki**.⁵ Paraqitja e televizionit tokësor digjital në **Irlandë** ishte parashikuar me Aktin e vitit 2001 për Transmetime. Në **Itali** transmetimi digjital është trajtuar me një pjesë të veçantë të Aktit për Transmetime nr. 112/2004. Në **Republikën Çeke**, korniza ligjore për televizionin digjital është themeluar përmes miratimit të amendamenteve të Aktit mbi Mediat nga ana e parlamentit. Akti përmban përkufizime të reja ligjore të termave si “EPG”, “rrjeti i komunikimit elektronik” dhe “shërbimet e transmetimit”. Gjithashtu janë shtuar udhëzimet e reja në lidhje me përqendrimin e transmetimit në sektorin digjital. Transmetuesve që dorëzojnë kapacitetet e tyre analoge në përputhje me një plan teknik të kalimit në sistemin digjital do t’ju jepet një licencë shtesë për transmetim digjital. Përgjegjësitë e Këshillit për Transmetim dhe Zyrës së Telekomunikacionit janë rishpërndarë në mënyrë që të ndahet tërësisht rregullimi i përmbajtjes (programore) dhe rregullimi i transmetimit.⁶

Kapitulli 6. Audiencia: Çështjet sociale dhe ekonomike

Për të qenë publiku në gjendje të gëzojë efektet pozitive të digjitalizimit me më shumë zgjedhje dhe me cilësi më të mirë, është e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendje faktit se sa do të kenë qasje në transmetim të gjitha grupet në shoqëri kur pajisjet e marrjes të ndryshojnë. Digjitalizimi ngre çështje të ndryshme sociale dhe ekonomike në lidhje me mënyrën se si njerëzit e fitojnë qasjen, me çmime të arsyeshme, në transmetime të ndryshme dhe me cilësi të lartë. Kjo përfshin edhe faktin nëse do të dhe si do të subvencionohen pajisjet e marrjes, gjithashtu edhe kërkesat për transmetuesit që të ofrojnë një shërbim universal.

6.1 Çështjet sociale dhe ekonomike dhe qasja në transmetim

Në planifikimin për digjitalizim, është thelbësore që të merret parasysh këndvështrimi i qytetarëve, që d.m.th., *mes tjerash*, mbulimi i popullatës, në vend të mbulimit të territorit. Kjo është një nga çështjet e vëre në dukje nga Këshilli i Europës.⁵³ Deklarata për ndarjen dhe menaxhimin e dividendit digjital dhe interesit publik (Deklarata e Dividendës Digjitale)⁵⁴ përfshin dispozita të cilave qeveritë duhet t'ju kushtojnë vëmendje të veçantë gjatë promovimit të qasjes për publikun në shërbimet audio-vizuale. Rekomandimi (2007)3 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi qëllimin e mediave të shërbimit publik në shoqërinë e informacionit sugjeron që Shtetet duhet *“të sigurojnë që qasja universale në mediat e shërbimit publik i është ofruar të gjithë individëve dhe grupeve shoqërore, duke përfshirë minoritetet dhe grupet*

53 Rekomandimi Rec (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital

54 Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi ndarjen dhe menaxhimin e dividendës digjitale dhe interesit publik (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 shkurt 2008 në takimin e 1018-të të Zëvendësministrave). Shih: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1252459&Site=CM&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=EDB021&BackColorLogged=F5D383>

e pafavorizuara, përmes një sërë mjetesh teknologjike.⁵⁵

Për të fituar përparësitë e mundshme të teknologjive të reja, çështja se si të sigurohemi që një numër sa më i madh i njerëzve do të mundësohet të përdorë teknologjinë e re në dobi të vet duhet të jetë lartë në listën e qëllimeve të planifikimit. Kjo do të përfshinte një vëmendje të veçantë për grupet e cenueshme të cilat nuk do të kenë mundësitë apo stimulimin për veten e tyre që të përqafojnë teknologjinë e re.

Grupet e rrezikuara sociale dhe disa njerëz me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për mbështetje të veçantë. Direktiva e BE-së për Televizionin pa kufij (ndryshuar/plotësuar nga Direktiva për Shërbimin e mediave audiovizuale) obligon shtetet të inkurajojnë ofruesit e shërbimeve mediale që të sigurojnë që shërbimet e tyre gradualisht janë bërë të arritshme për njerëzit me aftësi të kufizuara pamore apo në të dëgjuar.

Një dobi e transmetimit digjital - përveç mundësisë për një numër të madh kanalesh - është mundësia e ofrimit të shërbimeve të tjera të informacionit për popullatën nëpërmjet konvergjencës së teknologjive. Shërbimet e ndryshme të shoqërisë së informacionit gjithnjë e më shumë përdorin të njëjtat mjete të transmetimit dhe mund të ofrohen në mënyrë kolektive ose së paku mund të shfrytëzojnë (një pjesë të) infrastrukturës dhe pajisjeve fundore të njëjta. Nëse trajtohet mirë, digjitalizimi mund të ndihmojë në eliminimin e pabarazive të disponueshmërisë së këtyre shërbimeve dhe rritjen e qasjes në informata. Megjithatë, fakti se pajisjet e reja marrëse (set-top kutitë) do të jenë të domosdoshme për publikun, si dhe pajisjet e reja transmetuese për transmetuesit, mund të shpjerë në më pak zgjedhje gjatë një periudhe kalimtare. Në këtë kuptim, ekziston një rrezik i pabarazive në rritje në mes të grupeve të popullsisë, bazuar në dallimet ekonomike dhe faktorët gjeografikë.

55 Rekomandimi Rec (2007)3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për Shtetet anëtare mbi qëllimet e shërbimit publik të mediave në shoqërinë e informacionit.

6.2. Pluralizëm dhe jo vetëm numër i madh i kanaleve

Është e rëndësishme të ketë pluralizëm dhe jo vetëm një numër të madh të kanaleve. Modeli i zakonshëm në Europë është zhvillimi i disa multiplekseve të televizionit digjital, duke përfshirë pakon pa pagesë, në dispozicion për të gjithë që kanë pajisje të përshtatshme pranuese dhe zgjedhjen e pakove tjera me pagesë. Pako të tjera do të zhvillohen gradualisht. Një prej sfidave për digjitalizim është që të shmanget rritja e tepërt e pabarazisë së qasjes në informata në mes të atyre që abonohen në kanalet me pagesë dhe atyre që nuk bëjnë këtë. Pakoja pa pagesë duhet të përfshijë një shumëllojshmëri të kanaleve për të përmbushur nevojat e ndryshme të transmetimit, ShPT-të duke qenë gjithmonë në mesin e atyre.

Numri i kanaleve në pakon pa pagesë ndryshon varësisht nga vendi. Në shumicën e vendeve Europiane, përveç kanaleve ekzistuese të shërbimit publik të transmetimit si dhe kanaleve të tjera që janë në dispozicion pa pagesë, pas digjitalizimit një kanal shtesë ofrohet falas për publikun. Ky mund të jetë një kanal 24-orësh i lajmeve (Finlanda dhe Suedia) natyra e shërbimit publik e të cilit është e qartë.⁵⁶ Gjithashtu multiplekset me pagesë duhet të përfshijnë kanale të ndryshme dhe zgjedhja ideale duhet të bëhet nga një rregullator i pavarur në bazë të kriterëve objektive dhe transparente, ose nëse zgjedhja bëhet nga pronari i multipleksit, rregullatori duhet të ofrojë mbikëqyrje dhe të ndihmojë në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje.

6.3 Subvencionimi i pajisjeve marrëse

Si dhe në çfarë mase duhet të subvencionohen pajisjet marrëse është një pyetje e rëndësishme. Para së gjithash duhet të sqarohet se në çfarë mënyre njerëzit pranojnë televizionin analog; cili është numri i njerëzve që kanë marrës kabllor ose të drejtpërdrejtë satelitor.

⁵⁶ Në një vend të madh si Mbretëria e Bashkuar, kanalet pa pagesë mund të arrijë deri në numrin 30, ndërsa në Suedi ka gjashtë dhe në Finlandë pesë plus radioja.

Kjo do të përcaktojë se sa njerëz mund të kenë nevojë për pajisje marrëse dhe se çfarë lloji i pajisjeve është i nevojshëm. Çështja nëse ka pasur një numër të konsiderueshëm të blerjeve vullnetare gjithashtu është e rëndësishme, siç është edhe çështja e shërbimeve të tjera dhe konvergjenca, ku mund të ketë nevojë më shumë ose më pak për pajisje shtesë.⁵⁷

Nga këndvështrimi i audiencës, është tejte e rëndësishme që të ketë rregulla të qarta, transparente dhe të drejta rreth asaj nëse ekziston mundësia për të marrë falas pajisjet marrëse siç janë set-top kutitë apo mbështetja për të blerë pajisje të tilla. Është e mundshme që kriteret e përdorura në kontekste të tjera për sigurimin e ndihmave sociale mund të jenë të papërshtatshme. Modeli nismëtar i biznesit (i provuar në Spanjë dhe në Mbretërinë e Bashkuar) i dhënies falas të pajisjeve për abonentët dështoi për shkak të absorbimit të ngadalshëm nga konsumatorët.

Shteti bart përgjegjësi për të ofruar mundësinë për të gjithë që të jenë pjesë e procesit. Lidhur me shpërndarjen e set-top kutive të subvencionuara (ose teknologjive të tjera) do të ketë punë administrative dhe shpenzime, të cilat duhet të merren parasysh me rastin e vlerësimit të koston totale të digjitalizimit. Vendet ose rajonet që kanë kryer digjitalizimin më herët (Berlino, Finlanda dhe Suedia) nuk kanë dhënë ndonjë mbështetje apo set-top kuti falas për njerëzit. Statusi ekonomik i këtyre vendeve duhet të kihet parasysh: ato janë vende relativisht të pasura dhe kostoja e një set-top kutie mund të konsiderohet të jetë e arsyeshme dhe e përballueshme për shumicën e njerëzve. Është e rëndësishme që rregullat për ndihmën e mundshme janë të përshtatshme për një vend specifik. Në shumë vende fitimet e perceptuara të mirëqenies nga transmetimet digjitale mund të mbipeshojnë koston e pajisjeve për shumë njerëz, veçanërisht pasi tregu ka qenë në gjendje

57 Në Itali shumica e njerëzve pranonin (para fillimit të digjitalizimit) programet e tyre televizive përmes transmetimit tokësor (19 milionë aparate televizive nga gjithsej 22 milionë), ndërsa në Gjermani në fillim të digjitalizimit ka pasur 93% mbulim kabllor ose satelitor. Kjo ka ndikuar, për shembull, mënyrën dhe nivelin në të cilin vendet e kanë trajtuar me subvencione digjitalizimin, siç është diskutuar edhe më herët në këtë Udhëzues. Disponueshmëria e qasjes në internet me shpejtësi të lartë është një tjetër faktor pasi që vetëm me shtrirje të gjerë të qasjes së tillë televizioni nëpërmjet internetit me brez të gjerë do të ketë rëndësi.

të ofroj pajisjet me një çmim të arsyeshëm.⁵⁸ Ndoshta mund të jetë e mjaftueshme që njerëzit të informohen në lidhje me përfitimet nga digjitalizimi dhe ata nuk do të kundërshtojnë investimin e nevojshëm që është relativisht i vogël. Nëse nuk ka ndihma shtesë në një vend ku shumë njerëz jetojnë afër kufirit të varfërisë, ekziston rreziku real që digjitalizimi do të shpjer njerëzit në tjetërsimin nga transmetimi dhe kështu do t'i largoj ata nga një burim i rëndësishëm i informacionit. Ata nuk do të jenë në gjendje të gëzojnë shërbimet e reja digjitale dhe kështu nuk do të jenë përfitues të dividendës digjitale.

Përveç dizajnit praktik dhe kostos së ndonjë projekti për subvencionim të dekodereve, është e rëndësishme që projektet e tilla të mos favorizojnë vetëm disa transmetues, për të mos krijuar kështu kushte të pabarabarta të konkurrencës.

58 Kjo u shfaq në sondazhet e kryera në Mbretërinë e Bashkuar në fillim të viteve 2000. Shih: "Një Udhëzues për Televizionin Digjital dhe Kalimin në Transmetimet Digjitale", botimi i 1 tetorit 2004, Ofcom (MB).

Në këtë kuptim, Komisioni i Bashkimit Europian në dhjetor të vitit 2005 nisi një hetim kundër Italisë për shkelje të ligjit të BE-së në lidhje me skemën e italiane për të subvencionuar dekoderët e televizionit digjital. Ankesa ishte bërë nga operatorët ekzistues konkurrues. Komisioni vuri në dukje se edhe ato masa që mbështesin qëllimin e interesit të përbashkët⁷ (si digjitalizimi) duhet të jenë proporcionale dhe nuk duhet të përfshijnë deformimin e panevojshëm të konkurrencës. Shpjegimi italian që subvencionimi mund të justifikohet sipas rregullave në lidhje me ndihmën e shtetit të karakterit social⁸ nuk u pranua, pasi që subvencioni nuk ju është dhënë vetëm grupeve të pafavorizuara. Nuk përfituan vetëm konsumatorët por edhe kompanitë dhe, sidoqoftë, një subvencion i tillë nuk duhet të diskriminojë operatorët e ndryshëm. Operatorët e tjerë u detyruan të ofrojnë pajisje në shpenzime të veta. Komisioni nuk pranoi as argumentin se ndihma ishte vetëm një pjesë e ofrimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, diçka që Shtetet Anëtare të BE-së mund të vendosin vetë si t'ia bëjnë.⁹

Pasi që transmetimi tokësor ishte mjeti kryesor i pranimit të televizionit në Itali, ndikimi i një programi të subvencionuar ishte tejet i madh. Italia u përpoq të mbroj skemën duke përmendur dobritë e televizionit digjital, siç janë përmirësimi i shfrytëzimit të frekuencave për pluralizëm më të madh, nxitja e zhvillimit ekonomik, teknologjitë e informacionit dhe shërbimet e e-shoqërisë. Për projektet me interes të përgjithshëm, ndihma mund të jepet vetëm për të adresuar një dështim të tregut dhe nëse është e nevojshme dhe proporcionale, për të cilat Komisioni këtë herë mendoi se nuk ishte rasti.¹⁰ Sistemi italian i subvencionimit më vonë u ndryshua, siç është përshkruar diku tjetër.

Madje edhe për vendet që nuk janë të lidhura me dispozitat e veçanta ligjore të BE-së për ndihmën shtetërore dhe konkurrencën, parimet që u vunë në dukje nga Komisioni në lidhje me skemën e italiane janë me interes, pasi ato nxjerrin në pah rrezikun e një programi të subvencioneve të projektuara gabimisht. Një program i tillë do të vështirësonte konkurrencën dhe do të dekurajonte ofruesit, sidomos pjesëmarrësit e ri në treg.

Në përfundim, mund të thuhet se është e rëndësishme që njerëzit të mos përjashtohen nga qasja në transmetimet digjitale, dhe çdo subvencion i dhënë duhet të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm për vendin në fjalë.

6.4 Obligimi i Shërbimit Universal

Koncepti i obligimit të shërbimit universal (OSHU - USO) është i njohur mirë nga telekomunikacioni dhe shërbimet tjera. Kjo do të thotë se disa shërbime thelbësore duhet të ofrohen për të gjithë, edhe nëse tregu vetvetiu nuk do të lejonte një shërbim të tillë universal. Shembujt e zakonshëm janë se si shërbimet e telekomunikimit, posta ose energjia duhet të ofrohen për njerëzit që jetojnë larg nga përqendrimet e popullsisë dhe të cilët mund të jenë shfrytëzues të mëdhenj të shërbimit. USO zakonisht është i lidhur me shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik, një koncept që përfshin nevojat themelore të jetesës. Ky duhet të jetë, koncept fleksibil i jetesës në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në shoqëri. Një shembull i tillë është interneti, i cili ishte konsideruar si një shërbim i veçantë atëherë kur ishte paraqitur fillimisht, por tani në shumicën e vendeve Europiane shihet si një domosdoshmëri themelore në të cilën çdokush duhet të ketë qasje.

Për sa i përket përmbajtjes (programore) të transmetimit, rregullat "përfshirjes së domosdoshme" (shih më lart) të ShPT, është një lloj i USO-s - është një mjet për të imponuar ofrimin e një shërbimi të caktuar nga kompanitë private, duke u mbështetur në supozimin se ky shërbim është i vlefshëm për tërë popullatën dhe duhet të jetë në dispozicion për të gjithë. Ky detyrim mbetet i vlefshëm dhe është ndoshta edhe më i rëndësishëm në një mjedis digjital të transmetimit, me larminë e vet të kanaleve. Përndryshe ekziston rreziku që shumë njerëz nuk do të kishin qasje në ShPT nëpërmjet pakove të ndryshme në të cilat ata abonohen. ShPT nuk do të jetë në dispozicion përpos nëse nuk është i përfshirë në paket programore, pasi i tërë pranimi i transmetimit do të bazohet në abonim tek ndonjë kompani.

Ekzistimi i një ShPT nuk duhet të përfshijë asnjë kosto shtesë për shikuesit, kjo duhet të jetë përgjegjësi e ofruesit të shërbimit.⁵⁹

Përveç obligimeve të “përfshirjes së domosdoshme” që janë të lidhura me përmbajtjen e transmetimit, obligimit të shërbimit universal teknik - të ngjashëm me atë të telekomunikimit - është me rëndësi të kufizohet numri i operatorëve në mjedisin digjital, pasi teknologjia komplekse dhe e shtrenjtë e transmetimit mund të veprojë si një fyt i ngushtë. Ligjvënësi dhe rregullatori kanë një detyrë të rëndësishme për të siguruar se, në qoftë se tregu nuk arrin të ofrojë mundësinë për qasje universale në transmetim digjital, obligimi për një shërbim të tillë universal do të ngarkohet mbi operatorët e caktuar. Ky imponim duhet të bëhet në mënyrë transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese, në përputhje me atë që është e nevojshme pa ndërhyrje të tepruar në kompanitë private. Është e rëndësishme të theksohet se USO do të thotë vetëm se një shërbim i caktuar duhet të jetë në dispozicion me një kosto të përballueshme. Kjo nuk do të thotë se shërbimi duhet të jetë falas apo se shteti në të vërtetë do të sigurojë që të gjithë do të shfrytëzojnë këtë shërbim - kjo vetëm nënkupton se ai ekziston për ata që zgjedhin ta shfrytëzojnë atë. Çdo vend duhet të përcaktoj se çfarë është e përballueshme, jo vetëm në raport me nivelin e të ardhurave të popullatës, por edhe për atë që mund të shihet si pjesë legjitime e të ardhurave të disponueshme për të paguar një shërbim të caktuar.

6.5 Ndërveprimi

USO ka të bëjë me disponueshmërinë e një shërbimi, duke pasur parasysh pajisjet e duhura. Sa i përket pajisjeve, në disa raste, në vend të mbështetjes shtetërore dhe/ose krahas saj, industria duhet të inkurajohet që të ofrojë lloje të ndryshme të pajisjeve me një kosto të ulët. Vendet që kryen më herët digjitalizimin kanë promovuar konkurrencën dhe kështu kanë arritur tek set-top kutitë e lira, si dhe tek llojet më të përpunuara të pajisjeve për ata që janë veçanërisht të interesuar.

⁵⁹ Në BE, obligimi i "përfshirjes së domosdoshme" është përcaktuar në Direktivën mbi Shërbimin Universal, Direktiva 2002/22/EC (e ndryshuar/plotësuar nga Direktiva 2009/136/EC) mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, Neni 31.

Ndërveprimi është një koncept i rëndësishëm në këtë aspekt; ai gjithashtu është promovuar edhe nga BE-ja, pasi kjo e bën tregun më tërheqës për prodhuesit.

Edhe pse qeveria në ekonominë demokratike të tregut nuk duhet të ndërhyjë drejtpërsëdrejti mbi industrinë ose të vendos çmimet, ajo mund të ketë një dialog me industrinë dhe të shoh nëse ka mundësi për pajisje më të lira. Standardet dhe specifikimet teknike duhet, për aq sa është e mundur, të përqafohen ndërkombëtarisht për të siguruar ndërlidhjen më të madhe të mundshme dhe mundësinë që mallrat të lëvizin lirshëm për të lejuar një treg ndërkombëtar. BE-ja, e cila nëpërmjet ndikimit të saj të madh mbi tregtinë në Europë në realitet vendos standardet edhe për jo-anëtarët e BE-së, mban qëndrimin se standardet duhet të udhëhiqen nga industria - sa më shumë që kjo është e mundur. Është e rëndësishme që sistemi të mos bllokohet me standarde në qoftë se ende ka vend për zhvillim teknologjik, në vend të kësaj duhet qenë fleksibil dhe të hapur për ndërveprimin ndërmjet standardeve të ndryshme.

BE-ja parashikon⁶⁰ që shtetet anëtare do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që operatorët e shërbimeve të qasjes së kushtëzuar, pavarësisht nga mjetet e transmetimit, të cilët prodhojnë dhe qesin në treg shërbimet e qasjes në televizionin digjital për të gjithë transmetuesit, në baza të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, ofrojnë shërbimet teknike që ju mundësojnë transmetuesve shërbime të transmetuara në mënyrë digjitale, të cilat do të pranohen nga shikuesit e autorizuar përmes dekoderëve të administruar nga operatorët e shërbimeve. Kjo në esencë do të thotë se shtetet anëtare do të sigurojnë që këto shërbime duhet të punojnë në platforma të ndryshme teknologjike.⁶¹

60 Neni 4 i Direktivës 95/47/EC mbi shfrytëzimin e standardeve për transmetimin e sinjaleve televizive. Disa komentues konstatojnë se Direktiva ishte e paqartë në disa pjesë dhe si pasojë nuk pati harmonizim të dëshiruar. Ajo gjithashtu nënkuptonte zbatimin e papërsosur nga Shtetet Anëtare. Për shembull M. Arino "Lufta dhe paqja digjitale: Rregullimi dhe Konkurrenca në Transmetimet Digjitale Europiane" Ligji Publik Europian, 2004, Vëll. 10 Çështja 1, fq.135-160 në fq.137-138.

61 Neni 24 i Direktivës 2002/22/EC mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike përfshin një detyrim të ngjashëm. Një Shtojcë e Direktivës mbi Shërbimet Universale, ndryshuar nga Direktiva 2009/136/EC, siguron ndërveprimin e pajisjeve të konsumit të televizionit digjital në BE.

Në mënyrë të ngjashme, *Rekomandimi (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës* parashikon që shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa që synojnë një shkallë të lartë të ndërveprimit dhe krahasueshmërisë së pajisjeve të pranimit, dekodimit dhe dekriptimit (hapjes) dhe të sistemeve të lejimit të qasjes në shërbime të transmetimit digjital.

Direktiva e Kornizës së BE-së⁶² specifikon se duhet të inkurajohet ndërveprimi i shërbimeve televizionit digjital interaktiv dhe pajisjet e përmirësuara të televizionit digjital në nivel të konsumatorit për të siguruar rrjedhjen e lirë të informacionit, pluralizmin e mediave dhe diversitetin kulturor. Për konsumatorët është e dëshirueshme që të jenë në gjendje të marrin të gjitha shërbimet e televizionit digjital interaktiv që nënkuptojnë, ndër të tjera, neutralitetin teknologjik, progresin e ardhshëm dhe nevojën për të nxitur absorbimin (nga tregu) e televizionit digjital. Operatorët e platformave digjitale duhet të përpiqen të zbatojnë ndërthurjen e hapur të programit aplikativ (API), e cila përputhet me standardet Europiane dhe lejon migrimin në mes të sistemeve.

Zhvillimi i teknologjisë së re audio-vizuale (siç janë sistemet interaktive të televizionit, sistemet për ofrimin tek marrësit portativ, ofrimi i (internetit) brezit të gjerë (broadband) dhe televizioni me definicion të lartë) mund të paraqesë probleme të reja rreth ndërveprimit. Prandaj, sigurimi i ndërveprimit është një detyrë e vazhdueshme. EBU-ja thekson se është e rëndësishme që të riafirmohet që konsumatorët duhet të kenë qasje në një gamë të gjerë dhe të larmishme të përmbajtjes programore dhe shërbimeve në platforma të ndryshme, me cilësinë më të lartë të mundshme dhe me çmimin më të ulët të mundshëm. EBU-ja beson se ky objektivi më së miri mund të arrihet përmes konkurrencës së tregut. Standardet e ndërveprueshme dhe ndërveprimi i përmirësuar i pajisjeve digjitale do të nxisë pranimin nga konsumatorët, që nga ana tjetër do të promovojë kalimin në sistemet digjitale.⁶³ Vendet e hershme në digjitalizim, si Suedia, Finlanda dhe Mbretëria e Bashkuar, kanë vënë theks të madh mbi nevojën që pajisjet duhet të jenë të përshtatshme për ofruesit e ndryshëm të përmbajtjes, në mënyrë që shikuesit

62 Direktiva 2002/21/EC mbi një kornizë të përbashkët rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, në veçanti Neni 18.

63 "Kontributi i EBU-së Komisionit Europian bën thirrje për prurje (inpute) në risikimin e ardhshëm të kornizës rregullatore të BE-së për komunikimet dhe shërbimet elektronike", 30.1.2006 DAJ/ACB/mtp/jev

të jenë në gjendje të ndërrojnë ofruesin edhe pasi të kenë blerë pajisjet.

6.6 Mbrojtja e konsumatorit

Në planin e digjitalizimit, çështjet e mbrojtjes së konsumatorit duhet gjithashtu të merren parasysh. Shkalla e ndryshimeve të nevojshme të ligjeve ose dispozitave të reja ligjore në një vend të caktuar varet nga korniza e përgjithshme për mbrojtjen e konsumatorit. Nëse ekziston legjislacioni i fuqishëm për mbrojtjen e konsumatorit, kjo do të gjej zbatim edhe për transmetimin digjital, dhe nuk ka nevojë për legjislacion të posaçëm. Por, në qoftë se mbrojtja e konsumatorit në përgjithësi është e dobët, paraqitet nevoja për dispozita të posaçme ligjore brenda ligjit mbi sektorin specifik.

BE-ja thekson nevojën për mbrojtje më të fuqishme të konsumatorëve në lidhje me shërbimet e ndryshme elektronike dhe modelet tjera të reja të afarizmit. Çështjet që kanë tendencë të paraqiten në këtë kontekst janë të ngjashme me çështjet e telekomunikacionit, dhe përfshijnë çështje të tilla si faturimi i qartë (sidomos kur disa shërbime gjenden në të njëjtën faturë), mundësitë për të anuluar kontratat, dhe rregullat për pajisjet që nuk lidhin konsumatorët vetëm me një ofrues për një kohë të paarsyeshme.

Në **Mbretërinë e Bashkuar**, në shkurt të vitit 2008 rregullatori për komunikimet Ofcom¹¹ lëshoi propozime të reja rreth asaj se si ofruesit e shërbimeve të komunikimit duhet të tregojnë qartë çdo pagesë shtesë e cila shfaqet në faturat e konsumatorit, në mënyrë që konsumatori të jetë në gjendje që të kuptoj lehtë se për çfarë është duke paguar. Shfrytëzuesi duhet të kuptoj se çfarë ngarkesash të ndryshme janë të përfshira në faturë. Ofcom ka gjithashtu një komitet të veçantë këshillues për njerëzit e moshuar dhe me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të sigurohet që nevojat e këtyre grupeve janë marrë posaçërisht parasysh gjatë procesit të digjitalizimit dhe në ndryshimet tjera të peizazhit të komunikimit.

Në **Finlandë**, duke klikuar në një link të veçantë në faqen e internetit, njerëzit mund të parashirojnë pyetje ose të bëjnë ankesa, poashtu aty ofrohet një numër i veçantë telefoni të cilin mund ta thirrni për çdo çështje të konsumatorëve në lidhje me digjitalizimin.

Në **Suedi**, operatori kryesor drejton faqen e vetë të blogut ku çështjet e konsumit mund të diskutohen me këdo që dëshiron të bëjë një koment ose të ngrejë një pyetje.

Kapitulli 7. Transmetuesit: Çështjet ekonomike dhe ato teknike

Fillimisht digjitalizimi është shumë i shtrenjtë për transmetuesit të cilët duhet të bëjnë investime të mëdha. Ata mund të shohin kthimin e këtyre investimeve vetëm pas një afati të gjatë. Ky kapitull shpjegon çështjet me të cilat duhet të merren transmetuesit në lidhje me investimet dhe infrastrukturën, dhe mënyrën se si shteti mund të ofroj ndihmë pa dëmtuar konkurrencën.

7.1 Investimet për digjitalizim

Edhe pse ka aktorë të ndryshëm që mund të përfitojnë nga digjitalizimi, siç janë transmetuesit e rinj që mund të pranojnë pjesë të spektrit të vënë në dispozicion,

prodhuesit e pajisjeve, dhe ofruesit e shërbimeve të tjera, këta aktorë mund të mos jenë të njëjtit ata që kanë për të bartur shpenzimet fillestare. Shpenzimet për infrastrukturën e ndërtimit, kush duhet të paguaj për këtë dhe në çfarë mënyre paraqesin sfida për shtetet që kalojnë në transmetim digjital. Nëse barra vihet vetëm mbi transmetuesit, ekziston një rrezik i vërtetë që ata të falimentojnë.

Siç u përmend më parë në këtë udhëzues, kjo mund të jetë shumë negative për pluralizmin dhe diversitetin. Një mundësi është që të formohen partneritete ndërmjet qeverisë, transmetuesve, operatorëve të rrjetit dhe industrisë (ndoshta në kuadër të të ashtuquajturave Partneritetet Publiko-Private, ose PPP).

PPP është një koncept gjithnjë e më i popullarizuar në shumë kontekste në Europë, si një mjet për të marrë kapitalin e nevojshëm privat për projekte me interes publik. Modeli do të varet nga struktura e sektorit të transmetimit të vendit të caktuar; për shembull, nëse objektet e transmetimit janë në pronësi të shtetit ose të përqendruara në një kompani (siç janë kompanitë e privatizuara që burojnë nga një ish-monopol i shtetit). Nuk ka një model të përbashkët European. Çdo vend duhet të gjejë mënyrën më të mirë, duke përfshirë edhe përgjigjen në pyetjen se si mund të inkurajohen industria dhe transmetuesit privatë që të bëjnë investime e njëkohësisht pa iu dhënë atyre përparësi të padrejtë në procesin e konkurrimit.

Çfarë duhet të pranohet kur vlerësohet kostoja dhe gatishmëria për investime të subjekteve private është se shpenzimet fillestare janë të larta, dhe atraktiviteti i rritur dhe potenciali i investimeve të transmetimit digjital vijnë vetëm pas një kohe dhe me një kosto. Koha dhe madhësia e përparësisë nuk janë të njohura, dhe kjo çështje është shumë e re çdokund për të qenë në gjendje të bëjmë ndonjë krahasim të saktë me vendet e tjera.

Siç vejnë në dukje studimet, televizioni digjital nuk është një minierë ari, dhe kompanitë e përfshira duhet të kenë mundësi të konsiderueshme për investim.⁶⁴

Është e qartë se në të gjitha proceset e digjitalizimit, pritet që transmetuesit privatë të bartin një pjesë të kostos. Edhe pse kjo është një gjë e arsyeshme, duhet pranuar se mund të nevojiten disa stimulime për këta transmetues në mënyrë që ata të jenë të gatshëm për të kryer investimet e nevojshme. Stimulimet e tilla mund të jenë në formë të një reduktimi apo heqjeje totale të taksës për licencë transmetimi për një periudhë të caktuar, e kushtëzuar me vazhdimin e digjitalizimit apo një zgjatje e afatit të licencës së transmetimit.

Në **Finlandë**, Akti mbi Fondin për Televizionin dhe Radion Shtetërore i 1 korrikut 2002 ofroi një përjasje tre-hapshe për të lehtësuar barrën e investimeve për transmetuesit. Së pari, ka pasur një lirim prej 50% të tarifës për licencë operimi që paguhej nga kompanitë e televizionit komercial, ndërsa transmetuesit digjital liroheshin plotësisht nga ajo deri më 31 gusht 2010. Së dyti, tarifa e licencës për televizion e paguar nga amvisëritë u rrit për 13% nga 1 janari 2004. Së treti, tarifa vjetore e licencës televizive do të ngritej çdo vit për aq kohë sa të dy llojet e transmetimit, analog dhe ai digjital, do të vazhdonin (d.m.th. periudha e transmetimit të njëkohshëm).¹²

Një rritje e ngjashme e tarifës u prezantua edhe në **Austri**. Në të njëjtën kohë, në **Irlandë** në vitin 2002 dhe në **Zvicër** në vitin 2003 qeveritë hodhën poshtë kërkesat e transmetuesve publikë që kostot shtesë të transmetimit të të dy llojeve të kanaleve, analoge dhe atyre digjitale, gjatë periudhës së tranzicionit të financohen nëpërmjet një rritjeje të përkohshme të tarifave të licencave.¹³

64 Ashtu si edhe kompania amë e operatorit BSKyB në Mbretërinë e Bashkuar që subvencionoi shumë vite të humbjeve para rentabilitetit të degës së saj digjitale. Shih A. Wessberg "Digjital - një sfidë për Europën" 2003/4 Përhapja (difuzioni) online, EBU fq. 2-5.

Në **Mbretërinë e Bashkuar**, e ashtuquajtura “dividenda digjitale” është një ulje e tarifës së paguar për përdorimin e frekuencave të lidhur me numrin e shikuesve që përqafojnë një nga tri platformat digjitale. Këto lloje të politikave mund të jenë një nxitje e fuqishme për transmetuesit që të miratojnë strategji që ndihmojnë absorbimin e shpejtë të platformave digjitale.¹⁴

Në **Estoni**, amendamenti i Aktit të Transmetimeve i 18 qershorit 2008 shfuqizoi pagesën e tarifës së licencës së dy transmetuesve më të mëdhenj privat prej rreth 20 milionë kroons secila. Tarifa kishte për qëllim të kompensoj humbjet e ShPT për shkak të abstenimit nga reklamat në programet e veta. Amendamenti ishte i motivuar nga nevoja për lehtësimin e transmetuesve privatë nga barra financiare për kohëzgjatjen e periudhës së kalimit në transmetime digjitale. Mungesa e taksës pas 1 Janarit 2009 është kompensuar nga buxheti i shtetit. Në **Maltë**, nuk ka asnjë tarifë për transmetuesit analog që transmetojnë të njëjtën përmbajtje në sistemin digjital.

Për të mbështetur transmetuesit jashtë Europës është përdorur një tjetër mënyrë, në **Australi**, detyrimet rregullatore për të ofruar programe për fëmijë dhe përmbajtje vendore australiane ishin zbutur për një kohë, në mënyrë që të lejohet themelimi i shërbimeve digjitale. Metoda e fundit bart rreziqe për pluralizmin dhe diversitetin, si dhe për cilësinë e transmetimit, dhe nuk do të ishte në përputhje me detyrimet Europiane nga Konventa mbi Televizionin Tej-kufitar dhe marrëveshjet e tjera.

Një tjetër nxitje është që një kompanie t'i garantohet monopol i caktuar për një periudhë të kufizuar kohe, në mënyrë që t'ju jepet vetëbesimi se ata do të jenë në gjendje të mbulojnë investimet e tyre.

Ky koncept është i njohur mirë nga rregulloret e shërbimeve komunale, por megjithatë është i ndërlikuar, pasi që përforcon një monopol ose të paktën një pozitë dominante, e cila është e keqe për konkurrencë.⁶⁵

Infrastruktura ekzistuese duhet të shfrytëzohet sa më shumë të jetë e mundur edhe për transmetimin digjital. Ndikimi në mjedis, rezistenca popullore (shumë shtylla të reja), si dhe kostoja e instalimeve të reja duhet të merren parasysh kur bëhet shqyrtimi për zgjerimin apo krijimin e infrastrukturës paralele. Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka kuptim, ashtu si edhe modernizimi në faza. Transparenca dhe procedurat publikisht në dispozicion për t'u siguruar që të gjitha pikëpamjet përkatëse janë marrë parasysh duhet të aplikohen kur shqyrtohen mënyrat për të instaluar infrastrukturën. Shumë besojnë se një rrjet tokësor është më i miri për pjesën dërmuese të televizionit digjital, i plotësuar nga rrjeti satelitor. Rrjeti tokësor kryesisht tashmë ekziston, dhe rrjetet tokësore janë të vetmet që mund të pranohen me marrës portativ në një mënyrë të dobishme.

Megjithatë, televizion nëpërmjet internetit të brezit të gjerë (broadband) është gjithashtu një teknologji interesante. BE-ja aplikon parimin e neutralitetit teknologjik, pasi prioriteti i saj është të vejë transmetimin digjital në dispozicion, pavarësisht nga mënyra. Një parim i tillë është i përshtatshëm edhe jashtë BE-së.

Bashkë-vendndodhja dhe ndarja tjetër e infrastrukturës është një mjet për të ulur shpenzimet. Kjo përjasje gjithashtu është e dobishme për mjedisin. Shumë vende kanë rregulla mbi ndarjen e detyrueshme në legjislacionin e telekomunikacionit dhe dispozita të ngjashme mund të përdoren gjithashtu në mjedisin digjital (dhe në disa vende, këto çështje janë të mbuluara nga legjislacioni i komunikimit tashmë ekzistues i përshtatshëm për të mbuluar edhe transmetimin digjital). Kjo nuk është e njëjtë si për rregullat e qasjes (të cilat do të përshkruhen më poshtë), por ka të bëjë vetëm me instalimet fizike, duke përfshirë shtyllat, ndërtesat dhe strukturat e ngjashme.

65 Rastet C-320/91 Courbeau dhe C-280/00 Altmark nga Gjykata Europiane e Drejtësisë (Gjykata e BE-së).

7.2. Platforma e transmetimit

Në shumë vende, operatori i rrjetit që është përgjegjës për platformat e transmetimit për transmetimet digjitale është një organ në pronësi shtetërore ose më parë ka qenë i tillë. Ky organ normalisht do të jetë dominues, ose do të kishte edhe monopolin, por digjitalizimi nuk duhet të shihet si një mjet për të çimentuar dominimin e këtij organi ose të paktën jo pasojat e mundshme negative të dominimit të tillë. Rregullat e qasjes janë shumë të rëndësishme, por duhet të pranohet që rregullat e tilla mund të përforcojnë dominimin e kompanisë që mban rrjetin në qoftë se ajo kufizon zhvillimin e rrjeteve të tjera.

Në shumë vende, rrjeti transmetues është ndarë nga transmetuesit, si dhe është privatizuar, që është një zhvillim pozitiv. Privatizimi dhe ndarja strukturore janë çështje të ndara nga digjitalizimi, dhe digjitalizimi nuk duhet të lejohet të vonojë zhvillime të tilla. Ndoshta është e dobishme të studiohen përvojat nga liberalizimi i telekomunikacionit, pasi çështjet janë të ngjashme. Përfshirja e organit rregullator të telekomunikacionit është e rëndësishme.

Pavarësisht nga pronësia e mundshme publike mbi rrjetin e transmisionit, dispozitat e qasjes duhet të zbatohen në mënyrë rigoroze dhe pronësia mbi objektet/pajisjet e transmetimit nuk duhet të përfshijë ndonjë ndërhyrje në përmbajtjen e transmetimit. Kjo është një çështje rregullatore për rregullatorin e pavarur. Për më tepër, të gjithë transmetuesit, duke përfshirë ShPT, duhet të mbrohen nga ndërhyrja e qeverisë, ashtu si në sistemin e transmetimit analog. Siç thekson BE-ja,⁶⁶ ndërhyrjet e politikave shtetërore duhet të jenë transparente, të justifikuar, proporcionale dhe në kohë të duhur për të minimizuar rrezikun e deformimit të tregut. Këto janë synime të mira për të gjithë shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

66 COM(2003)541 final, "Në kalimin nga transmetimi analog në atë digjital".

7.3 Të ardhurat e transmetuesve

Një problem i shtuar në financimin e digjitalizimit është që të ardhurat nga reklamat në përgjithësi kanë rënë në tërë botën. Kur ka depërtim të ulët, si dhe fragmentim të audiencës, tregu është mjaft jotërheqës për reklamuesit, që do të thotë se digjitalizimi mund të nënkuptoj më pak të ardhura për transmetuesit. Në **Australi**, të paktën pjesërisht për shkak të lobimit nga transmetuesit (ata komercial që mbështeten në reklama ose abonime) në vend të shfrytëzimit të digjitalizimit për të lejuar kanale të shumta, ai fillimisht do të shfrytëzohej për të prezantuar HDTV që përdor një pjesë të madhe të spektrit dhe kështu lejon një cilësi më të mirë në vend të sasisë më të lartë (televizion më i mirë në vend të më shumë televizion). Një arsye për këtë ishte për të shmangur fragmentimin e tregut. Legjislacioni fillestar australian mbi digjitalizimin u ndryshua, pasi duhej gjetur mjetet për të bërë digjitalen tërheqëse për popullatën. Shembujt e digjitalizimit të suksesshëm, ku audienca ishte e interesuar në këtë proces, përfshirë ekzistimin e më shumë programeve (sidomos në Mbretërinë e Bashkuar), dhe kështu Australia e kuptoi se ajo gjithashtu duhej të shkonte rrugës së më shumë kanaleve në qoftë se ajo dëshironte të bind popullatën rreth dobisë nga digjitalizimi.⁶⁷

Shembulli australian tregon se ndoshta nuk ka asnjë mënyrë për të shmangur tendencën negative të reklamave të transmetimit, e cila është përkeqësuar nga kriza e tanishme ekonomike në pjesën më të madhe të botës. Sjellja popullore ka ndryshuar, dhe reklamat tradicionale të transmetuara nuk janë më aq tërheqëse sa ishin atëherë kur mund të pritej që një numër i madh i njerëzve do të shikonin programin e njëjtë në të njëjtën kohë.

Industria e reklamave është e vetëdijshme për ndryshimet dhe, tashmë për disa vite, ka shqyrtuar mundësitë e tjera reklamuese, siç janë reklamat më të drejtuara kah interneti dhe telefonat mobil.

67 J. Bosland "Televizioni Digjital dhe Shumë kanale: Ndryshimet sipas Amendamentit të Legjislacionit mbi Transmetimet (Televizioni Digjital) Akti i vitit 2006", Melburn Shkolla Juridike, Dokument Hulumtimi i Studimeve Ligjore nr. 258. Kopja elektronike në dispozicion në: <http://ssrn.com/abstract=1014457>.

Ky ndryshim është në vazhdim e sipër, por është i rëndësishëm për digjitalizim për shkak se kjo do të çojë në një reduktim të të ardhurave nga reklamat për shumë transmetues në një kohë kur ata kanë nevojë që të financojnë kalimin e shtrenjtë në sistemin digjital. Pritjet e kontributeve nga transmetuesit privat rreth shpenzimeve të procesit duhet të jenë të arsyeshme në këtë kontekst.

7.4 Ndhimja shtetërore

Financimi nga shteti dhe investimet e garantuara të qeverisë, mund të nevojiten për digjitalizimin, duke pasur parasysh madhësinë e investimeve të nevojshme. Megjithatë, këto duhet të kryhen me kujdes në mënyrë që të mos favorizojnë padrejtësisht ndonjë operator dhe të mos shkelin ndihmën shtetërore dhe rregullat e tjera të konkurrencës. BE-ja është duke hetuar nëse financime të caktuara të digjitalizimit shkelin dispozitat e ndihmës shtetërore, gjë që tregon se qëndrimi Europian është se digjitalizimi si i tillë nuk është një justifikim për të mos respektuar rregullat tjera.

Komisioni Europian shqyrtoi rastin e Berlin-Brandenburgut dhe mbështetjen e dhënë për digjitalizimin e televizionit tokësor në vitin 2005. Ky rast vendos standardet dhe limitet e financimit shtetëror brenda BE-së, dhe ai gjithashtu ofron udhëzime për vendet jo-anëtare të BE-së.⁶⁸ Autoriteti i transmetimeve (MABB) ofroi ndihmë financiare për kalimin në transmetimet digjitale, dhe ndau multiplekset për kanalet komerciale që në këmbim të ndihmës morën përsipër që të transmetojnë në formatin digjital për pesë vjet, pa marrë parasysh shifrat e audiencës. Për transmetuesit tokësor që nuk ishin në dispozicion, është bërë një lloj tjetër i marrëveshjes. Paratë buruan nga buxheti i MABB, i cili merr paratë nga taksat e licencave. ShPT mbuloi shpenzimet e veta nga tarifat e abonimit.⁶⁹

68 Vendimi i Komisionit është apeluar në Gjykatën e Shkallës së Parë, Rasti T-8/06. A ËSHTË ZGJIDHUR APELI DERI MË TANI?

69 C. Schoser (DG Konkurrenca) "Komisioni shpall ilegale subvencionet për televizionin tokësor digjital (DVB-T) në Berlin Brandenburg" Buletin Informativ i Politikave të Konkurrencës, 2006, Numër 1 (Komisioni Europian, Bruksel), fq.93-96.

Komisioni shqyrtoi nëse mbështetja ishte ndihmë shtetërore dhe nëse duhej lejuar. Komisioni gjeti se përparësia ekonomike nuk u eliminua nëpërmjet procedurës së përzgjedhjes: ajo ishte, në fakt, jo e hapur për konkurrencën dhe përkundrazi ka qenë e paqartë dhe jo-transparente. Shuma e kompensuar ndryshonte sipas kanaleve, sistemi ishte selektiv (mbështeste vetëm një platformë të transmetimit), gjë që mund të ndikonte në preferencat e shikuesve.⁷⁰

Arsyeja për të dhënë ndihmën shtetërore për digjitalizim është se ai është objekt i interesit të përbashkët apo se ndihma është e nevojshme për të mbështetur inovacionin. Por siç zbuloi Komisioni, nuk ka asnjë arsye për të mbështetur vetëm platformën tokësore e jo edhe platformat tjera. Ishte shkëlur parimi i neutralitetit teknologjik. Mund të ketë dështime të tregut që kanë nevojë për korrigjim, por këto nuk është konsideruar si arsyetim për ndihmën në fjalë në Berlin-Brandenburg.

Ndërhyrja rregullatore në lidhje me licencën e transmetimit do të kishte qenë një mjet më pak deformues për të arritur të njëjtin rezultat, apo ndoshta tregu mund të merrej me paqartësitë.⁷¹ Ndihma i është dhënë transmetuesve komercialë dhe atyre nuk iu ishte dhënë, në këmbim, ndonjë detyrë e veçantë e shërbimit publik. Promovimi i pluralizmit nuk është specifik as për platformën tokësore. Ofruesit kabllor dhe ata satelitor gjithashtu kontribuojnë dhe mund të jenë njësoj ose edhe më të përshtatshëm për ndihmë, duke pasur parasysh modelet përkatëse të të shikuarit.⁷²

Mbështetja shtetërore në forma të ndryshme gjithashtu u shqyrtua në vende të tjera, përveç Gjermanisë. Skemat italiane të mbështetjes të drejtuara kah shfrytëzuesit janë ekzaminuar më lart në këtë Udhëzues. Në Mbretërinë e Bashkuar, vëmendja është përqendruar në financimin për BBC-në, sidomos në vitin 1999, kur ishte nën diskutim një tarifë shtesë për abonimin në digjital. Transmetuesit privatë thanë se do të ankohen pranë Komisionit të BE-së.

70 *Po aty.*

71 *Po aty.*

72 *Po aty.*

Në fund, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka vendosur kundër tarifës së veçantë dhe gjithashtu ka vendosur që BBC-ja mund të ngritë tarifën e saj në mënyrë të moderuar gjatë disa viteve. Se shërbimet digjitale duhet të jenë në dispozicion për të gjithë, është parë si kontribut i BBC-së për digjitalizimin. Ishte konstatuar që BBC-ja mund të bëjë kursime të efikasitetit, si dhe të rrisë të ardhurat e veta komerciale nga shitja e programeve. Është parashikuar se situata për BBC-në do të ndryshojë - me një dallim të bërë mes shërbimeve bazë publike dhe kanaleve ose detyrave të tjera. Ndoshta (BBC-ja) duhet të gjej partnerë për ndërmarrje komerciale.⁷³

Ka pasur disa ankesa në Komisionin e BE-së mbi preferencat e dhëna ShPT-ve në shumë shtete anëtare të BE-së.⁷⁴ Situata e ShPT-ve në lidhje me ndihmën shtetërore dhe dispozitat tjera ligjore të BE-së përgjithësisht është trajtuar me rregulla të veçanta, por këto merren me çështjet e përgjithshme dhe jo me mbështetjen specifike shtesë për digjitalizimin.

Nevoja për mbështetje publike financiare për procesin e kalimit në transmetime digjitale është e mirë-pranuar në disa pjesë të Europës. Komisioni Europian pranon se kalimi në transmetime digjitale mund të shtyhet për më vonë nëse lihet tërësisht në forcat e tregut. Ai gjithashtu pranon se ndërhyrja publike mund të jetë e dobishme nëpërmjet rregulloreve, mbështetjes financiare për konsumatorët, fushatave informuese apo subvencioneve, në mënyrë që të kapërcehet një dështim i veçantë i tregut apo për të siguruar kohezionin social apo rajonal. Barra bie mbi shtetet anëtare të BE-së për të demonstruar se ndihma është instrumenti më i përshtatshëm, se ajo është e kufizuar në minimumin e nevojshëm, dhe ajo nuk do të dëmtoj konkurrencën padrejtësisht. Format e pranueshme të mbështetjes publike për kalimin në sistemin digjital mund të jenë:

73 J. F. MacLennan "Duke u përballur me të ardhmen digjitale: Transmetuesit e Shërbimit Publik dhe Ligji mbi Ndhimën Shtetërore në Bashkimin Evropian", fq. 159-202 Vjetari i Kembrixhit i Studimeve Europiane Juridike, Vëll. 2, 1999, (botuesi A. Dashwood & A. Ward), fq. 193-195.

74 *Po aty*.

- financimi për lansimin e rrjetit të transmisionit në zonat ku do të ketë mbulimi të pamjaftueshëm;
- kompensimi financiar për ShPT, në mënyrë që të arrij tërë popullatën;
- subvencionet për konsumatorët për blerjen e dekodeve digjital për aq kohë sa ata janë teknologjikisht neutral, veçanërisht në qoftë se ata inkurajojnë shfrytëzimin e standardeve të hapura për interaktivitet;
- kompensimi financiar për transmetuesit të cilët janë të detyruar të ndërpresin transmetimin analog para skadimit të licencave të tyre, me kusht që kjo merr parasysh kapacitetin e dhënë të transmetimit digjital.

Kapitulli 8. Rregullatori: Çështjet e licencimit

8.1 Procesi i licencimit

Çelësi për të specifikuar funksionet rregullatore të transmetimit në interes të lirisë së mediave është në procesin e **licencimit** të transmetuesve, si analog ashtu edhe digjital.

Neni 10 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut përcakton që:

“1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e pasjes së mendimit dhe të pranimit dhe dhënies së informacionit dhe ideve, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky Nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit

2. Ushtrimi i këtyre lirive, pasi që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'i nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për parandalimin e trazirave apo krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për parandalimin e përhapjes së informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.

Sipas fjalisë së tretë të Nenit 10, paragrafi 1, të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, shtetet lejohet që të rregullojnë, me anë të një sistemi të licencimit, mënyrën e organizimit të transmetimit në territoret e tyre, veçanërisht sa i përket aspekteve teknike. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet një procesi të paanshëm dhe transparent të licencimit, siç është deklaruar në një numër dokumentesh më të reja Europiane dhe vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nënvizojnë se dhënia e licencës mund të jetë gjithashtu një çështje teknike, por ajo zakonisht kushtëzohet me çështje të tilla si natyra dhe objektivat e një stacioni të propozuar, audiencën e tij të mundshme në nivel kombëtar, rajonal apo lokal, të drejtat dhe nevojat e një audience të veçantë dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumentet juridike ndërkombëtare. Kjo mund të shpjer në ndërhyrje nga ata qëllimet e të cilëve do të jenë legjitime në bazë të fjalisë së tretë të paragrafit 1, edhe pse ata mund të mos korrespondojnë me ndonjë nga qëllimet e përcaktuara në paragrafin 2 të Nenit 10. Megjithatë, përputhshmëria e ndërhyrjes së tillë duhet të vlerësohet si pasojë e kërkesave të paragrafit 2 të Nenit 10.⁷⁵

Në veçanti, Gjykata ka theksuar se mënyra në të cilën aplikohen **kriteret e licencimit** gjatë procesit duhet të ofroj garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, duke përfshirë arsyetimin e duhur nga autoriteti licencues me rastin e vendimeve të tij kur refuzohet dhënia e një licence transmetimi.⁷⁶

Më 20 dhjetor 2000, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin Rec (2000)23 për shtetet anëtare mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit, në të cilën ai rekomandon se kushtet dhe kriteret bazë që rregullojnë dhënien dhe rinovimin e licencave të transmetimit duhet qartë të përcaktohen në ligj. Rregulloret që udhëheqin procedurën e licencimit të transmetimeve duhet të jenë të qarta dhe të sakta dhe duhet të aplikohen në mënyrë të hapur, transparente dhe të paanshme. Vendimet e marra nga autoritetet rregullatore në këtë kontekst duhet t'i nënshtrohen publicitetit adekuat.

⁷⁵ *Demuth v. Zvicra*, nr. 38743/97, § 33, ECHR 2002-IX. dhe *Meltex Ltd dhe Mesrop Movsesyan v. Armenia*, nr. 32283/04, § 76, ECHR 2007-

⁷⁶ *Glas Nadezhda EOOD dhe Anatolij Elenkov v. Bullgaria*, nr. 14134/02, §§ 49-51, dhe *Meltex Ltd dhe Mesrop Movsesyan v. Armenia*, nr. 32283/04, § 81, ECHR 2007-....

Për më tepër, ato duhet të jenë:

- të arsyetuara në mënyrë të duhur, në përputhje me ligjin kombëtar;
- të hapura për shqyrtim nga juridiksionet kompetente sipas ligjit kombëtar;
- të vihen në dispozicion të publikut.⁷⁷

Rekomandimi (2003)9 mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital sugjeron se, kur lëshojnë një licencë për transmetim digjital, autoritetet publike përkatëse duhet të sigurojnë që shërbimet që ofrohen janë të shumta dhe të ndryshme, dhe ato duhet të inkurajojnë krijimin e shërbimeve rajonale apo lokale që përbushin pritjet e publikut në këto nivele.⁷⁸

8.2 Shembuj të licencimit digjital

Sipas një studimi të kryer nga Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore për alokimin e kapacitetit (spektrit) digjital janë përdorur përjasje të ndryshme. Në shumicën e rasteve (në Gjermani, Mbretëri të Bashkuar, Holandë, Itali, Spanjë, Austri, Irlandë dhe Lituani) kapaciteti është alokuar për njërin ose më tepër operatorë të rrjetit/multiplekseve. Në rastet tjera (Suedi dhe Finlandë) kapaciteti i është alokuar drejtpërdrejt kanaleve (televizive). Por, gjatë vlerësimit të modelit rregullator, ajo që duket të jetë e rëndësishme është se si rregullohet qasja në këtë kapacitet, e jo se kujt i është caktuar kapaciteti.

Duket se paraqiten dy përjasje rregullatore: në grupin e parë të vendeve (Finlanda, Gjermania dhe Suedia), renditja e kanaleve është rezultat i një përzgjedhjeje të bërë nga rregullatori apo qeveria përmes procedurave publike të cilat janë shumë të ngjashme me ato të përdorura në mjedisin analog;

⁷⁷ Rekomandimi Rec (2000)23 për shtetet anëtare mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit.

⁷⁸ Parimet themelore për transmetimin digjital / Shtojca e Rekomandimit Rec (2003)9. Shih: https://wcd.coe.int/rsi/common/renderers/rend_standard.jsp?DocId=38043&SecMode=1&SiteName=cm&Lang=en

në këtë rast nëse frekuencat i janë alokuar drejtpërdrejt transmetuesit ose një operatori të rrjetit, renditja e kanaleve që kanë qasje në kapacitet është paracaktuar nga qeveria apo rregullatori.

Në grupin e dytë të vendeve (Italia, MB dhe Norvegjia), kapaciteti menaxhohet në tërësi nga një operator i multipleksit/rrjetit i cili është relativisht i lirë të përdor kapacitetin dhe të përzgjedh renditjen e kanaleve. Në këtë rast, disa kufizime ose detyrime (përfshirja e domosdoshme, kapaciteti i rezervuar për kategori të veçanta të transmetuesve dhe të ngjashme) do të vendosen në mënyrë që të ruajnë objektivat e interesit publik, siç janë diversiteti dhe pluralizmi.

Procedura e “garës së bukurisë” mbetet që të përqafohet gjerësisht si një mënyrë për shpërndarjen e kapaciteteve teknike, për dallim nga ankandet të cilat janë përdorur gjatë alokimit të spektrit për nevoja të telekomit, si telefonja, komunikimi pa tela (wireless) dhe interneti.⁷⁹

Sipas një “gare bukurie”, apo përzgjedhjes krahasuese, aplikuesit paraqesin rastet e tyre për të fituar licencat mbi bazën e kritereve të përcaktuara në kushtet për konkurrim për licencim. Me fjalë të tjera “gara e bukurisë” lejon ndarjen e licencave në bazë të planeve të detajuara të paraqitura nga aplikuesit. Tipari themelor i procedurës tjetër, ankandit, është se licencat u jepen atyre që ofertojnë çmimin më të lartë.

Sidoqoftë e drejta për të transmetuar kanale të televizionit tokësor digjital (TTD) jepet me kushte të bashkangjitura. Për shembull, në Austri në shkurt të vitit 2006, Kommunikationsbehörde Austria (Autoriteti kombëtar i komunikimit në Austri)

⁷⁹ Grupi punues për Televizionin Tokësor Digjital në vendet e PEAR (EPRA). Raporti final. 2 qershor 2004. Shih në faqen zyrtare të PEAR, Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, në: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTTWG_finalreport.doc

i dha Österreichische Rundfunksender GmbH & Co KG (ORS) licencën për të operuar një platformë të multipleksit tokësor deri më 1 gusht 2016. Vendimi për licencimin përcakton kushtet e hollësishme për transmetimin e televizionit tokësor digjital. Nga ORS kërkohet që të rris mbulimin e vet përmes fazave. Ai duhet të përfshijë që të dyja kanalet televizive kombëtare dhe, në një masë të kufizuar, kanalet rajonale të prodhuara nga transmetuesi publik *Österreichische Rundfunk* (ORF). Transmetuesi privat ATV gjithashtu ka të drejtë të ketë kanalin e vet kombëtar tokësor ATV+ të transmetuar përmes platformës së multipleksit të shumëfishtë të ORS. Tarifat e ngarkuara për transmetimin e kanaleve dhe shërbimeve të tjera duhet të jenë të arsyeshme. ORS është gjithashtu i detyruar të trajtoj të gjithë aplikantët në mënyrë të barabartë, kur bëjnë përllogaritjen e këtyre tarifave.⁸⁰

Më parë *Kommunikationsbehörde* nxori Dekretin mbi Kriteret e Përzgjedhjes së Multiplekseve, i cili përcakton kriteret ligjore të përzgjedhjes. Preferenca do t'i jepej aplikantëve që do të arrinin shpejt një nivel të lartë të mbulimit të popullatës, që do të ofronin cilësi të shkëlqyeshme të sinjalit, që do të përfshijnë kompanitë e transmetimit, që do të ofrojnë një shërbim miqësor ndaj konsumatorit, dhe që do të paraqesin një strategji për promovimin e shpërndarjes së pajisjeve të përshtatshme marrëse dhe të ofrojnë një gamë të kanaleve digjitale që më së miri do t'i shërbej diversitetit të opinioneve.⁸¹

Detyrime të ngjashme mund t'i referohen edhe platformave të tjera. Autoriteti rregullator audiovizual francezë - CSA në vitin 2006, lëshoi një rekomandim të detyrueshëm për të gjithë operatorët kabllorë për zbatimin e Nenit 34-1 të Aktit mbi Lirinë e Komunikimit (1986, i ndryshuar). Ky Nen është paramenduar që të siguroj që amvisëritë në blloqet e apartamenteve që nuk janë të lidhura më përmes antenave ajrore, por përmes një rrjeti kabllor të shpërndarjes, të jenë në gjendje për të pranuar kanalet e televizionit të transmetuara përmes sistemit tokësor të cilat zakonisht pranoheshin në atë zonë, për të cilën gjë nuk ngarkoheshin me asnjë pagesë, pa qenë të detyruar të abonohen për një pako të kanaleve me pagesë.

80 *Rittler R.* Austria: Dhënia e Licencave për Platformën e Multipleksit Tokësor // IRIS 2006-4:8/11. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2006/4/article11.en.html>

81 *Rittler R.* Austria: Ftesë e tenderëve për Platformën Multiplekse // IRIS 2005-7:8/11. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2005/7/article11.en.html>

Vëmendja CSA-së u tërhoq nga kushtet dhe koha që u nevojiti për zbatimin e këtij "shërbimi të zgjeruar ajror", dhe për çmimet që ngarkonin disa nga operatorët kabllorë për qiradhënie të një adaptori.

Neni 34-1 deklaroi se çmimi i ngarkuar duhet të mbulojë vetëm "koston e instalimit, mirëmbajtjes, dhe zëvendësimit të rrjetit". Kjo do të thotë se në qoftë se çmimi që ngarkohet për shërbimin ajror plus kanalet e transmetuara të pa-koduara të televizionit tokësor digjital është më i lartë se çfarë ishte çmimi më parë për shërbimin ajror pa këto kanale, operatorët kabllorë do të kenë nevojë t'i ofrojnë CSA-s arsytim për rritjen e çmimit.⁸²

Rregullim i ngjashëm në lidhje me transmetimin kabllor të kanaleve publike dhe private pa pagesë u arrit në vitin 2004 në Gjermani.⁸³

Kushtet e rrepta kanë qëllim të parandalojnë kompanitë që të bartin shpenzimet e tyre mbi publikun me anë të imponimit kontrollit të çmimit mbi platformat e reja. Mund të ketë kufizime të tjera nëse merret parasysh pozita dominuese e ofruesve të shërbimeve. Për shembull, në Spanjë aktori kryesor i televizionit digjital me pagesë, i kontrolluar nga grupe kombëtare dhe ndërkombëtare të mediave është i kufizuar sa i përket kohëzgjatjes së kontratave për transmetim, të cilat ai mund t'i nënshkruajë me klubet spanjolle të futbollit; ai duhet gjithashtu të lejojë palët e treta që të shpërndajnë kanalet e tyre specifike tematike. Nuk i është lejuar për të pasur të drejta ekskluzive për kanale të prodhuara nga studiot më të mëdha amerikane apo prodhuesit ndërkombëtar. Ai gjithashtu është i detyruar t'ju japë programeve të pavarura qasje në platformën e vet nën kushte të arsyeshme, transparente dhe jo-diskriminuese.⁸⁴

82 *Blocman A. Francë*: Rekomandimi i CSA mbi "Shërbimin ajror" që do të ofrohet nga Rrjetet Kablore Digjitale // IRIS 2006-5:12/19. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2006/5/article19.en.html>

83 *Scheuer A. Gjermani*: Marrëveshja në mes të Transmetuesve të Shërbimit Publik dhe Ofruesit më të madh kabllor në Gjermani // IRIS 2004-5:7/11. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2004/5/article11.en.html>

84 *Gómez A. P. Spanjë*: Miratimi i kushtëzuar i Qeverisë rreth bashkimit (shkrirjes) të platformave kryesore të TV Digjital // IRIS 2003-3:10/17. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2003/3/article17.en.html>

Në rajonin BShP, shumë vende marrin shembullin e digjitalizimit nga Rusia, ku deri më tani vetëm 10 % e popullsisë kanë qasje në teknologjinë e televizionit digjital⁸⁵. Në Rusi (shih 8.5 më poshtë) renditja e saktë për multipleksin e parë u konfirmua nga një Dekret Presidencial të 24 qershorit 2009. Në tetor 2009, moratoriumi u hoq për ato zona ku alokimi i spektrit për multipleksin e parë të televizionit digjital kishte përfunduar. Kanalet ekzistuese të televizionit analog që kishin jo-kompatibilitet me planin digjital që ishte në zhvillim e sipër duhej të ri-pozicionoheshin në frekuenca tjera. Heqja e moratoriumit kishte për qëllim të lejonte ripërtëritjen e licencave analoge pas skadimit të tyre (afati maksimal i licencës në Rusi është 5 vjet). Sidoqoftë deri në fund të moratoriumit disa kompani televizive dështuan të ripërtërijnë licencat e tyre, veçanërisht nëse frekuencat e tyre ishin marrë gjatë ngrirjes nga multipleksi i parë i ardhshëm apo edhe u mbajtën të zbrazëta në mënyrë që të mos ndërhyjnë me televizionin digjital. Në Bjellorusi dhe Kazakistan renditjet e kanaleve për multiplekset e para janë miratuar nga qeveritë. Nga ana tjetër, në Ukrainë renditja është përzgjedhur në procedurë të hapur nga rregullatori kombëtar.

8.3 Roli i autoritetit rregullator

Sipas një studimi nga Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, roli i autoriteteve kombëtare të transmetimit (ARrK-ve), mbetet i pazëvendësueshëm sa i përket kalimit në transmetime digjitale. Aktiviteti kryesor i politikëbërjes, i cili kryhet nga ARrK-të duket të jetë mbështetja e legjislaturës në hartimin e akteve përkatëse, e ndjekur nga drejtimi i procesit të ndërprerjes së transmetimeve analoge. Sa i përket implementimit të politikave, aktiviteti kryesor i ARrK-ve është hartimi dhe kryerja e procedurës së licencimit, e ndjekur nga alokimi i frekuencave dhe përbërjes së multiplekseve. Siç duket nga përvoja e vendeve të cilat tashmë kanë nisur TTD, ARrK-të gjithnjë e më tepër do të jenë të përfshira në sfidat e paraqitura nga kalimi në transmetime digjitale.

85 Shih: <http://www.rosbalt.ru/2009/05/13/640331.html>

Kompetenca e tyre teknike, ekonomike dhe juridike është vendimtare në hartimin e kornizës më të përshtatshme rregullatore. Gjithashtu, pasi në skenarin e transmetimit digjital, në shumicën e vendeve transmetuesit tokësor do të bëhen “operatorë të rrjetit”, atëherë duhet fituar njohuri dhe aftësi profesionale të reja. Këto aftësi do të jenë të nevojshme për të menaxhuar këtë “natyrë të dyfishtë” të transmetimit që do të rregullohet, nga njëra anë, si një rrjet komunikimi, dhe nga ana tjetër sipas përmbajtjes audio-vizuale që do të bartin.⁸⁶

Në Irlandë me Aktin për Transmetime të vitit 2001, Komisioni i Pavarur për Radio dhe Televizion (IRTC), i themeluar me statut në vitin 1988 për të rregulluar sektorin e pavarur audio-vizual, u riemërua në Komisioni i Transmetimeve i Irlandës (BCI) dhe iu dha një rol më i madh. Është e nevojshme që të përkujdeset që numri dhe kategoritë e shërbimeve të transmetimit në dispozicion “i shërbejnë më së miri nevojave të popullit të ishullit të Irlandës, duke pasur parasysh gjuhët e tyre dhe traditat dhe diversitetin e tyre fetar, etnik dhe kulturor” (s.11(2)). Gjithashtu pritet që të zhvillohen dhe zbatohen kodet në lidhje me shijen dhe mirësjelljen, si dhe reklamimi dhe teleshopping.⁸⁷

Rekomandimi Rec (2000)23 për shtetet anëtare mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit sugjeron se pavarësia e organeve rregullatore dhe atyre të licencimit është jetike për ekzekutimin e funksioneve të tyre. Ai fton shtetet anëtare të Këshillit të Europës që të *“përfshijnë dispozita në legjislacionin e tyre dhe masat në politikat e tyre për t’i besuar autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit kompetenca të cilat ju mundësojnë atyre që të përmbushin misionet e tyre,*

86 Grupi punues për Televizionin Tokësor Digjital në vendet e PEAR (EPRA). Raporti final. 2 qershor 2004. Shih në faqen zyrtare të PEAR, Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, në: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTTWG_finalreport.doc

87 *McGonagle M.* Irlandë: Projektligji mbi Transmetimet bëhet Ligj // IRIS 2001-4:9/19. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2001/4/article19.en.html>

siç përshkruhet nga ligji kombëtar, në mënyrë efektive, të pavarur dhe transparente, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara” përkrah këtij dokumenti.⁸⁸

Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit parashikon si më poshtë:

“Në shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Europës, anëtarët e autoriteteve rregullatore janë të emëruar nga parlamenti ose nga kreu i shtetit me propozimin e parlamentit. Në disa shtete anëtare, me qëllim të sigurimit se anëtarësia e autoritetit rregullator reflekton diversitetin social dhe politik, një pjesë ose të gjithë anëtarët emërohen nga grupet jo-qeveritare të cilat konsiderohen të jenë përfaqësues të shoqërisë. Më tej, në një numër të vogël shtetesh anëtare, ligji parashikon kritere objektive të përzgjedhjes për emërimin e anëtarëve.

Për dallim, në një numër vendesh, anëtarët emërohen me një vendim të vetëm të ndonjë organi shtetëror, p.sh. nga kreu i shtetit ose një departament i shtetit, shpesh pa kritere të përzgjedhjes të përcaktuara qartë. Emërimi i anëtarëve të autoriteteve rregullatore nga kreu i shtetit dhe/ose parlamenti është kritikuar disa herë, duke theksuar se, në raste të tilla, anëtarësia do të përfaqësojë ose riprodhojë strukturat e pushtetit politik.

Shpesh janë ngritur shqetësimet se organet emëruese mund të ushtrojnë presion mbi anëtarët pas emërimit të tyre. Në fakt, në disa shtete anëtare, anëtarët e autoriteteve rregullatore shpesh janë akuzuar për veprime në emër të organit shtetëror që i ka caktuar apo grupacionit politik prapa autoritetit emërues.”⁸⁹

88 Rekomandimi Rec (2000)23 për shtetet anëtare mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit.

89 Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit, 26 mars 2008. Paragrafët 13 dhe 14.

Pavarësia e tillë është një parim i mirë-themeluar në Europë, i konfirmuar kohëve të fundit nga një akt vendimtar - Rezoluta 1636 (2008) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Teksti i saj vë në dukje se një nga treguesit për mediat në një shoqëri demokratike është se “autoritetet rregullatore për mediat transmetuese duhet të funksionojnë në mënyrë të paanshme dhe efektive, për shembull kur bëjnë dhënien e licencave”.⁹⁰

8.4 Moratoriumi

Një moratorium për lëshimin e licencave për transmetime mund të jetë një hap i nevojshëm në procesin e kalimit në transmetim digjital. Kjo i lejon autoritetet rregullatore që të bëjnë plane dhe të shfrytëzojnë në mënyrë efikase spektrin duke bërë ndërkohë gjithçka gati për të filluar licencimin e transmetuesve digjital. Ai gjithashtu i shtyn transmetuesit të bëjnë hapa praktik për të kaluar sinjalin e tyre analog në atë digjital.

Në të njëjtën kohë, siç është theksuar edhe nga Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave, mund të ketë përpjekje për të shfrytëzuar një moratorium të tillë për qëllime politike, për shembull, për të mbajtur stacionet e pavarura larg transmetimit.

Sa për të dhënë një shembull, më 19 shtator 2008, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave ka kërkuar nga Qeveria e Armenisë të shqyrtoj amendamentet e miratuara, të ligjit mbi TV-në dhe radion, që futën një moratorium mbi lëshimin e licencave të reja të transmetimit deri në kalimin e planifikuar në sistemin digjital më 20 korrik 2010. Ky moratorium e bën të pamundur që Armenia të respektoj vendimin e qershorit 2008 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila konstatoi se mohimi i licencave për televizionin A1+ shkelë Nenin 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dhe i apeloj vendit që të lejoj

90 Artikulli 8.15. Shih: <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta08/ERES1636.htm#1>

stacionin të aplikoj për një licencë të re në një konkurrencë të drejtë. A1+ është një kanal i pavarur të cilit në mënyrë të përsëritur i është mohuar licenca e transmetimit.

Moratoriumi në mënyrë efektive është në kundërshtim me vendimin e GjEDNj. Përderisa kalimi në transmetim digjital është cituar nga autoritetet armene si arsyeja për amendamentin, një moratorium mbi tenderët për licencat e transmetimit nuk duhet të jetë hapi i parë në procesin e digjitalizimit. Siç është raportuar, ndalimi i konkurseve për licencim të transmetuesve në Armeni shkaktoi shqetësime serioze për mediat, por edhe për organizatat ndërkombëtare.⁹¹

Nuk duhet të lejohet që digjitalizimi të zvogëlojë diversitetin dhe pluralizmin, dhe ai kurrë nuk duhet të përdoret si një justifikim për të kufizuar transmetimin e lirë dhe të pavarur. Nëse peizazhi i transmetimit në një vend nuk është pluralist dhe i larmishëm, do të ishte më mirë që digjitalizimi të shtyhej për më vonë dhe të ndërmerren paraprakisht reforma të tjera.⁹²

8.5 Transmetimi shtetëror

Pluralizmi i mediave ndikohet negativisht nga dominimi i transmetimit shtetëror. Kur transmetuesit janë nën kontrollin e qeverisë, liria e mediave është e rrezikuar. Ky problem mund të fitoj një shtytje në procesin e kalimit në transmetime digjitale.

91 Shih Buletini Javor i Klubit të Gazetarëve në Jerevan, 5-11 shtator 2008, 26 shtator - 2 tetor 2008, 3-9 tetor 2008.

92 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë. Përfaqësuesi për Lirinë e Mediave - Miklós Haraszti. Raport i rregullt për Këshillin e Përhershëm. 27 nëntor 2008. FOM.GAL/5/08/Rev.1. Shih: http://www.osce.org/documents/html/pdf/html/35149_en.pdf

Për shembull, qeveria **ruse** ka miratuar një program federal sipas të cilit pesë nga tetë kanalet televizive digjitale që janë të detyrueshëm të ofrohen pa pagesë për publikun në vitin 2011 do t'i takojnë kompanisë shtetërore, ndërsa tre të tjerë drejtohen nga kompanitë e afërta me qeverinë dhe/ose pjesërisht në pronësi të shtetit.

Kanalet ishin përzgjedhur nga qeveria, pa diskutim publik ose procedura transparente. Autoritetet ruse e quajtën këtë pako si "pako sociale", që do të thotë se buxheti publik federal dhe rajonal do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për transferimin digjital të këtij grupi të caktuar të programeve në tri platforma - TTD, kablore dhe satelitore. Përbërja e tij përfundimtare u konfirmua me një dekret të Presidentit. Nuk u ofrua asnjë shpjegim se përse, për shembull, një kanal sportiv kishte prioritet mbi një program edukativ, apo pse kanale të veçanta ishin përzgjedhur nga një grup i rrjeteve të tjera private. Nuk ishte e rezervuar asnjë vend për transmetuesit rajonal, me përjashtim të *5 Kanal* nga Shën Petersburgu.

Të gjithë transmetuesit e tjerë do të duhet të paguajnë një çmim të tregut për transferimin. Në rastin e tyre, qeveria e vë barrën e financimit të kalimit në sistemin digjital tërësisht mbi vetë transmetuesit. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë garanci që kanalet private ekzistuese pa pagesë do të mbahen në multiplekse pas ndërprerjes së televizionit analog të planifikuar për vitin 2015. Multipleksi i parë i sistemit TTD, si dhe dy të mëvonshëm, do të operohen nga kompania shtetërore RTRS.

Në vend të prezantimit të ligjit të shumëpritur për transmetime, është planifikuar që vetëm pak të ndryshohen rregulloret e tanishme qeveritare për licencimin dhe aspektet tjera të marrëdhënieve në transmetim.⁹³ Dokumentet e politikave mbi zhvillimin e transmetimeve në Federatën Ruse të miratuara nga Qeveria nuk parashikojnë prezantimin e transmetimit publik së

93 Natalya Rostova. Zritel'yu predyavili tsifru // Novaya gazeta (Moskë). 12 nëntor 2007.

bashku me, ose paralelisht me kalimin në radio dhe televizion digjital.⁹⁴

Siç vuri në dukje OSBE-ja, qeveritë duhet të përmbahen nga lehtësimi i kalimit në televizionin digjital vetëm për transmetuesit shtetëror ose ata besnikë. Përndryshe do ishte shkelje e një prej parimeve të mirë-themeluar në Europë, e konfirmuar kohëve të fundit nga **Rezoluta 1636 (2008) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Teksti i saj vë në dukje se një nga treguesit për mediat në një shoqëri demokratike është se media “ka qasje të drejtë dhe të barabartë në kanalet e shpërndarjes, qofshin ato të infrastrukturës teknike (për shembull, radio frekuencat, kabllot e transmetimit, satelitët)”**.⁹⁵

8.6 Ndërprerja e transmetimit analog

Për të përmbyllur këtë Udhëzues, le të hedhim një vështrim në datën e ndërprerjes së transmetimeve analoge.

Duket se data e ndërprerjes së transmetimeve analoge është mjeti politikë më i fuqishëm dhe më efektiv në duart e qeverive. Siç është përjetuar në Gjermani, një datë shumë e afërt dhe e sigurt e ndërprerjes së transmetimeve analoge mund të jetë jashtëzakonisht funksionale në një tranzicion digjital të suksesshëm dhe të shpejtë.

Komisioni Europian thekson se ndërprerja e transmetimeve analoge duhet të bëhet vetëm “kur transmetimi digjital ka arritur depërtim pothuajse universal”.⁹⁶

94 Shih më shumë mbi kalimin në transmetimin digjital në Rusi: Zhvillimi i Televizionit Tokësor Digjital në Rusi dhe Ukrainë nga Andrei Richter dhe Taras Shevchenko / Televizioni Digjital. IRIS-Plus, Strasburg, 2010-1, http://www.obs.coe.int/oea_publ/iris/iris_plus/plus1_2010.pdf.en

95 Artikulli 8.16 i Rezolutës 1636 (2008) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës "Treguesit për mediat në një demokraci". Shih: <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta08/ ERES1636.htm>

96 Idema E. Komisioni Europian: Komunikimi mbi Kalimin nga Transmetimi Analog në atë Digjital // IRIS 2003-10:4/5. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2004/1/article7.en.html>

Në këtë kontekst ne kemi vërejtur (shih 6.1) rekomandimet e Këshillit të Europës për të promovuar qasjen e publikut në shërbimet audiovizuale. Përveç kësaj, Direktiva e BE-së mbi Shërbimet e Mediave Audiovizuale - DShMA (AMSD) obligon shtetet anëtare që të inkurajojnë ofruesit e shërbimeve mediale për t'u siguruar që shërbimet e tyre janë bërë gradualisht të arritshme për njerëzit me aftësi të kufizuara pamore apo të dëgjimit.⁹⁷

Në shumë raste OSBE-ja vuri në dukje se procesi i kalimit në transmetime digjitale përfundon me ndërprerjen e transmetimeve analoge. Data e ndërprerjes së transmetimeve analoge duhet të caktohet me shumë kujdes, në mënyrë që asnjë pjesë e popullatës të mos përjashtohet nga televizioni tokësor digjital. Data e ndërprerjes së transmetimeve analoge, ndonëse në praktikë ajo i shtyn transmetuesit në një ritëm më të shpejtë në procesit e kalimit në transmetime digjitale, duhet të revidohet në qoftë se paraqitet rreziku i përjashtimit të tillë. Për këtë arsye, rekomandohet **monitorimi** i rregullt i mjedisit digjital.

Mbretëria e Bashkuar paraqet një shembull se si mund të bëhet ndërprerja e transmetimeve analoge në praktikë. Transmetimi analog në MB do të ndërpritet në faza rajonale mes viteve 2008 dhe 2012. Televizioni digjital në formën e Freeview (një sipërmarrje e përbashkët në mes të BBC-së dhe transmetuesve komercialë) ka qenë i suksesshëm. Freeview transmetohet në multiplekset televizive, ku pesë nga gjashtë prej tyre janë licencuar nga Ofcom (i gjashti operohet nga BBC-ja sipas Kartës së vet Mbretërore). Ofcom, rregullatori i komunikimit në MB, e bën si pjesë të kushteve të licencës sigurimin që mbulimi nga ana e televizionit tokësor digjital është arritur pas kalimit në një shkallë ekuivalente me atë të mbulimit aktual të televizionit analog. Për dy mbajtësit e licencës së multipleksit që përfshijnë kanalet e televizionit të shërbimit publik, do të jetë i nevojshëm mbulimi prej 98,5% të popullatës së MB. Për të arritur këtë, do të jetë e nevojshme që multiplekset të transmetojnë nga të gjitha 1154 pikat transmetuese që përdoren aktualisht për transmetimet analoge, gjithashtu do të nevojiten edhe nëntë drejtues shtesë të transmetimit.


⁹⁷ Neni 7 i Direktivës 2017/13/EU .

Listat e pikave nga të cilat duhet të bëhen transmetimet janë të përfshira në kushtet. Tri multiplekset komerciale që nuk përmbajnë kanalet e shërbimit publik të transmetimit duhet të arrijnë 90 % të mbulimit pas kalimit në transmetime digjitale. Mbajtësit e licencave të multiplekseve duhet t'i dërgojnë Ofcom-it një raport vjetor mbi përbushjen e kushteve.⁹⁸

98 *Prosser T.* Kushtet e licencës për të arritur mbulim pothuajse-universal të televizionit tokësor digjital pas kalimit në transmetime digjitale // IRIS 2007-2:13/22. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2007/2/article22.en.html>

VI. Shtojcë.

Aktet përkatëse ndërkombëtare



Bashkimi European

- Direktiva 95/47/EC mbi përdorimin e standardeve për transmetimin e sinjaleve televizive. 24 tetor 1995. Shih: <http://eur-lex.europa.eu>
- Direktiva 2002/19/EC mbi qasjen në, dhe ndërlidhjen e rrjeteve të komunikimit elektronik dhe objekteve/pajisjeve shoqëruese (Direktiva mbi qasjen). 7 mars 2002. Shih: <http://eur-lex.europa.eu>
- Direktiva 2002/21/EC mbi kornizën e përbashkët rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva mbi kornizën). 7 mars 2002. Shih: <http://eur-lex.europa.eu>
- Direktiva 2002/22/EC mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva mbi shërbimin universal). 7 mars 2002.
Shih: <http://eur-lex.europa.eu>
- Direktiva 2009/136/EC e cila ndryshon Direktivën 2002/22/EC mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, 25 nëntor 2009.
Shih: <http://eur-lex.europa.eu>

Direktiva 2002/58/EC në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike dhe Rregullorja (EC) Nr. 2006/2004 mbi bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit.
Shih <http://eur-lex.europa.eu>

- Direktiva 2010/13/EU për koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore apo veprime administrative në shtetet anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale (Direktiva mbi Shërbimet e Mediave Audiovizuale) (versioni i kodifikuar). 10 mars 2010.
Shih <http://eur-lex.europa.eu>

Këshilli i Europës

- Rekomandimi Rec (2000)23 për shtetet anëtare mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit. Miratuar më 20 dhjetor 2000, në takimin e 735-të të Zëvendësministrave.
Shih: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=393649&Lang=en>
- Rekomandimi Rec (2003)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi masat për nxitjen e kontributit demokratik dhe social të transmetimit digjital. Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 28 maj 2003 në takimin 840-të të Zëvendësministrave.
Shih: https://wcd.coe.int/rsi/common/renderers/rend_standard.jsp?DocId=38043&SecMod e=1&SiteName=cm&Lang=en
- Rekomandimi 1641 (2004) “Shërbimi publik i transmetimit” i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Shih: <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=http://assembly.coe.int/Documents/AdoptedTexts/ta04/EREC1641.htm>
- Rekomandimi CM/Rec(2007)2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pluralizmin e mediave dhe diversitetin e përmbajtjes së mediave (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 janar 2007 në takimin e 985-të të Zëvendësministrave).
Shih: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1089699>
- Rekomandimi *Rec (2007)3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për Shtetet anëtare mbi qëllimet e shërbimit publik të mediave në shoqërinë e informacionit* (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 janar 2007 në takimin e 985-të të Zëvendësministrave). Shih: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1089759>
- Deklarata e Komitetit të Ministrave për mbrojtjen e rolit të mediave në demokraci në kontekstin e përqendrimit të mediave (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 janar 2007 në takimin e 985-të të Zëvendësministrave).
Shih: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1089615>

- Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi alokimin dhe menaxhimin e dividendës digjitale dhe interesit publik (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 shkurt 2008 në takimin e 1018-të të Zëvendësministrave). Shih: [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Decl\(20.02.2008\)&Language=lanEnglish&Ver=0002&Site=COE&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Decl(20.02.2008)&Language=lanEnglish&Ver=0002&Site=COE&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75)
- Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore të sektorit të transmetimit. Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 26 mars 2008, në takimin e 1022-të të Zëvendësministrave. Shih: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1266737&Site=CM>
- **Rezoluta 1636 (2008) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Treguesit për mediat në një demokraci”.** Shih: <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta08/ERES1636.htm>

1 Po aty.

2 Prosser T. Mbetëria e Bashkuar: Ministri miraton Shërbimin e ri të BBC-së për Arsimitin Digjital, i cili i nënshtrohet kushteve rigorozë // IRIS 2003-3:12/21. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2003/3/article21.en.html>

3 Shih <http://www.digitaluk.co.uk/>

4 Lengyel M. Akti për kalimin në transmetim digjital dhe Ndryshim/plotësimi i Ligjit mbi Transmetimet // IRIS 2007-8:14/23. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2007/8/article23.en.html>

5 Zákon. 220/2007 Z.z. z 29. marca 2007 o digitálnom vysielani programových služieb a poskytovaní iných obsahových služieb prostredníctvom digitálneho prenosu a o zmene a doplnení niektorých zákonov (zákon o digitálnom vysielaní). Shih: <http://www.culture.gov.sk/ministerstvo/legislatva2/prvne-predpisy-v-oblasti-kultry/zkony/zkon.-220/2007>

6 Fuik J. Republika Çeke: Kalimi në DVB // IRIS 2006-6:7/10. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2006/6/article10.en.html>

7 Neni 107.3c (ish-Neni 87.3c) të Traktatit mbi Funksionimin e BE-së.

8 Neni 107. 2 a ((ish-Neni 87.2a) të Traktatit mbi Funksionimin e BE-së.

9 Neni 14 (ish-Neni 16) dhe 106 ((ish-Neni 86) të Traktatit mbi Funksionimin e BE-së.


10 S. Santamato dhe M. Salto (DG Konkurrenca) “Ndihma shtetërore për dekodëret digjital: proporcionaliteti është i nevojshëm për të përbushur interesat e përbashkët” Buletini Informativ mbi Politikat e Konkurrencës, 2006, Numër 1 (Komisioni Europian, Bruksel) fq. 97-99.

11 Ofcom është rregullatori dhe autoriteti i pavarur për konkurrencën në sektorin e komunikimit, me një detyrë të gjithanshme statutore për të çuar përpara interesat e qytetarëve dhe konsumatorëve në çështjet e komunikimit. Ofcom është përgjegjës për të siguruar: konkurrencën ndërmjet platformave digjitale; shfrytëzimin optimal të radio-spektrit; dhe se transmetuesit dhe të tjerët të përbushin detyrimet e tyre ndaj licencës, në fusha të tilla siç janë mbulimi dhe pranimi i transmetimit.

12 Österlund-Karinkanta M. Finlandë: Tarifa më të larta në Finlandë për licenca të televizionit, prej 1 janarit 2005// IRIS 2004-9:10/18. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2004/9/article18.en.html>

13 Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2002/4/article15.en.html> dhe <http://merlin.obs.coe.int/iris/2003/8/article14.en.html>

14 Grupi punues për Televizionin Tokësor Digjital në vendet e PEAR (EPRA). Raporti final. 2 qershor 2004. Shih në faqen zyrtare të PEAR, Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore, në: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTWGW_finalreport.doc



www.osce.org/fom

THE REPRESENTATIVE ON FREEDOM OF THE MEDIA

osce

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Europë

ISBN 978-92-9234-632-4